

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët.

FUQIZIM I TË RINJVE PËRMES HULUMTIMIT

STUDIM KOMBËTAR MBI PJESËMARRJEN RINORE DHE ÇËSHTJET GJINORE

Financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe zbatuar nga
Terre des hommes Shqipëri në kuadër të projektit "Të rinjtë, të drejtat dhe drejtësia"

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët.

PJESA E PARË

Studim Kombëtar mbi Pjesëmarrjen Rinore

Autorët

Drejtues shkencorë
Prof. Dr. Nevila Xhindi
Dr. Olta Qejvani

Grupi kërkimor i të rinjve

Berat	Klarida Orizi; Rei Peco
Dibër	Engjëll Karoshi; Sara Lleshi
Durrës	Avdirrahman Bakalli; Jonida Markja
Elbasan	Helen Velko; Soira Gjevori
Fier	Anja Alibehaj; Erisjana Gapi Driela
Gjirokastrë	Muho; Trei Xhemali
Korçë	Gisela Koroli; Livja Topi Esmeralda
Kukës	Plori; Klarisa Sinani Aleksia Ndoj;
Lezhë	Aleksandara Sula Egli Rustemi;
Shkodër	Melisa Rama
Tiranë	Anisa Alla; Elfrida Dauti
Vlorë	Shefqet Hoxha

Stafi mbështetës – Terre des hommes Shqipëri

Albana Izeti	Menaxhere e Programit 'Qasja në Drejtësi'
Ilva Vjero	Menaxhere për Cilësinë dhe Llogaridhënie
Gentjana Zeneli	Specialiste për Ndërtimin e Kapaciteteve
Elvis Mancellari	Specialist i Fuqizimit të të Rinjve
Kaltrina Hyka	Oficere e Monitorimit të Projekteve
Anduela Kaba	Koordinator vendor, Dibër
Anila Prendushi	Koordinator vendor, Shkodër
Brusilda Kastrati	Koordinator vendor, Kukës
Klodiana Tosuni	Koordinator vendor, Fier
Nertila Kolmarkaj	Koordinator vendor, Lezhë
Nadjuska Çela	Koordinator vendor, Tiranë
Skerdi Orgeni	Koordinator vendor, Elbasan

© Tetor 2023 Terre des hommes Shqipëri. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky studim u përgatit në kuadër të projektit "Të Rinjtë, të Drejtat dhe Drejtësia," i zbatuar nga Terre des hommes Shqipëri, dhe me kontributin financiar të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC). Opinione dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Terre des hommes Shqipëri apo donatorit të saj.

Falënderime

Grupi kërkimor i studimit dëshiron të shprehë falënderimin për 750 të rinjtë nga 12 qarqet e Shqipërisë, pjesë e këtij studimi, të cilët iu përgjigjën me shpejtësi studimit.

Dëshirojmë të falënderojmë edhe kolegët tanë - koordinatorë të Terres des Hommes në disa nga qarqet dhe bashkëpunëtorë të Tdh në terren veçanërisht të rinjtë, të cilët nëpërmjet fokus grupeve dhe intervistave dhanë informacione, ndanë opinione dhe njohuri të vlefshme në lidhje me analizat dhe rekomandimet e këtij studimi.

Një falënderim i veçantë shkon për ekipin drejtues dhe menaxhues të programeve të Terre des Hommes në Shqipëri, për inkurajimin, besimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen për të realizuar një studim pionier në këtë fushë me të rinjtë dhe për të rinjtë.

Së fundi, një falënderim për Agjencinë Austriake për Zhvillim për mbështetjen financiare dhe inkurajimin e tyre për të zhvilluar një studim kaq të vlefshëm për të rinjtë, për t'i nxitur ata të mbrojnë me dinjitet të drejtat e tyre, për të kapërcyer pengesat gjinore dhe për të qenë pjesë aktive e shoqërisë dhe demokracisë shqiptare.

Shkurtime

ADA-Agjencia Austriake për Zhvillim

ADC-Austrian Development Cooperation

AKR-Agjencia Kombëtare për Rininë

BE-Bashkimi Evropian

CAWI-Computer Assisted Web Interviewing (Mbledhja e të dhënave përmes internetit)

INSTAT-Instituti i Statistikave

KEDNJ-Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

KVR-Këshilli Vendor Rinor

OJF-Organizata jofitimprurëse

OKB-Organizata e Kombeve të Bashkuara

TdH-Terres des hommes

UNESCO-Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë UNHCR-Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

UNICEF-Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara

SKR29-Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029

Tabela përmbledhëse

I. Qëllimi dhe objektivat e studimit	8
II. Metodologjia	8
Metodologjia e përfshirjes së të rinjve bashkëkërkues	9
Përzgjedhja e kampionit	10
III. Struktura e studimit	12
IV. Kuadri i përgjithshëm teorik dhe legjislativ	13
Analiza legjislativë dhe mekanizmat institucionalë për pjesëmarrjen e të rinjve Marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj	17
Përfaqësimi i të rinjve në jetën politike dhe veçanërisht në strukturat e qeverisjes vendore	21
V. Gjetjet dhe analiza	22
VI. Përfundime dhe rekomandime	23
VII. Bibliografia	32
Lista e tabelave	36
Tabela 1 Të dhënat zyrtare të INSTAT-it për popullsinë e grupmoshës 15-19 dhe 20-24 vjeç	10
Tabela 2. Të dhënat sipas INSTAT-it për popullsinë për qark dhe përlllogaritjet e kampionit	11
Lista e figurave	
Figura 1. Të anketuarit sipas grupmoshës	23
Figura 2 Të anketuarit sipas gjinisë	23
Figura 3. Shpërndarja e të anketuarve në nivel qarku në %	24
Figura 4. Strukturat më aktive me të rinjtë në komunitet	26
Figura 5. Besimi se institucionet që punojnë me të rinjtë mund të sjellin ndryshim	28
Figura 6. Aktivitete në shkollë që nxisin pjesëmarrjen e të rinjve	28
Figura 7. Sa të përfaqësuar ndihen të rinjtë në strukturat e shkollës	29
Figura 8. Përfitimet nga pjesëmarrja në aktivitetet e organizuara	30
Figura 9. Shpeshtësia e përdorimit të rrjeteve sociale	31
Figura 10. Format e pjesëmarrjes online	31

Përmbledhje e studimit

Pjesëmarrja e të rinjve në jetën demokratike është një nga temat më të rëndësishme të politikës rinore në Evropë. Që nga fillimi i mijëvjeçarit të ri, studiuesit dhe politikanët kanë qenë të shqetësuar për "tërheqjen" e dukshme të të rinjve nga pjesëmarrja demokratike (p.sh., Norris, 2001; Furlong dhe Cartmel, 2011). Megjithatë, studimet kanë zbuluar gjithashtu se, pavarësisht mungesës në dukje të interesit të tyre për aktivitetet zyrtare publike dhe politike, të rinjtë shpesh përfshihen në mënyra dhe stile joformale e alternative të pjesëmarrjes në jetën demokratike.

Problemet që lidhen me angazhimin e të rinjve në Shqipëri nuk kanë marrë gjithmonë vëmendjen e nevojshme dhe të duhur nga politikëbërja. Të rinjtë shpesh përfshihen në shoqërinë civile si një hap drejt politikës dhe vendimmarrjes. Përfshirja e të rinjve në procesin e vendimmarrjes në Shqipëri shpesh pengohet nga mendësia e vjetër, e cila e konsideron rininë si të papërvajë për të qenë pjesë e institucioneve vendimmarrëse, si parlamenti, qeveria, këshillat bashkiakë dhe kjo është një pikë kryesore shqetësuese. Megjithatë, në dekadën e fundit, fokusi i vëmendjes për të rinjtë lidhen më së shumti me problemet me të cilat përballen, si papunësia, pabarazia, përjashtimi social, migrimi, varësia, etj.

Terre des hommes (Tdh) është organizata kryesore zvicerane për ndihmën ndaj fëmijëve. Nëpërmjet programeve të ndryshme, çdo vit ofron ndihmë për mbi katër milionë fëmijë dhe familjet e tyre në rreth 40 vende të botës. Një nga vendet ku Terre des Hommes operon është edhe Shqipëria, me seli në Tiranë. Në përmbushje të këtij misioni, një nga projektet e organizatës është edhe 'Të Rinjtë, të Drejtat dhe Drejtësia', i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA). Një nga rezultatet e zotuar në kuadër të këtij projekti, është hartimi i një studimi kombëtar i drejtuar nga të rinjtë, mbi pjesëmarrjen e të rinjve shqiptarë në çështjet e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe në komunitet. Përveç ekspertizës dhe hulumtimeve përkatëse, roli i të rinjve si bashkëkërkues dhe përpunues të dhënash ka qenë një dimension thelbësor në ndërtimin dhe impaktin e këtij studimi.

Është thelbësore të pranohet se trajtimi i çështjeve që lidhen me rininë kërkon një qasje të shumanshme që përfshin politikën e qeverisë, organizatat e shoqërisë civile, institucionet arsimore dhe pjesëmarrjen aktive nga vetë të rinjtë. Marrja përsipër e këtij studimi në nivel kombëtar përputhet me vizionin dhe misionin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029:

Ky studim u realizua në nivel kombëtar nga bashkëpunimi i 23 të rinjve nën këshillimin shkencor të dy drejtuesëve, duke mbuluar 12 qarqe në Shqipëri. Procesi i kërkimit në këtë studim përfshiu tri faza kryesore: së pari, hulumtimi dhe kërkimi shkencor; së dyti, puna në terren dhe mbledhja e të dhënave nga të rinjtë e angazhuar si bashkëkërkues; dhe së treti, analiza dhe interpretimi i të dhënave.

Objektivit Specifik 1.3 "Studimet rinore zhvillohen dhe bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë" dhe masat përkatëse përfshijnë:

1.3.2 Politikat zhvillimore rinore ndërtohen mbi analiza faktike dhe dokumentare.

1. Hartohet një studim bazë reference në lidhje me autonominë rinore dhe mundësitë e barabarta sipas nevojave të të rinjve (2022 – 23)

2. Hartohet një studim bazë reference në lidhje me gjithë përfshirjen rinore dhe sfidat e përfshirjes të të gjithë kategorive rinore në proceset e zhvillimit të vendit (2022 – 23).

Metodologjia për mbledhjen e të dhënave u realizua sipas teknikës CAWI (Computer Assisted Web Interviewing), e njohur ndryshe si mbledhje e të dhënave përmes internetit. Mbledhja e të dhënave u krye në periudhën shtator 2023, në platformën Microsoft Forms dhe studimi përfshiu një kampion prej 650 të rinjsh e të rejash të grupmoshave 15–19 vjeç dhe 20–24 vjeç, duke përfshirë të rinj nga zona urbane dhe rurale, nga komunitete të cënueshme dhe të rinj që nuk janë në arsim, punësim apo formim profesional (NEET). Po ashtu, u ngritën 11 fokus grupe verifikuese me 100 të rinj nga 12 qarqet e vendit, me përfaqësi të të rinjve nga zona urbane e rurale, vajza e djem, komunitete të cënueshme.

Gjetjet kryesore:

- Struktura vendimmarrëse ku të rinjtë raportojnë se kanë qenë më së shumti të angazhuar është senati i shkollës.
- Vetëm 29% e të rinjve raportojnë se janë të angazhuar apo pjesë e organizatave rinore/organizatave për të rinjtë.
- Gjithashtu, një përqindje e vogël e të rinjve (9%) raportojnë se janë të angazhuar në grupime politike.
- Ndërkohë që 82% raportojnë se janë të gatshëm të marrin pjesë në organizata rinore apo struktura të tjera vendimmarrëse.
- Shumica e të rinjve (61%) raporton se nuk ndihen të përfaqësuar në organet vendimmarrëse dhe shumica e të rinjve gjithashtu nuk besojnë, apo nuk janë të sigurtë, nëse pjesëmarrja e tyre ka ndikim.
- Shkolla është struktura më aktive në komunitet, ku organizohen shumica e aktiviteteve për të rinjtë. Aktivitetet sportive, kulturore dhe argëtuese janë aktivitetet që ofrohen më së shumti për të rinjtë, kryesisht të organizuara nga shkolla.

- Të pyetur se sa të përfshirë ndihen në këto aktivitete, 30% e të rinjve shprehen se nuk mendojnë se roli i tyre ka ndonjë ndikim.
- Vetëm 28% e të rinjve ndihen/janë ndier tërësisht të përfaqësuar nga strukturat në shkollë/universitetet.
- 56% e të rinjve u shprehën se nuk kanë qenë ndonjëherë pjesë e ndonjë nisme komunitare.
- 67% e të rinjve raportojnë se media sociale është burimi kryesor për të marrë informacionin që nxit pjesëmarrjen e të rinjve, duke lënë pas televizionin apo kërkimin në faqet e internetit.
- Po ashtu, për 56% të të rinjve, rrjetet sociale janë një burim i besueshëm për të marrë informacione që nxisin pjesëmarrjen e tyre në shoqëri.
- Media sociale është kanali kryesor i komunikimit për të rinjtë, ku ata informohen dhe angazhohen më së shumti. Në të njëjtën kohë, të rinjtë raportojnë se ajo është bërë një hapësirë që i ka çuar drejt individualizimit dhe ku janë përballur me rreziqe, si tallja dhe bullizmi.
- Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve (17%) janë ndier të bullizuar, të ngacmuar dhe të rrezikuar gjatë përdorimit të rrjeteve sociale dhe 10% kanë preferuar të mos përgjigjen.
- Vetëm 7% e tyre kanë raportuar abuzimin online.

I. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi ishte përfshirja e vetë të rinjve në hulumtimin e pengesave dhe sfidave që hasin në angazhimin e tyre social dhe publik, si dhe ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e mekanizmave të përfshirjes në vendimmarrje.

Objektivat e studimit janë si më poshtë

- Të identifikojë pengesat e mundshme brenda mekanizmave ligjorë dhe politikave që mbështesin fuqizimin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve/të rinjve për avancimin e të drejtave të njeriut.
- Të identifikojë praktikrat ekzistuese në mbarë vendin që promovojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e barabartë të fëmijëve/të rinjve me aktorët vendorë për avancimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe mjedisit në nivel vendor.
- Të eksplorojë pengesat dhe boshllëqet që ndikojnë në angazhimin e duhur dhe kuptimplotë të të rinjve.

Studimi ka pasqyruar gjetjet dhe konkluzionet e analizës së bërë pas ndjekjes së një metodologjie rigoroze dhe ka dalë me rekomandime konkrete dhe të përshtatura për Tdh-në, që do të përdoren në ndërhyrjet e ardhshme të Tdh.

II. Metodologjia

Ky studim u realizua në nivel kombëtar nga bashkëpunimi i 23 të rinjve nën këshillimin shkencor të dy drejtuesëve, duke mbuluar 12 qarqe në Shqipëri.

Procesi i kërkimit në këtë studim përfshiu tri faza kryesore: së pari, hulumtimi dhe kërkimi shkencor; së dyti, puna në terren dhe mbledhja e të dhënave nga të rinjtë e angazhuar si bashkëkërkues; dhe së treti, analiza dhe interpretimi i të dhënave. Në bashkëpunim me të rinjtë u hartua një kornizë kërkimore për studimin. Procesi i realizimit ishte si më poshtë:

- **Identifikimi i grupit të të rinjve bashkëkërkues** dhe realizimi i trajnimit/ orientimit të tyre. Fillimisht u zhvillua një trajnim 2-ditor me 23 të rinjtë me qëllim për t'i bërë pjesë të të gjithë studimit, duke filluar nga hartimi i pyetësorit, mbledhja e të dhënave deri te realizimi i fokus grupeve me të rinjtë në 12 qarqe.

- **Përcaktimi i objektivave të kërkimit:** Këtu u përfshinë objektivat specifike të kërkimit, dhe në bashkëpunim me të rinjtë u identifikuan fushat kryesore të interesit, si pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje, në kontekstin komunitar, në kontekstin e shkollës dhe në teknologji, mekanizmat e pjesëmarrjes dhe pengesat, si dhe sfidat që hasin të rinjtë.
- **Rishikimi i literaturës ekzistuese:** U bë një përmbledhje e literaturës aktuale mbi çështjet që lidhen me rininë në arenën ndërkombëtare, me fokus te politikat rinore në BE dhe Shqipëri. U analizuan punimet akademike, studimet, dokumentet ligjore, strategjitë kombëtare, publikimet e OJQ-ve dhe të dhënat e organizatave ndërkombëtare. Kjo ndihmoi për të ndërtuar një bazë të fortë për studimin dhe për të identifikuar boshllëqet që kanë nevojë për eksplorim të mëtejshëm në rastin e Shqipërisë.
- **Identifikimi i praktikave më të mira:** U identifikuan praktikat e suksesshme të fuqizimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve që kanë kontribuar pozitivisht në avancimin e sundimit të ligjit, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore në Shqipëri, si dhe faktorët që i bëjnë këto praktika efektive.
- **Mbledhja dhe analiza e të dhënave:** Metodologjia për mbledhjen e të dhënave u realizua sipas teknikës CAWI (Computer Assisted Web Interviewing), e njohur ndryshe si mbledhje e të dhënave përmes internetit. Mbledhja e të dhënave u krye në periudhën shtator 2023, në platformën Microsoft Forms, dhe studimi përfshiu një kampion prej 650 të rinjsh e të rejash të grupmoshave 15–19 vjeç dhe 20–24 vjeç. Të dhëna cilësore u mblodhën përmes 11 fokus grupeve të realizuar me 100 të rinj nga gjithë vendi.
- **Përfundime dhe rekomandime:** Bazuar në analizën e të dhënave, të rinjtë e angazhuar dhe ekspertët kanë nxjerrë përfundime dhe kanë bërë rekomandime në lidhje me gjendjen dhe mundësitë e fuqizimit, pjesëmarrjes dhe paragjykimeve gjinore të të rinjve në Shqipëri. Rekomandimet janë të bazuara në fakte për përmirësimin e strukturave dhe praktikave rinore në mbështetje të avancimit të sundimit të ligjit, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

Gjatë gjithë procesit të kërkimit, janë ruajtur standardet etike dhe është siguruar konfidencialiteti i të dhënave.

Metodologjia e përfshirjes së të rinjve bashkëkërkues

Terre des hommes Shqipëri, ka përfshirë në këtë studim, në rolin e bashkëkërkuesëve, 23 të rinj nga 12 qarqe të vendit. Të rinjtë janë përzgjedhur përmes një procesi aplikimi, ku fillimisht u përcaktuan kriteret kryesore që duhet të përmbushnin të rinjtë bashkëkërkues (Shtojca A). Në secilin qark u përzgjedhën 2 të rinj. Pas procesit të përzgjedhjes, të rinjtë u bënë pjesë e një trajnimit 2-ditor, ku u pajisën me njohuri në lidhje me studimin e drejtuar nga të rinjtë, procesin dhe hapat e tij. Po ashtu, u pajisën me aspekte teorike të angazhimit rinor dhe mekanizmeve ligjore, si dhe u orientuan mbi metodologji dhe mjete praktike për hartimin e një pyetësori.

Pas disa takimeve konsultative mbi teknikat që do të përdreshin prej tyre për të ideuar dhe shpërndarë pyetësorin, për të drejtuar takimet me të rinjtë në fokus grupet vendore deri në hartimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve bazuar mbi të dhënat, së bashku me ekspertët dhe stafin e Tdh-së, të rinjtë morën udhëzimet përkatëse për të shpërndarë dhe përcjellë në komunitetet e tyre të dhënat e mbledhura të pyetësorit.

Pas disa takimeve konsultuese mbi teknikat që do të përdreshin prej tyre për të ideuar dhe shpërndarë pyetëtorin, për të drejtuar takimet me të rinjtë në fokus grupet vendore deri në hartimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve bazuar mbi të dhënat, së bashku me ekspertët dhe stafin e Tdh-së, të rinjtë morën udhëzimet përkatëse për të shpërndarë dhe përcjellë në komunitetet e tyre të dhënat e mbledhura të pyetëtorit.

Pyetëtori i hartuar nga të rinjtë (Shtojca B) u administrua online me 650 të rinj, me fokus 5 fusha studimi:

- Angazhimi publik;
- Angazhimi komunitar;
- Angazhimi në edukim;
- Pjesëmarrja përmes përdorimit të rrjeteve sociale;
- Pjesëmarrja dhe çështjet gjinore.

Të rinjtë dhe stafi mbështetës i Tdh-së, pas përfundimit të pyetëtorit, organizuan 11 fokus grupe (Shtojca C) me pjesëmarrjen e 100 rinjve nga 12 qarqet e Shqipërisë.

Përzgjedhja e kampionit

Përzgjedhja e kampionit në këtë studim u bazua në të dhënat zyrtare të INSTAT-it (1 janar 2023) për popullatën e grupmoshës rinore 15-24 vjeç.

Pyetëtori u aplikua në dy grupmosha: 15-19 dhe 20-24. Në bazë të të dhënave të INSTAT-it dhe llogaritjes së madhësisë së kampionit¹ dhe kufirit të gabueshmërisë, parashikimi ishte që, për të qenë sa më përfaqësues, studimi të përfshinte minimalisht 384 persona të të dy grupmoshave të mësipërme.

Popullata	Total	Vajza	Djem
15-19	172.076	84.315	87.761
20-24	196.240	97.887	98.353
Total	368.316	182.202	186.114

1 Të dhënat zyrtare të INSTAT-it për popullsinë e grupmoshës 15-19 dhe 20-24 vjeç

Popullata (Total)	Niveli i besimit	Kufiri i gabimit	Madhësia e kampionit ¹
368.316	95%	5%	384

¹<https://www.calculator.net/sample-size-calculator.html?type=1&cl=95&ci=5&pp=50&ps=368316&x=110&y=23>

Vihet re se numri total i të rinjve për secilin qark është një indikator i munguar në bazën e të dhënave të INSTAT-it. Duke eksploruar edhe nga burime (raporte) të tjera, duke qenë se kjo e dhënë mungon, përlogaritjet përkatëse për secilin qark u bazuan mbi numrin e popullsisë totale. Në këtë mënyrë u nxor përqindja përkatëse për secilin qark (popullsia e qarkut si pjesë e numrit total të popullsisë).

	Total	Femra	Meshkuj	%e totalit
Berat	111.431	56.370	55.061	4
Dibër	106.380	51.030	55.350	4
Durrës	289.797	143.757	146.040	10
Elbasan	252.719	128.470	124.249	9
Fier	271.672	136.104	135.568	10
Gjirokastrë	53.314	27.907	25.407	2
Korçë	192.925	98.437	94.488	7
Kukës	71.498	34.783	36.715	3
Lezhë	114.181	58.164	56.017	4
Shkodër	189.164	97.728	91.436	7
Tiranë	925.268	470.061	455.207	34
Vlorë	183.436	92.053	91.383	7
Total	2.761.785	1.394.864	1.366.921	

2 Të dhënat sipas INSTAT-it për popullsinë për qark dhe përlogaritjet e kampionit

Ky numër u konceptua dhe përlogaritjet u kryen në mënyrë që kampioni të ishte sa më përfaqësues edhe për popullsinë urbane dhe rurale, vajzat dhe djemtë, si dhe grupmoshën 15-19 dhe 20-24 vjeç. Numri i të rinjve të përfshirë për secilin qark do të përfshinte 50 për qind meshkuj e 50 për qind femra për secilën grupmoshë.

Përzgjedhja e kampionit u testua edhe në takimin e organizuar me të rinjtë mbi mundësitë, pamundësitë dhe vështirësitë që ata mendojnë se mund të hasin në këtë proces. Përzgjedhja e kampionit prej 500 të rinjsh (realisht arriti në 650) në gjithë qarqet e vendit, siguroi përfaqësimin e duhur për secilin prej qarqeve, duke mundësuar jo vetëm gjithëpërfshirjen, por edhe mundësinë e krahasimit të problematikave dhe realiteteve të komuniteteve mbi pjesëmarrjen e të rinjve, me mekanizmat e ngritur në nivel politik, ligjor dhe social.

III. Struktura e studimit

- **Prezantimi (lista e shkurtimeve, hyrja, metodologjia, objektivat, përmbajtja, etj.).**
Këtu janë përfshirë disa informacione bazë, objektivat e kërkimit, metodologjia, përzgjedhja e kampionit dhe instrumentet konkrete të kërkimit.
- **Kuadri i përgjithshëm teorik dhe legjislativ:**
 - Përfshirja demokratike e të rinjve,
 - Analiza legjislative dhe mekanizmat institucionalë për pjesëmarrjen e të rinjve – të drejtat dhe drejtësia,
 - Sfondi rinor në Shqipëri – mekanizmat legjislativë dhe dokumentet kryesore strategjike.

Qëllimi i këtij kapitulli të dytë është të ofrojë një kornizë të detajuar konceptuale dhe analitike, si sfond i nevojshëm i projektit kërkimor, por edhe si një instrument për të kuptuar më mirë dhe për t'i vendosur gjetjet e kërkimit në kontekst. Qëllimi nuk është të ndalemi në konceptet teorike, por të kemi një kornizë të qartë analitike që do t'u mundësojë studiuesve të interpretojnë gjetjet dhe të nxjerrin rekomandimet përkatëse.

- **Gjetjet dhe analizat**

Kjo do të jetë pjesa thelbësore e studimit dhe do të organizohet sipas objektivave të kërkimit të përshkruara në hyrje. Duke qenë se ky është një studim cilësor, analizat dhe diskutimet do të paraqiten së bashku. Për ta bërë më të lehtë leximin, do të përdoren grafika dhe tabela të rezultateve.

- **Përfundime dhe rekomandime**

Ky seksion do të fokusohet në pikat kryesore dhe rekomandimet. Këto të fundit janë hartuar në bazë të çështjeve të identifikuara, por edhe duke synuar audienca të veçanta, për shembull, rekomandime për ministrinë, grupet e interesuara dhe TdH-në.

- **Bibliografi**

- **Shtojcat: Formati i pyetësorit, udhëzimet e fokus grupeve, instrumentet e përdorur në studim.**

IV. Kuadri i përgjithshëm teorik dhe legjislativ

Përfshirja e të rinjve në demokraci: koncepte dhe praktika

Fuqizimi dhe angazhimi aktiv i të rinjve në jetën qytetare shërben si një forcë e fuqishme për progresin dhe transformimin shoqëror. Pjesëmarrja e barabartë e të rinjve në proceset demokratike nuk është thjesht një çështje gjithëpërfshirjeje, sesa është një kërkesë themelore për qëndrueshmërinë e qeverisjes demokratike. Duke përfaqësuar të tashmen e kombit, dhe me sytë drejtuar nga e ardhmja, të rinjtë sjellin perspektiva të reja, ide novatore dhe energji në tryezën e vendimmarrjes, të cilat potencialisht çojnë drejt ndryshimeve pozitive për komunitetet vendore dhe mbarë shoqërinë.

Njerëzit fuqizohen kur arrijnë të përfitojnë të drejtat e tyre dhe është e rëndësishme të sigurohen mundësi dhe të drejta të barabarta për gjithsecilin, si dhe është e drejta e secilit prej nesh të marrë pjesë në jetën demokratike dhe atë qytetare. Megjithatë, të rinjtë sot janë të nënpërfaqësuar në proceset vendimmarrëse, shumë prej tyre nuk kanë qasje në të drejtat e tyre sociale dhe përballen me diskriminim të shumëfishtë e paragjykime. Strategjia e Bashkimit Evropian për Rininë 2019-2027 i kushton rëndësi të veçantë gjithëpërfshirjes, pjesëmarrjes dhe angazhimit,

- listuar “pika 3: **SHOQËRITË PËRFSHIRËSE:** *Një e treta e të rinjve në Evropë janë në rrezik të varfërisë dhe përjashtimit social. Duhet të mundësohet dhe sigurohet përfshirja e të gjithë të rinjve në shoqëri”, si*
- dhe “pika 9: **HAPËSIRË DHE PJESËMARRJE PËR TË GJITHË:** *Të forcohet pjesëmarrja dhe autonomia demokratike e të rinjve, si dhe të sigurohen hapësira të dedikuara rinore në të gjitha fushat e shoqërisë.”²*

Është thelbësore të punohet drejt përmbushjes së të drejtave të të rinjve në veçanti, sidomos më të marginalizuarit dhe të përjashtuarit, dhe mbarë njerëzimit në përgjithësi. Sot, një në gjashtë persona globalisht përjetojnë diskriminim të çfarëdo forme. Në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, objektivi nr. 5 – Barazi Gjinore dhe objektivi nr. 10 – Pabarazi të Redukuara, theksojnë rëndësinë e fuqizimit dhe promovimit të përfshirjes sociale, ekonomike dhe politike të të gjithëve, pavarësisht nga mosha, gjinia, raca, etnia, origjina, feja ose statusi ekonomik.⁴

Sakaq, në udhëzuesin e Fondit të Emergjencës të Kombeve të Bashkuara (UNICEF) për angazhimin e adoleshentëve dhe të rinjve, cilësohet se është një detyrim moral i qeverive dhe shoqërive në mbarë botën që të mbështesin dhe përmirësojnë mundësitë e angazhimit të të rinjve, pasi pjesëmarrja e të rinjve dhe angazhimi qytetar ka rëndësi dhe është një e drejtë themelore për ta.⁵

²Strategjia e BE-së për Rininë 2019-2027. Gjetet në: https://www.oph.fi/sites/default/files/documents/eu-youth-strategy_en.pdf

³United Nations (2023). The Sustainable Development Goals Report: Special Edition 2023. Gjetet në:

<https://unstats.un.org/sdgs/report/2023/The-Sustainable-Development-Goals-Report-2023.pdf>

⁴Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Gjetet në: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/ent-goals/>

⁵UNICEF. Adolescent and Youth Engagement Guide. Available at:

<https://www.unicef.org/evaluation/media/1581/file/A%20guide%20to%20action%20what%20works%20on%20adolescent%20and%20young%20people%20engagement.pdf>

Në dekadën e fundit, edhe Shqipëria i ka dhënë fokus të veçantë angazhimit të të rinjve në jetën qytetare dhe atë demokratike. Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 383, datë 6 maj 2015, Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 pati si qëllim zhvillimin dhe koordinimin e politikave ndërsektoriale rinore në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe forcimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset vendimmarrëse.⁶

Në përfundim të këtij plani dhe bazuar në raportin final, u hartua një ndër dokumentet më të fundit kombëtare publikuar në mars 2023, Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 (SRK29), miratuar në tetor 2022 me vendim të Këshillit të Ministrave, e cila i jep mundësi dhe mbështet në mënyrë të barabartë të rejtat dhe të rinjtë për t'u bërë partnerë aktivë në zhvillimin e Shqipërisë. Dy nga parimet bazë të kësaj strategjie janë:

1) Mbështetje për të gjithë të rinjtë për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë, duke marrë parasysh të drejtat e tyre, zërat dhe nevojat e tyre të ndryshme, duke mos lënë askënd pas;

dhe

2) Pjesëmarrja domethënëse e të rinjve në vendim-marrjen vendore dhe kombëtare, në organizatat rinore dhe jetën e komunitetit (SKR 2022 – 2029; faqe 34).⁷

Ndonëse pjesëmarrja konsiderohet një element thelbësor i qytetarisë në një shoqëri demokratike dhe në një vend demokratik, shqiptarët ndihen të shkëputur nga qeveria dhe politika, dhe dy të tretat e tyre shprehin pakënaqësi nga puna e institucioneve të qeverisjes dhe strukturat e opozitës. Vetëm 20% e të rinjve raportojnë se ndihen të përfaqësuar në politikën rinore të zbatuara në nivel qendror/vendor dhe SKR29 synon që në përfundim të vitit 2029, kjo shifër të kapë vlerën 80%. Sakaq, pritet që 2.4% e buxhetit të shtetit t'i dedikohet programeve për rininë. Për më tepër, të rinjtë në Shqipëri raportojnë nivelin më të ulët të njohurive dhe interesin më të ulët për politikën.⁸ 80% e tyre janë të distancuar nga partitë politike, duke mos i konsideruar ato si mjetin parësor për të ndryshuar shoqërinë dhe për të avancuar aftësitë dhe bindjet e tyre politike. 68.8% e të rinjve deklarojnë se pjesëmarrja e tyre në politikë është e rëndësishme dhe vetëm 16% besojnë se çështjet rinore janë në fokus të programeve të partive politike.⁹ Bino dhe Seferaj (2021) argumentojnë se:

“Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërsektorial në fushën e rinisë dhe çështjeve të ndërlidhura është thelbësor. Shqipëria ka nevojë të rrisë përpjekjet e saj për të zhvilluar një sistem rinor plotësisht funksional, i cili u përgjigjet nevojave të të rinjve, siguron gjithëpërfshirje dhe krijon një mjedis të përshtatshëm për pjesëmarrjen dhe fuqizimin e të rinjve”.¹⁰

Që të mundësohet përfshirja e të gjithë të rinjve në shoqëri dhe të sigurohet mbështetje për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë, duke marrë parasysh të drejtat e tyre, zërat dhe nevojat e ndryshme, si dhe t'i jepet rëndësia e duhur fuqizimit dhe promovimit të përfshirjes sociale, ekonomike dhe politike të të gjithëve, nevojitet ngritja dhe përdorimi i disa mekanizmave funksionalë.

Sipas UNICEF-it¹¹, nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve dhe angazhimi qytetar, bazuar në përvojat e shumë vendeve, mundësohet nëpërmjet:

⁶Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020. Gjetet në: https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/plani-kombetar-i-veprimit-per-rinine-2015-2020_Shqip.pdf

⁷Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029. Gjetet në: <https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/Strategjia-Kombetare-e-Rinise-2022-2029.pdf>

⁸NDI & NDI (2020). Angazhimi Politik Shqipëri 2020. Gjetet në: https://www.ndi.org/sites/default/files/Albania%20Political%20Engagement%20Survey%202020_Albanian.pdf

⁹Anketa kombëtare: Të rinjtë dhe politika në Shqipëri. Gjetet në: https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey_young-people-and-politics-in-albania-final.pdf

¹⁰Bino, B., & Seferaj, K. (2021). Mapping of Youth Policies and Identification of Existing Support and Gaps in Financing of Youth Actors in The Western Balkans – Albania Report. Gjetet në: https://www.rcc.int/youth_db/files/user/docs/1.1_Albania_Report.pdf

- Nxitjes së ligjeve, politikave dhe përpjesëtimeve buxhetore që mbështesin angazhimin e të rinjve;
- Mbështetjes dhe krijimit të strukturave për pjesëmarrjen dhe angazhimin qytetar të të rinjve;
- Institucionalizimit të edukimit global të qytetarisë duke përfshirë programet mësimore dhe trajnimin e mësuesve;
- Investimit në kapacitetet, rrjetet dhe partneritetet e të rinjve duke përfshirë lëvizjet dhe nismat e tyre;
- Maksimizimit të vlerës së vullnetarizmit dhe shërbimit në komunitet.

Edhe në rastin e Shqipërisë, zbatimi i konventave dhe instrumenteve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe aktet ligjore dhe rregullatore që mbështesin angazhimin e shoqërisë civile në përgjithësi dhe të rinjve në veçanti, formojnë një mekanizëm të nevojshëm mbështetës të politikave të integritit të të rinjve dhe shoqërisë civile në vendimmarrjen vendore dhe kombëtare, në organizatat rinore dhe jetën e komunitetit. Bino, Qirjazi dhe Dafa (2020)¹² argumentojnë se:

“Kornizat ligjore dhe politikave për mundësimin e bashkëpunimit mes institucioneve publike dhe shoqërisë civile janë kryesisht në vend”.

Kuadri ligjor që mundëson pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të rinjve në vendimmarrje është përmirësuar me ligjin për konsultimet publike, ligjin për të drejtën e informimit, ligjin për vetëqeverisjen vendore dhe ligjin për rininë.¹³ Megjithatë, referuar ligjit për rininë, vlen të theksohet se në nivel vendor zbatimi i tij po ecën me hapa më të ngadaltë se në nivel qendror. Sipas raportit “Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/2019 - Për Rininë”, 28% e bashkive nuk e kanë filluar ende zbatimin e ligjit, ndërsa 46.5% e tyre nuk kanë filluar ngritjen e Këshillave Vendore Rinore. Për më tepër, 74.4% e bashkive nuk kanë një buxhet të dedikuar për rininë, gjë që e bën të pamundur realizimin e aktiviteteve që burojnë nga ligji për rininë dhe 69.7% e bashkive nuk disponojnë një dokument strategjik për politikave rinore në nivel vendor.¹⁴

Si pasojë, në vitin 2022, vetëm 16% e bashkive i kanë pasur të ngritura Qendrat Rinore Multifunkionale (SKR29). Në sferën politike, ndonëse ka përmirësim në përfshirjen e të rinjve për sa i përket zgjedhjes së drejtuesve rinorë, aktiviteteve politike dhe njëfarë pranije të politikanëve të rinj në organet kryesore politike, niveli i pjesëmarrjes është ende i ulët, duke i penguar në rolin e tyre proaktiv dhe përfshirjen në strukturën tradicionale politike të vendit (Bërdufi & Pacukaj, 2022).¹⁵

Krahas kuadrit ligjor më se të nevojshëm për të siguruar përfshirjen e të rinjve në shoqëri dhe vendimmarrje, një mekanizëm tjetër po aq i nevojshëm për të rritur ndërgjegjësimin e këtyre të fundit mbi rëndësinë e të qenit qytetarë aktivë, është puna që bëjnë organizata të ndryshme joqeveritare nëpërmjet projekteve dhe trajnimeve që lidhen pikërisht me këtë çështje. Bino dhe Seferaj (2021) theksojnë se është e rëndësishme që:

¹¹UNICEF. Udhëzuesi për Angazhimin e Adoleshentëve dhe të Rinjve. Gjetet në:

<https://www.unicef.org/evaluation/media/1581/file/A%20guide%20to%20action%20what%20works%20on%20adolescent%20and%20young%20people%20engagement.pdf>

¹²Bino et al (2020). Civil Society Participation in Decision Making in Albania. WFD dhe IDM. Gjetet në: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/CSO-Participation-in-Decision-Making-in-Albania.pdf>

¹³Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 75/2019 “Për Rininë”

¹⁴Raport Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/2019 “Për Rininë” (2021). Fondacioni Konrad Adenauer dhe Kongresi Rinor Kombëtar. Gjetet në:

<https://mail.google.com/mail/u/0/#inbox/FMfcgzGtxSmrIFGmwdVvXKWmcTmsksx?projector=1&messagePartId=0.1>

¹⁵Bërdufi, D., & Pacukaj, S. (2022). Youth Political Participation in Conventional Forms in Albania 2011-2021. Academic Journal of Interdisciplinary Studies. ISSN 2281-3993. Vol.11. Nr.3

“Organizatat rinore të fokusohen në forcimin e marrëdhënieve të qëndrueshme dhe të besueshme me grupe të ndryshme të të rinjve dhe të kanalizojnë interesat, nevojat dhe kërkesat e tyre në vendimmarrje”.

Nëpërmjet trajnimeve dhe projekteve të tilla me fokus te fuqizimi i të rinjve dhe rritja e pjesëmarrjes së tyre në jetën qytetare dhe atë demokratike, të rinjtë mësojnë se sa e rëndësishme është që zëri i tyre të dëgjohet; se është e drejtë legjitime e gjithsecilit të ndihet i përfaqësuar në tryezën e vendimmarrjes dhe se janë hallkë kyçe për avancimin e sundimit të ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Krahas punës që bëjnë këto organizata për ndërgjegjësimin e të rinjve dhe fuqizimin e tyre në shoqëri, Raporti Kombëtar Rinia në Shqipëri 2020¹⁶ sugjeron se:

“Organizatrat rinore duhet të ushtrojnë më tepër presion dhe të krijojnë mekanizma të llogaridhënies dhe monitorimit të të zgjedhurve publikë, institucioneve të pushtetit vendor dhe atyre qendror për problemet dhe shqetësimet e rinisë”.

Një tjetër mekanizëm i rëndësishëm për të siguruar mbështetjen e nevojshme që të rinjtë të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë, duke marrë parasysh të drejtat e tyre, zërat dhe nevojat e ndryshme, është promovimi i programeve arsimore/edukative për ta, me qëllim përgatitjen dhe edukimin e tyre për t'u bërë qytetarë politikë aktivë, për të kuptuar më mirë procesin e politikave publike dhe procesin e vendimmarrjes. Zaimi (2023) sugjeron se:

*“Në shkollën e mesme nxënësit duhet të kenë të drejtën e përzgjedhjes së lëndëve me zgjedhje si: hyrje në drejtësi, të drejtat e njeriut, Shteti dhe Kushtetuta për të pasur mundësinë e të pasurit njohuri të përgjithshme për proceset demokratike dhe rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve në proceset publike”.*¹⁷

Institucionet arsimore janë vende ku pjesëmarrja e të rinjve jo vetëm që duhet të nxitet, por edhe të praktikohet, nëpërmjet dhënies së mundësive të barabarta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në struktura vendimmarrëse si qeveria e nxënësve, senati, këshilli studentor apo në aktivitete që nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje. Shumë i rëndësishëm është progresi arsimor i të rinjve dhe më tej, tranzicioni i tyre nga shkolla në tregun e punës. Në “Udhërrëfyesi Kombëtar për Tranzicionin e të Rinjve nga Shkolla në Vendin e Punës”¹⁸ theksohet se sa e rëndësishme është pjesëmarrja e vetë të rinjve në hartimin, zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe strategjive për nxitjen e punësimit, aftësimin dhe sipërmarrjes rinore. Janë të rinjtë ata që, duke mbajtur gjithmonë si themel të drejtat, përfaqësimin dhe lirinë e vendimmarrjes, duhet të kërkojnë informacion me cilësi, këshillim karriere dhe qasje në mundësi punësimi.

Së fundmi, duhet përmendur pa diskutim përdorimi i platformave online, si një hapësirë që të rinjtë të shprehin mendimet dhe pasionet e tyre, të lidhen me organizata dhe grupe me inte-

¹⁶Raporti Kombëtar Rinia në Shqipëri 2020. CRCA/ECPAT. Gjetet në: https://www.crca.al/wp-content/uploads/2022/10/RAPORTI-TE-RINJTE-NE-SHIQIPERI-2019-2020_0-1.pdf

¹⁷Zaimi A. (2023). Participation of Citizens in Decision-Making Process: Albanian Case. Tezë e dorëzuar për marrjen e titullit Doktor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Universiteti Epoka. Gjetet në: <http://dspace.epoka.edu.al/bitstream/handle/1/2274/Al%20Zaimi.pdf?sequence=1>

¹⁸Udhërrëfyesi Kombëtar për Tranzicionin e të Rinjve nga Shkolla në Vendin e Punës (2022). Gjetet në:

<https://krk.al/wp-content/uploads/2023/04/UDHERREFYESI-KOMBETAR-PER-TRANZICIONIN-E-TE-RINJVE-NGA-SHKOLLA-NE-VENDIN-E-PUNES-2-1.pdf>

resa të përbashkëta, si dhe të kontribuojnë në debatin shoqëror e politik. Një ndër nismat në vendin tonë, është ngritja e këndeve digjitale të informimit rinor (info points). Në vitin 2022, vetëm 3.27% e bashkive raportuan ngritjen e këtyre këndeve dhe SKR29 synon ngritjen e tyre në të gjitha bashkitë e vendit. Krahasuar me burimet tradicionale, Oden dhe Porter (2023) gjejnë një marrëdhënie pozitive më të fortë midis përdorimit të medias sociale dhe interesimit politik e angazhimit qytetar të të rinjtë¹⁹. Bazuar në eksperiencën e vendeve të tjera, duke punuar ngushtësisht me konventat ndërkombëtare dhe duke garantuar zbatimin e akteve ligjore në lidhje me përfshirjen e të rinjve në shoqëri dhe në vendimmarrje, shoqëria shqiptare përqafoi frymën dhe perspektivat rinore, të cilat potencialisht çojnë drejt ndryshimeve pozitive për komunitetet vendore dhe mbarë shoqërinë.

Analiza legislative dhe mekanizmat institucionalë për pjesëmarrjen e të rinjve: të drejtat dhe drejtësia

Pjesëmarrja e të rinjve është domosdoshmëri për të qenë pjesë e qartë e mekanizmit legjislativ dhe institucional në vendin tonë. Edhe pse marrim në konsideratë se një legjislacion i mirë nuk është i vetmi faktor i zhvillimit të duhur dhe arritjeve të politikave të kërkuara bashkëkohore, do të ishte një hap më domethënës për të shkuar drejt rezultateve më të suksesshme të pjesëmarrjes së të rinjve.

Çfarë kemi parasysh kur vendosim 'pjesëmarrjen e fëmijëve/të rinjve' në kuadër të legjislacionit shqiptar? ²⁰ :

- Grupet e fëmijëve/të rinjve marrin pjesë në mbledhjet e këshillave bashkiakë.
- Fëmijët/të rinjtë dëgjohen para, gjatë hartimit, si dhe gjatë fazës së zbatimit të buxhetit.
- Grupet e fëmijëve/ të rinjve, nëpërmjet pyetësorëve, seminareve dhe takimeve, pyeten nga përfaqësues të pushtetit vendor mbi nevojat dhe çështjet që i shqetësojnë.
- Të rinjtë/ fëmijët mund të hartojnë peticione apo letra publike drejtuar organeve të qeverisjes vendore.
- Të rinjtë/fëmijët japin mendime gjatë hartimit të politikave në nivel vendor që lidhen me të drejtat, sigurinë dhe mirëqenien.
- Pjesëmarrja e fëmijëve/të rinjve krijon një mjedis ku ata ndihen të vlerësuar.
- Pjesëmarrja e të rinjve forcon demokracinë dhe ndjenjën e përgjegjësisë në një shoqëri demokratike.
- Fëmijët/të rinjtë i njohin më mirë problemet e tyre dhe mund t'i ndihmojnë organet vendore për të përcaktuar çështjet që kanë përparësi.
- Fëmijët/të rinjtë nxiten të jenë aktivë dhe orientohen që t'i drejtohen pushtetit vendor për problemet dhe nevojat e tyre.
- Fëmijëve/të rinjve duhet t'u jepet mundësia të ndjekin nga afër se si përdoren fondet.
- Zhvillohet një rrjet më i fuqishëm ndërmjet pushtetit vendor, ofruesit të shërbimeve dhe fëmijëve/të rinjve.

¹⁹Oden, A., & Porter, L. (2023). The Kids Are Online: Teen Social Media Use, Civic Engagement, and Affective Polarization. *Social Media+ Society*, 9(3), 20563051231186364.

²⁰E konceptuar jo si një listë shteruese.

Në kuadër të këtij studimi, ne e shohim pjesëmarrjen dhe qytetarinë aktive si një disponim i së drejtës, mjeteve, hapësirës dhe mundësisë, dhe kur është e mundur, të disponohet edhe mbështetja për të marrë pjesë për të ndikuar në vendimmarrje, e për t'u përfshirë në nisma për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të mirë. Pjesëmarrja e të rinjve është një çështje moderne e shoqërisë. Ende ka shoqëri dhe vende, përfshi edhe Shqipërinë, ku pjesëmarrja e të rinjve shihet më shumë si lëmoshë sesa si një çështje e rëndësishme e qëndrueshmërisë së demokracisë dhe formimit që në moshë të hershme të drejtuesve të ardhshëm.

Edhe në aspektin studimor dhe atë ligjor kjo çështje mbetet ende e re, duke lënë hapësirë të konsiderueshme për të eksploruar dhe propozuar zhvillime të mëtejshme. Studimet në fushën e ligjit, apo edhe më gjerë, mbeten të kufizuara dhe ende mungojnë meta-analizat shoqërore të ndikimit pozitiv që ka pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve në vendimmarrje dhe politikë. Është pikërisht kjo arsyeja që mundësitë dhe edukimi për pjesëmarrje fillon që me edukimin e hershëm të fëmijëve dhe të rinjve për të marrë pjesë në çdo demokraci aspiruese, dhe veçanërisht në ato vende që janë tashmë të bindura se janë demokratike. Ndonëse Shqipëria ka bërë hapa përpara në drejtim të demokratizimit të jetës së saj politike, pas rrëzimit të sistemit komunist, këto hapa nuk janë shoqëruar me nisma ligjore për të mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve. Megjithatë, Shqipëria ka ndërtuar një imazh publik pozitiv në drejtim të përgatitjes së politikave kombëtare për të rinjtë, përfshi edhe pjesëmarrjen e tyre në politikë dhe vendimmarrje.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke shërbyer si akti themeltar i vendit, parashikon disa të drejta të rëndësishme që lidhen me pjesëmarrjen e të rinjve, si e drejta e organizimit, e zgjedhjes, e shoqërimit, e fjalës dhe e shprehjes së lirë. Dimensionet demokratike të përfshirjes, të pjesëmarrjes në ndërtimin dhe përmirësimin e demokracisë, Kushtetuta jonë i paraqet që në preambulën e saj.

Edhe pse e nënkuptuar në këtë moment deklarativ kushtetues, mund të themi se ky akt promovon pjesëmarrjen dhe përfshirjen e qytetarëve në zhvillimin demokratik të vendit. Ky moment frymëzues është më se i mjaftueshëm për t'i hapur rrugë parashikimeve kushtetuese dhe ligjeve të tjera. Në përgjithësi, preambulat e kushtetutave evropiane nuk kanë të përfshirë në mënyrë eksplicite pjesëmarrjen e të rinjve, por përmbajnë fjali me funksion inkurajues, duke krijuar lidhjen e qytetarit me shtetin.²¹

Fëmijët dhe të rinjtë vendosen si një prej kategorive 'të preferuara' të Kushtetutës, duke i hapur rrugë legjislatorit apo, në njëfarë mënyre, duke e detyruar që ta konceptojë dhe zhvillojë legjislacionin duke respektuar në mënyrë thelbësore këtë parim. Në përgjithësi, ligjet që aplikojnë të drejta apo detyrime që lidhen me fëmijët e të rinjtë e përmendin këtë aspekt preferencial që në nenet e para, duke u bërë pjesë e objektivave dhe qëllimeve legjislative apo dhe akteve dytësore.

²¹P.sh., Kushtetuta e Republikës Çeke ka në preambulë '... qytetarët – përgjegjësia e tyre ndaj komunitetit....', duke e paraqitur pjesëmarrjen përtej së drejtës, edhe si një detyrë. <https://www.psp.cz/en/docs/laws/1993/1.html>

Në përfundim, mund të themi se Kushtetuta jonë eksploron dhe vendos shinat kryesore për pjesëmarrjen e të rinjve duke u ofruar mbrojtje specifike nga shteti, si dhe duke ofruar instrumentet dhe parimet kryesore demokratike për këtë aspekt. Duke shërbyer si korniza kryesore e projektimit të shtyllave kryesore demokratike, ky akt flet dhe eksploron mjaftueshëm për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, duke i lënë legjislacionit shqiptar detyrën e hollësive dhe rregullimeve sipas fushave përkatëse. Në këtë kuadër, modeli i Kushtetutës sonë vjen me të njëjtën linjë modelimi si një pjesë e mirë e kushtetutave evropiane (italiane, austriake, çeke, gjermane, etj).

Ligji për rininë

Ndërsa ligjet e tjera përcaktojnë elementë dhe dimensione të pjesëmarrjes së të rinjve, ligji specifik që parashikon pjesëmarrjen e të rinjve është Ligji për Rininë, i cili hyri në fuqi në nëntor 2019. Edhe pse një ligj i miratuar ‘relativisht vonë’, me nxitjen e shoqërisë civile dhe me propozimin e Këshilli të Ministrave, ligji është adresa kryesore që ofron të drejtat për të rinjtë, si dhe institucionet e mekanizmat e tjerë.

Edhe pse ligjet shkruhen me ‘rrethana dhe tone më favorizuese’ për fëmijët dhe të rinjtë, zhvillimi psikosocial i fëmijëve dhe të rinjve ka karakteristika të ndryshme. Në këtë mënyrë ligji për të rinjtë i drejtohet vetëm të rinjve nga mosha 15 deri në 29 vjeç. Ligji për të drejtat e fëmijëve aplikohet për personat nën moshën 18 vjeç. Pra, në varësi të moshës, ligji që na mbron, që prodhon të drejta e detyrime është:

Mosha	Term	Ligji
0-18 vjeç	Fëmijë	Ligji për të drejtat e fëmijëve
15-29 vjeç	I ri	Ligji për rininë

Ligji për rininë, edhe pse i ri në kohë, sjell një mekanizëm të ri legjislativ dhe organizativ të mundësive për të rinjtë, në mënyrë që ata të jenë pjesë e vendimmarrjes. Fuqizimi i rolit të tyre në jetën shoqërore dhe politike mbetet një objektiv thelbësor i ligjit. Ligji që në fillim e pozicionon pjesëmarrjen e të rinjve si një përmasë gjithëpërfshirëse, duke cituar se objekti i tij është mbrojtja e të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.²² Kështu, elementët e mëposhtëm mbeten ‘imponues’ sa i përket realizimit të pjesëmarrjes:

- Mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse;
- Krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve;
- Përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor;
- Bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.

²²Neni 1 Ligji ‘Për rininë’.

3 Mekanizmat që ofron ligji për rininë

Nr. Struktura	Parashikimi ligjor	Funksionimi
1. Ministria e Shtetit për Rininë	Pjesë e kabinetit të Kryeministrit përgjegjës për zhvillimin e politikave rinore dhe për zbatimin e tyre.	Aktualisht ka një ministre dhe një staf prej 4-5 vetash në strukturë.
2. Agjencia Kombëtare për Rininë (AKR)	Institucion në varësi të Ministrit të Shtetit për Rininë, përgjegjës për koordinimin e mëtejshëm të zbatimit dhe zhvillimit të politikave rinore në vend.	Institucion me seli në Tiranë dhe me koordinatore (pjesërisht) nëpër qytete të vendit. Gjatë trajnimeve në 8 qarqe të vendit në qershor 2023, rezultoi se nga 250 pjesëmarrës, rreth 90% shprehnin se kishin më pak informacion për AKR-në.
3. Organizata Rinore	70 për qind e anëtarëve të tyre të jenë të rinj dhe të luajnë rolin e OJF-ve sipas legjislacionit shqiptar.	Në faqet e internetit të AKR-së dhe të Ministrisë ka informacion të vakët mbi transparencën e listës së organizatave që gëzojnë këtë status. ²³
4. Organizata për të Rinjtë	OJF që gëzojnë këtë status sipas legjislacionit në fuqi dhe që gjatë 3 viteve të fundit të kenë zbatuar projekte që lidhen me të rinjtë dhe zhvillimin e tyre.	E njëjta situatë si me organizatat rinore.
5. Puna rinore	Formë e vullnetarizmit që krijon mundësinë për t'u konvertuar në kredite njohëse në arsim apo në punë.	Ende nuk është ngritur zyrtarisht një mekanizëm që ta qartësojë këtë dimension dhe ta vendosë në zbatim për të rinjtë.
6. Organizata përfaqësuese rinore	Organizatat rinore dhe ato për të rinjtë zgjedhin përfaqësinë e tyre.	Pavarësisht se gjatë vitit 2021 u hap dy herë thirrja për të aplikuar dhe mundësuar krijimin e kësaj organizate, nuk pati interes nga aktorë shqiptarë për ta themeluar atë. Bazuar në diskutimet dhe grupet e fokusuar me aktorë të organizatave rinore, ata u shprehën se nga ana procedurale është shumë e vështirë të bashkojnë vullnetet e 60 organizatave rinore dhe se praktikisht kompetencat dhe funksionet e saj nuk janë të qarta në ligjin për rininë. ²⁴
7. Kongresi Rinor Kombëtar	Një grupim prej 30 organizatash rinore.	Kujdes! Jo Organizata Përfaqësuese Rinore.
8. Këshilli Kombëtar Rinor	Organ Këshillimor që funksionon pranë ministrit dhe Këshillit të Ministrave për përcaktimin e politikave rinore.	Aktualisht është hapur thirrja për aplikim dhe formimin e këtij Këshilli ²⁵ . Deri tani ky organ nuk është ndërtuar sipas kërkesave të ligjit.
9. Këshilli Vendor për Rininë	Për efekt koordinimi, përbëhet nga stafet në qarqet/bashkitë kryesore.	Jo ekzistuese si strukturë, në pritje pas përzgjedhjes së mekanizmit të mësipërm.

²³ SShih <https://rinia.gov.al/keshilli-kombetar-rinor/>

²⁴ Raport i Kongresit Rinor Kombëtar IMPLEMENTIMI I LIGJIT PËR RININË, PERCEPTIMI I TË RINJVE DHE OSHC-ve, DHJETOR 2022, Autorë: Dafina PEÇI, Enxhi LIPA, Rigels XHEMOLLARI, https://krk.al/wp-content/uploads/2023/02/Raporti_KAS_2022_Final.pdf

²⁵ <https://rinia.gov.al/hapen-votimet-per-anetaret-e-keshillit-kombetar-te-rinise/>

Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj (konteksti ndërkombëtar)

Pjesëmarrja e të rinjve, ashtu si një pjesë e mirë e kërkesave të zhvillimeve demokratike për vendin tonë, nuk funksionon në mënyrë të mëvetëshme nga mjedisi ndërkombëtar, evropian dhe ai rajonal. Shqipëria është pjesë e një serë aktesh ndërkombëtare, të cilat funksionojnë si një emërues i përbashkët i zotimeve të shteteve ndaj krijimit të mundësive dhe hapësirave për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje, komunitet e më gjerë.

Përtej trajtimit të pjesëmarrjes si një e drejtë themelore e fëmijëve, OKB-ja e ka ngritur pjesëmarrjen e të rinjve në një nivel të rëndësishëm përmes miratimit të Rezolutës për përfshirjen e të rinjve.²⁶ Kjo Rezolutë thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në zhvillimin e vendeve dhe botës, por njëkohësisht i 'detyron' shtetet anëtare që planet e tyre të zhvillimit t'i koordinojnë me të njëjtën frymë të përcjellë nga Kombet e Bashkuara, duke fuqizuar kështu nismat jo vetëm në planin kombëtar, por dhe në atë rajonal e botëror.

Agjencitë e Kombeve të Bashkuara (UNICEF, UNESCO, UNHCR), në varësi të fushave të tyre të kompetencës, e përfshijnë pjesëmarrjen e fëmijëve/të rinjve si një element thelbësor, si p.sh., përfshirja e tyre në menaxhimin e migracionit, mbrojtjen e objekteve kulturore, etj.

Edhe pse, sipas mendimit tonë, parashikimet e OKB-së mbi pjesëmarrjen e fëmijëve/të rinjve mund të flisnin me tone më të qarta sa i përket vendimmarrjes, politikave dhe nismave, fakti që kjo organizatë e ngre pjesëmarrjen e fëmijëve/të rinjve si një kauzë globale, nxit shtetet anëtare që të ecin sipas perspektivave të përbashkëta.

Këshilli i Evropës, si një strukturë tjetër e rëndësishme që mbron të drejtat dhe liritë themelore të individit në kontinentin evropian, nuk shprehet ekskluzivisht për të rinjtë, por në nenin 11 rithekson detyrimin e shteteve anëtare për të respektuar lirinë e tubimeve paqësore dhe protestave.²⁷ Këshilli i Evropës mbetet sot për sot e vetmja strukturë ndërkombëtare/evropiane që ka trajtuar përmes një dokumenti specifik pjesëmarrjen e të rinjve në komunitetet vendore dhe rajonale.²⁸

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) fut nën ombrellën e saj vetëm një dimension të pjesëmarrjes, atë të tubimeve dhe protestave paqësore. Gjithsesi, përmbajtja e KEDNJ-së është miqësore për përfshirjen e qytetarëve në çështje që lidhen me ta.

Karta e Pjesëmarrjes së të Rinjve në jetën e pushtetit vendor, e prodhuar më 21 maj 2003 nga Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale, detyron të gjithë strukturat e pushtetit vendor në shtetet anëtare që të përfshijnë të rinjtë në secilën fushë zhvillimi dhe politikë të tyre sektoriale. Ky detyrim është edhe për vendin tonë, si një prej vendeve anëtare të Këshillit të Evropës. Një tjetër formë unike e pjesëmarrjes së të rinjve në Kongresin e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale është aplikimi përmes 'Youth delegate programme', i cili të jep mundësinë që për një vit të trajnohesh dhe të vësh në zbatim një projekt që fuqizon rininë dhe pjesëmarrjen në pushtetin vendor. Theksojmë këtu se një përfaqësi e zgjedhur nga pushteti vendor në Shqipëri merr pjesë në sesionet vjetore dhe periodike të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale duke pasur

²⁶<https://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-participation.pdf> <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N03/502/56/PDF/N0350256.pdf?OpenElement>

²⁷Shqipëria u bë pjesë e Konventës Ligj nr. 8137, datë 31.7.1996, shih nenin 11 të Konventës https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sq

²⁸European Charter on the Participation of Young People in Local and Regional Communities <https://rm.coe.int/168071b4d6>, miratuar nga një organ i Këshillit të Evropës

– Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale.

²⁸Shih këtu për më shumë info <https://www.coe.int/en/web/congress/youth-delegates>

detyrimin për të raportuar për marrjen e masave lidhur me zhvillimet përkatëse të politikave rinore, pjesëmarrjes së të rinjve dhe aktivizmin publik.²⁹

Këshilli i Evropës e ka vendosur pjesëmarrjen e të rinjve si një nga prioritetet kryesore të politikave të miratuara për periudhën 2022-2025.³⁰ Kjo përputhet me rëndësinë që dokumentet ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe ato rajonale, kanë në ndërtimin dhe zbatimin e perspektivave të përbashkëta. Këto dokumente ndihmojnë në krijimin e harmonizimit të koncepteve në shtetet anëtare, duke përdorur strukturat e tyre përkatëse për të zbatuar lehtësirat reale që e bëjnë të mundur pjesëmarrjen e të rinjve për të drejtat e tyre dhe të komunitetit pjesë e të cilit janë.

Edhe pse aktet e Bashkimit Evropian nuk janë ende të detyrueshme për t'u zbatuar nga aktorët tanë shtetërorë, në kuadër të procesit të integritit në këtë strukturë, është e rëndësishme të sjellim në vëmendje të këtij punimi se pjesëmarrja e të rinjve është një nga objektivat kryesore të vendosura në Strategjinë Evropiane për të Rinjtë.³¹

Krahas planit ndërkombëtar dhe atij evropian, pjesëmarrja e të rinjve trajtohet edhe në shumë forume apo konferenca joshetërore në mjedisin e Ballkanit Perëndimor, p.sh., Regional Cooperation Council (Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit) ka si pjesë të agjendës pjesëmarrjen e të rinjve dhe fuqizimin e përfshirjes rinore në vendimmarrje.

Larmia e dokumenteve ndërkombëtarë merr ngjyrimë gati të pafundme kur bëhet fjalë për të rinjtë dhe pjesëmarrjen e tyre. Më poshtë do të sjellim disa aspekte kryesore të zotimeve konkrete të shtetit shqiptar për të kontribuar për fuqizimin e të rinjve në vendimmarrje.

Përfaqësimi i të rinjve në jetën politike dhe veçanërisht në strukturat e qeverisjes vendore

Pjesëmarrja e të rinjve, përpara se të jetë aspekt i pushtetit qendror, është çështje e përditshme e pushtetit vendor. Në këtë kuadër, bashkitë e vendit prej disa vitesh kanë futur si pjesë të kulturës së tyre përcaktimin e politikave rinore në Planet e Përgjithshme Vjetore, si dhe buxhet specifik për të rinjtë (kjo e detyrueshme sipas përcaktimit të ligjit për vetëqeverisjen vendore). Përtej këtyre aspekteve, me financimin e Fondacionit Friedrich Ebert, Kongresi Rinor Kombëtar ka menaxhuar hartimin e 12 Planeve Vendore të Veprimit për Rininë 2020-2023.³² Është e rekomandueshme që këto plane t'u komunikohen dhe prezantohen sa më shpesh të rinjve të komunitetit, me qëllim që të jenë ata vetë që do t'i menaxhojnë parashikimet e Planit Vendor. Këto plane vendore janë të publikuara në faqen e Fondacionit dhe atë të Kongresit Rinor Kombëtar, duke qenë të arritshme nga të gjithë në gjuhën shqipe.

Përfaqësimi i të rinjve në jetën politike dhe sidomos në strukturat e qeverisjes vendore mbetet në nivele tepër të ulëta. Përfaqësimi i tyre në këto struktura bëhet jo sipas ligjeve apo vendimeve në fuqi, por, në shumicën e rasteve, sipas njohjeve personale apo "dëshirës së mirë dhe vullnetit" të drejtuesve partiakë. Pushteti vendor nuk nxjerr akte specifike për ligjin për

²⁹ Shih <https://www.coe.int/en/web/european-youth-foundation/council-of-europe-priorities>

³⁰ https://youth.europa.eu/strategy/european-youth-goals_en

³² Shih p.sh., https://krk.al/wp-content/uploads/2020/10/Plani_lokal_i_veprimit_per_rinine_2020-2023_Diber.pdf

rininë, gjithësesi bashkitë janë të përfshira në vendosjen e zërave të buxhetit, si dhe në zbatimin e vendimeve që lidhen edhe me aspekte të tjera për fëmijët dhe të rinjtë. Të rinjtë kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak, por ende sot ky instrument shihet si i vakët për të realizuar pjesëmarrjen e tyre domethënëse.

Përgjithësisht, roli i pushtetit vendor është nxjerrja e akteve që rregullojnë hapësirat e gjelbra, argëtimet për të rinjtë dhe aktivitete që lidhen me to. Dy aspekte kryesore që burojnë nga pushteti vendor janë: ndarja e buxhetit për rininë dhe vendosja e rinisë si përparësi në aktet e tyre të brendshme. Ndarja e fondeve publike nga bashkia për të rinjtë është një sektor ku organizatat e shoqërisë civile kanë kontribuar më shumë, me qëllim rritjen e kapaciteteve financiare për të rinjtë në komunitetet vendore.


Në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian 'Bashkitë për në Evropë', sot në një pjesë të konsiderueshme të bashkive të vendit funksionon Këndi i BE-së (EU Corner), që pjesën më të madhe të aktiviteteve e orienton ndaj të rinjve.³³

V. Gjetjet e studimit dhe analiza

Seksioni I - Të dhëna demografike


Studimi përfshiu një kampion prej 650 të rinjsh e të rejash të grupmoshave 15–19 vjeç dhe 20–24 vjeç. Grupmosha 15-19 vjeç zë përqindjen më të lartë të të anketuarve, në total 60%, dhe 40% e të anketuarve i takojnë grupmoshës 20-24 vjeç (Figura 1). Nga pyetëtori rezulton se përqindja më e lartë e të anketuarve përbëhet nga gjinia femërore, përkatësisht 63% e numrit total të të anketuarve, përkundrajt 37% të cilët i takojnë gjinisë mashkullore (Figura 2). Në Figurën 3 paraqitet shpërndarja e të anketuarve në nivel qarku. Vendin e parë e zë Tirana me 167 përgjigje. Në vend të dytë renditet Elbasani me 107, ndjekur nga Fieri me 90 përgjigje.

1 Kampioni- grupmoshë (%)



15-19 vjeç 20-24 vjeç


2 Kampioni-gjini (%)



Femër Mashkull

³³Shih <https://www.bpe.al/a/kendi-be>

3 Kampioni- qark (%)



Për sa i përket përkatësisë etnike të të rinjve që i janë përgjigjur pyetësorit, 92% deklarojnë se janë shqiptarë, 4% i përkasin komunitetit rom dhe 4% komunitetit egjiptian. Një pjesë e mirë e këtyre të rinjve e të rejave ndjekin arsimin parauniversitar (45%), 31% janë duke ndjekur studimet e larta, 16% janë të punësuar dhe 2% ndjekin arsimin profesional. 6% e të anketuarve deklarojnë se nuk janë duke ndjekur studimet dhe as nuk janë duke punuar.

Për përmbushjen e qëllimit të këtij studimi dhe për interpretim të mëtejshëm të rezultateve të pyetësorit, u realizuan 11 fokus grupe në rang kombëtar në qytete të tilla si Tiranë, Korçë, Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Berat, Elbasan, Fier dhe Vlorë, ku morën pjesë 100 të rinj e të reja të moshës 15-24 vjeç, të cilët ndanë mendimet dhe botëkuptimet e tyre tepër të vlefshme për rezultatet dhe rekomandimet e këtij studimi. Shpërndarja e kampionit sipas kriterëve ishte:

15-19 vjeç – 77%

20-24 vjeç – 23%

Vajza – 69%

Djem – 31%

Zona rurale – 26%

Komuniteti Rom/Egjiptian – 7%



Seksioni II – Pjesëmarrja e të rinjve - Aktivizmi publik dhe demokracia

Një shoqëri ku aktivizmi publik dhe demokracia janë të forta ka më shumë mundësi për zhvillim të qëndrueshëm dhe përmbushje të nevojave e aspiratave të qytetarëve të saj. Aktivizmi publik dhe demokracia janë thelbësore për të rinjtë, sepse i përgatisin ata për të marrë pjesë në një

shoqëri të hapur dhe për t'u ndier të përfshirë. Këto vlera nguliten në ndërgjegjen e tyre qytetare dhe ndikojnë në formimin e tyre si individë aktivë dhe përgjegjës në shoqëri.

Megjithatë, të rinjtë në vendin tonë janë indiferentë kur bëhet fjalë për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe rreth 63% e të anketuarve e pohojnë sa më sipër. Kjo e dhënë përputhet me studimin "Angazhimi Politik në Shqipëri 2020", ku cilësohet se të rinjtë në Shqipëri raportojnë nivelin më të ulët të njohurive dhe interesit për politikën. Sipas të dhënave nga pyetësi dhe fokus grupet me të rinjtë, indiferentizmi lidhet me faktin se vetëm 39% e të rinjve ndihen të përfaqësuar në organet vendimmarrëse dhe rreth 60% e tyre nuk janë të sigurtë nëse pjesëmarrja e tyre do të ndikonte në vendime më demokratike. Si rrjedhojë, 79% e tyre shprehen se janë të distancuar nga partitë politike, ndërsa vetëm 9% deklarojnë se janë të angazhuar në grupime politike. Gjatë fokus grupeve, vetë të rinjtë e qyteteve të ndryshme shprehen se indiferentizmi i tyre vjen si pasojë e mosbesimit se çështjet që ata ngrenë trajtohen, ose e zhgënjimit të përjetuar pas përfshirjes dhe mosmarrjes në konsideratë të mendimeve e opinioneve të tyre. Të zhgënjyer nga politika dhe me ndjesinë se thirren në takime sa për të "mbushur karriget", ata zgjedhin të distancohen dhe bëhen indiferentë kur bëhet fjalë për të marrë pjesë në vendimmarrje. Gjatë fokus grupit në Shkodër, një djalë 23 vjeçar nga komuniteti egjiptian shprehet:

"Kam pasur shumë herë ftesa për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme. Fillimisht kam marrë pjesë, por kam vënë re se fjala ime nuk është dëgjuar dhe kam qenë aty vetëm për të mbushur sallën, ndaj dhe nuk marr më pjesë, pasi kam kuptuar se nuk ndihem i përfshirë apo i dëgjuar."

Ndonëse të rinjtë kanë dijeni mbi organet vendimmarrëse në nivel qendror dhe vendor ku mund të jenë pjesë, pjesa dërrmuese e tyre shprehen se kanë pasur mundësi dhe kanë qenë të angazhuar më shumë në strukturat e shkollës, si qeveria e nxënësve apo këshilli studentor. 34.3% e tyre deklarojnë se kanë qenë pjesë e senatit të shkollës, 13.4% kanë qenë të angazhuar në qeverinë studentore, 10.8% kanë qenë pjesë e Këshillit Rinor Vendor dhe pak kanë qenë të angazhuar në këshilla bashkiakë apo pranë Kongresit Rinor Kombëtar. Ajo që vlen për t'u theksuar është se rreth 31% e të rinjve nuk kanë qenë të angazhuar në asnjë prej organeve vendimmarrëse.

Bazuar në fokus grupet e ngritura me të rinjtë, vihet re se në 8 qarqe, shkolla dhe OJF-të rezultojnë si hapësirat kryesore ku ata mund të angazhohen. Në qytetet e Lezhës dhe Shkodrës, OJF-të janë shumë aktive sipas të rinjve, KVR-të përmenden në Durrës dhe Dibër, ndërsa në Bashkinë Fier përmendet qendra multifunksionale dedikuar të rinjve. Nga diskutimi në fokus grupin e Tiranës, rezulton se të rinjtë nuk kanë hapësira, përpos angazhimit pranë institucioneve arsimore ku janë pjesë. Për një qytet të madh e dinamik si Tirana është e rëndësishme shpërndarja e informacionit dhe informimi mbi hapësirat dedikuar të rinjve dhe punës/projekteve që organizata të ndryshme realizojnë me ta.

Për sa i takon pjesëmarrjes së të rinjve në organizata rinore, 71% e të anketuarve deklarojnë se nuk janë të angazhuar dhe vetëm 29% janë pjesë e aktiviteteve të këtyre organizatave. Por, sikurse tregohet edhe në Figurën 4, shumica e të rinjve tanë kanë dëshirë dhe janë të gatshëm të marrin pjesë në organizata rinore apo struktura të tjera vendimmarrëse për të rinjtë.

³⁴https://www.ndi.org/sites/default/files/Albania%20Political%20Engagement%20Survey%202020_Albanian.pdf

Në fokus grupin e realizuar në qytetin e Korçës, një i ri 24 vjeçar shprehet:


“Do të kisha shumë dëshirë të bëhesha pjesë në struktura vendimmarrëse rinore, por nuk ka asnjë mundësi për t’u angazhuar, pasi nuk ka drejtësi në përzgjedhje”.

Seksioni III. Pjesëmarrja dhe Angazhimi në Komunitet

Pjesëmarrja aktive e të rinjve në aktivitete komunitare nxit zhvillimin e aftësive sociale, ndërgjegjësimin dhe krijimin e lidhjeve të forta mes njerëzve. Ajo mund të luajnë një rol kyç në zgjidhjen e sfidave dhe problematikave vendore, duke sjellë ide novatore dhe energji pozitive. Në këtë mënyrë, të rinjtë bëhen një forcë e pashmangshme për përparimin dhe mirëqenien e

komunitetit në tërësi. Një rol të madh për ndërgjegjësimin e të rinjve mbi rëndësinë e të qenit qytetarë aktivë luajnë institucionet që bashkëpunojnë me ta, organizatat e ndryshme joqeveritare dhe qendrat rinore, fokusi i të cilave është fuqizimi i të rinjve dhe rritja e pjesëmarrjes së tyre në jetën qytetare dhe atë demokratike.

Sipas të rinjve, strukturat më aktive në komunitetin e tyre janë shkollat, qendrat rinore, grupet rinore joformale dhe OJF-të, pasuar nga bashkia, institucionet fetare, forumet politike, etj. (Figura 7).



4 Strukturat më aktive me të rinjtë në komunitet

Sakaq, të pyetur edhe se cilin prej institucioneve preferojnë të frekuentojnë më shumë, shkolla zë po vendin e parë, pasuar nga qendrat rinore dhe organizatat e shoqërisë civile. Prandaj, është shumë i rëndësishëm angazhimi i institucioneve arsimore dhe qendrave rinore për gjithëpërfshirjen e të rinjve në shoqëri dhe komunitet, pa dallime me bazë gjinore, etnike, fetare, origjine apo statusi ekonomik. Megjithatë, vihet re një mungesë informacioni dhe ndërgjegjësimi masiv për sa i takon pjesëmarrjes, sidomos në Berat, Dibër, Kukës, Lezhë, Tiranë, Vlorë dhe Durrës. Të rinjtë e fokus grupeve nuk ngurojnë të shprehen se nuk kanë informacion për aktivitetet, strukturat vendimmarrëse apo format se si mund të angazhohen.


Për sa u përket aktiviteteve më të shpeshta të organizuara në komunitet, aktivitetet sportive, kulturore dhe argëtuese janë ato që ofrohen më së shumti për të rinjtë, kryesisht të organizuara nga shkolla. Ndërsa, të pyetur se sa të përfshirë ndihen në këto aktivitete, 30% e tyre shprehen se nuk mendojnë se roli i tyre ka ndonjë ndikim, një përqindje kjo e lartë dhe që kërkon vëmendje më të madhe nga gjithë aktorët e përfshirë në punën me të rinjtë, për të rritur motivimin dhe shpresën se mund të sjellin ndryshim përmes veprimeve të tyre.

Po ashtu, pavarësisht angazhimit të të rinjve në aktivitetet që ofrohen në komunitet, në disa qytete si Vloza, Korça dhe Elbasani, të rinjtë në fokus grupe u shprehën se shumica e temave që trajtohen janë jo aktuale, aktivitetet që ofrohen janë jo argëtuese dhe jo gjithëpërfshirëse për të rinjtë, ndaj ata nuk angazhohen apo janë indiferentë.

Referuar aspektit gjinor, 53% e të rinjve deklarojnë se në komunitetin ku jetojnë, edhe djemtë edhe vajzat janë njësoj të angazhuar; përkundrajt 23% që besojnë se janë djemtë ata që angazhohen më shumë, ndërsa 24% shikojnë vajzat si më të angazhuara në komunitet. Edhe pse në fokus grupe, shumica e të rinjve pohuan se vajzat janë më aktive në aktivitete sociale e komunitare dhe rekomanduan nevojën për përfshirje dhe motivim më të madh të djemve për t'u angazhuar dhe kontribuar në komunitet.

Nga bisedat me të rinjtë në fokus grupe, u shpreh qartazi nevoja dhe dëshira e tyre për të qenë aktivë dhe për të ndërmarrë nisma komunitare, si dhe për t'u mbështetur moralisht, teknikisht dhe financiarisht nga institucionet vendore (bashkia), shkolla, familja, OJF-të dhe bizneset në ndërmarrjen e këtyre nismave.

Pavarësisht gjithë pengesave dhe vështirësive që hasin për sa i përket angazhimit komunitar, një pjesë e konsiderueshme e të rinjve (41%) besojnë plotësisht që institucionet që punojnë me ta mund të sjellin ndryshime reale në komunitet (Figura 5).




5 Besimi se “institucionet që punojnë me të rinjtë mund të sjellin ndryshime reale”

Seksioni IV. Pjesëmarrja dhe Angazhimi në Edukim


Institucionet arsimore janë vende ku pjesëmarrja e të rinjve jo vetëm që duhet të nxitet, por edhe të praktikohet, nëpërmjet dhënies së mundësive të barabarta për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në struktura vendimmarrëse si qeveria e nxënësve, senati apo këshilli studentor, apo aktiviteteve që nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje.

Të pyetur nëse kanë pasur mundësi të barabarta për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në struktura vendimmarrëse në institucionet arsimore ku kanë qenë ose ku bëjnë pjesë, 62% e të rinjve e kanë pasur këtë mundësi. Më tej, 56% e të rinjve deklarojnë se në shkollat e tyre ka pasur aktivitete që nxisin ekskluzivisht pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje (Figura 6).



6 Aktivitete në shkollë që nxisin pjesëmarrjen e të rinjve

Teksa u pyetën në lidhje me nivelin e përfaqësimit nga strukturat në shkollë/universitet, vetëm 28% e të rinjve ndihen/janë ndier tërësisht të përfaqësuar nga këto struktura (Figura 7).




7 Sa të përfaqësuar ndihen të rinjtë në strukturat e shkollës

Referuar edhe diskutimeve gjatë fokus grupeve, sidomos në qytetet e Beratit, Elbasanit dhe Kukësit, shumica e të rinjve nuk ndihen të përfaqësuar, lidhur më së shumti me përfaqësimin në shkollë, në senat dhe në KVR. Të rinjtë i kanë cilësuar ato si struktura formale, jo funksionale dhe ku nuk ka barazi dhe meritokraci në përzgjedhje apo konkurrencë të drejtë. 17 vjeçarja nga Kukësi shprehet:

“Prej dy vitesh kam qenë pjesë e senatit të shkollës, i cili është tërësisht jo funksional. Nisur nga eksperiencia personale, nuk kam dëshirë të angazhohem më, sepse nuk ka pasur asnjë nismë që ne si senat të krenohemi apo të motivojmë nxënësit e tjerë të shkollës për t’u bërë pjesë”.

88% e të anketuarve pohojnë se familja ka qenë në mbështetje të tyre për të marr pjesë në aktivitete të organizuara nga shkolla/universiteti, aktivitete këto, të cilat kryesisht organizohen nga drejtorja e shkollës, mësuesit, qeveria e nxënësve dhe organizata të shoqërisë civile. Për më tepër, ka qenë nisma e tyre personale ajo që i ka shtyrë apo motivuar të rinjtë për të qenë pjesëmarrës në aktivitetet e shkollës/universitetit, ndjekur nga motivimi nga prindërit, mësuesit apo vetë shoqëria e tyre. Bazuar në fokus grupet e realizuara me të rinjtë, vihet re se në 8 qytete të rinjtë janë bërë pjesë e nismave të ndryshme, kryesisht të ndërmarra nga vetë ata, shkolla apo OJF-të, nisma të cilat kanë pasur më së shumti natyrë ndërgjegjësimi apo mbështetjeje/bamirësie dhe tema aktuale të prekshme që lidhen kryesisht me mjedisin, bullizmin dhe dhunën. Ajo çka të bën përshtypje, është se në qytete të mëdha, si Tirana e Durrësi, të rinjtë janë shprehur se hapësirat për t’u angazhuar janë të pakta dhe nuk kanë marrë pjesë në nisma komunitare.


Vlen për t'u theksuar se sa e rëndësishme është pjesëmarrja aktive e të rinjve në aktivitetet e shkollës/universitetit, pasi nxit një përvojë të pasur dhe të diversifikuar, duke i përgatitur ata jo vetëm për sfidat akademike, por edhe për zhvillimin personal dhe social në shoqëri. Pjesëmarrja në aktivitete shkollore ndihmon në zhvillimin e aftësive ndërpersonale si komunikimi, bashkëpunimi apo menaxhimi i konflikteve, si dhe u ofron mundësi të rinjve të ndërtojnë lidhje të forta sociale. Figura 8 jep informacion mbi këndvështrimin e të rinjve se çfarë kanë përfituar më shumë nga pjesëmarrja në aktivitetet e shkollës/universitetit, qëndrave rinore, OJF-ve. 40% e tyre kanë zgjedhur shoqërizimin si një vlerë të shtuar për ta, 33% janë shprehur se, si rrjedhojë e angazhimit, kanë përfituar aftësi komunikimi/drejtimi dhe 16% e janë informuar apo edukuar më tej. Edhe në diskutimet e fokus grupeve, të rinjtë kanë cilësuar se nga angazhimi në aktivitete të ndryshme kanë përftuar aftësi më të mira komunikimi, aftësi personale, si të folurit në publik, janë ndier të përfshirë dhe më sociale dhe se e gjitha eksperiencia u ka shërbyer.



8 Përfitimet nga pjesëmarrja në aktivitetet e organizuara


Seksioni V. Pjesëmarrja dhe Teknologjia Online

Në epokën digjitale, tepër i rëndësishëm është përdorimi i platformave online si një hapësirë për të rinjtë që të shprehin mendimet dhe pasionet e tyre, të lidhen me organizata dhe grupe me interesa të përbashkëta, si dhe të kontribuojnë në debatin shoqëror e politik. 67% e të rinjve të anketuar kanë zgjedhur median sociale (Facebook, Instagram, etj.) si burimin kryesor të informacionit nxitës për pjesëmarrjen e tyre, ndjekur nga faqet e internetit (21%) dhe televizioni (11%). 56% e të rinjve i shikojnë rrjetet sociale si një burim i besueshëm për të marrë informacione që lidhen me ta dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri. Ndonëse më shumë se gjysma e të rinjve (54%) i përdorin rrjetet sociale për të kaluar kohën e lirë dhe për argëtim, thuajse gjysma tjetër e të rinjve raporton se i përdor rrjetet sociale edhe për t'u informuar për kauza që lidhen me ta dhe për aktivizëm social. Të pyetur se sa shpesh janë online, 67% e tyre raportuan se janë shpesh ose shumë shpesh të angazhuar online (Figura 9).



9 Shpreshtësia e përdorimit të rrjeteve sociale

Të rinjtë raportuan pjesëmarrje në forma të ndryshme të angazhimit online, si pjesëmarrje në trajnime online, lojëra virtuale, peticione online, forume rinore apo diskutime online, votime online, podcast-e apo webinar-e informuese, konkurse online (Figura 10). Megjithatë, sikurse shprehen gjatë fokus grupeve, ndonëse rrjetet sociale janë vendi ku angazhohen më së shumti dhe marrin informacion, përdorimi i teknologjisë në mënyrë masive, jo konstruktive, i ka larguar nga njëri-tjetri, e ka zbehur interesin për pjesëmarrje në aktivitete dhe rrjedhimisht, janë bërë më indiferentë dhe individualistë.



10 Format e pjesëmarrjes online

Po ashtu, rrjetet sociale janë shpesh burim rreziku për të rinjtë, të cilët raportojnë se janë ekspozuar ndaj talljeve, bullizmit dhe ngacmimeve online. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve (17%), raportuan se janë ndier të bullizuar, të ngacmuar dhe të rrezikuar gjatë përdorimit të rrjeteve sociale dhe 10% kanë preferuar të mos përgjigjen. Ndërkohë që vetëm 7% e tyre kanë raportuar abuzimin online në rastet kur ka ndodhur.

VI. Përfundime dhe Rekomandime

Është thelbësore të pranohet se trajtimi i çështjeve që lidhen me rininë kërkon një qasje të shumanshme që përfshin politikat e qeverisë, punën dhe përpjekjet e organizatave të shoqërisë civile, institucioneve arsimore dhe pjesëmarrjen aktive nga vetë të rinjtë.

Bazuar në analizën e të dhënave nga administrimi i 650 pyetësorëve me të rinjtë në 12 qarqe dhe të dhënat nga 100 të rinj pjesëmarrës në fokus grupe, të rinjtë e angazhuar si bashkëkërkues dhe ekspertët kanë nxjerrë përfundime dhe kanë bërë rekomandime në lidhje me gjendjen dhe mundësitë e fuqizimit, pjesëmarrjes dhe angazhimit të të rinjve në Shqipëri. Rekomandimet janë të bazuara në fakte, për përmirësimin e strukturave dhe praktikave rinore në mbështetje të avancimit të sundimit të ligjit, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

Gjithsesi, përpara se të arrijmë në përfundime, duhen theksuar disa nga pengesat e identifikuar gjatë fokus grupeve që lidhen me mungesën e pjesëmarrjes dhe angazhimit të të rinjve në vendimmarrje:

- **Pengesat individuale** – Shumica e të rinjve në fokus grupe u shprehën se shpesh arsyeja se pse të rinjtë nuk angazhohen në jetën publike lidhet ngushtë me mungesën e vetë interesit të të rinjve. Të rinjtë mund të kenë përparësi personale të tjera, plane që lidhen vetëm me arsimimin/karrierën apo dhe plane për t'u larguar nga vendi, gjë që i bën pasivë dhe të painteresuar për pjesëmarrje aktive në shoqëri. Një arsye tjetër lidhet me angazhimet e tjera që kanë të rinjtë në punë apo brenda familjes, rrjedhimisht me mungesë kohe për përfshirje në aktivitete të tjera. Disa të rinj u shprehën se në ditët e sotme të rinjtë janë pesimistë, kanë ankth për të ardhmen apo kanë mungesë vetëbesimi, gjë që i bën të tërhequr dhe jo aktivë. Po ashtu, individualizmi u shfaq si një ndër aspektet që ndikon në mungesën e ndërëgjegjësimit mes të rinjve mbi rëndësinë e ndërveprimit me të tjerët dhe pjesëmarrjes publike. Arsye të tjera që u përmendën nga të rinjtë, dhe që janë mjaft me rëndësi për t'u trajtuar, lidhen gjithashtu me faktin se të rinjtë nuk janë ndier të dëgjuar apo të përfaqësuar në aktivitetet ku kanë marrë pjesë, nuk janë njohur me modele të suksesshme apo pozitive të pjesëmarrjes rinore, si dhe nuk kanë besim e shpresë se gjërat në të ardhmen mund të ndryshojnë.

- **Pengesat që lidhen me familjen** – Sipas të rinjve pjesëmarrës në fokus grupe, prindërit shpesh janë të painformuar dhe të pandërgjegjësuar mbi përfitimet që sjell angazhimi dhe pjesëmarrja e të rinjve në jetën publike dhe sociale. Ata nuk e vlerësojnë rëndësinë e angazhimit komunitar, por janë të fokusuar që fëmijët vetëm të shkollohen apo të jenë në një punë fitimprurëse. Po ashtu, ata theksuan se prindërit janë edhe mosbesues për sa i përket rolit dhe funksionit të organizatave dhe institucioneve rinore. Nuk janë të informuar mbi to dhe programet e tyre, ndaj kanë pasiguri dhe mosbesim për t'i lejuar apo motivuar fëmijët të bëhen pjesë.
- **Pengesa që lidhen me shkollën dhe komunitetin** – Gjetjet nga fokus grupet ishin thuajse unanime për sa u përket sfidave dhe pengesave që lidhen me shkollën dhe komunitetin, të cilat ndikojnë në mospjesëmarrjen dhe mosangazhimin e të rinjve. Për ta, strukturat vendimmarrëse në shkollë (p.sh., qeveria e nxënësve) janë jo funksionale. Nuk ka barazi, meritokraci apo konkurrencë të pastër në përzgjedhjen e përfaqësuesve të shkollës. Sipas të rinjve, në këto struktura përfshihen vetëm nxënësit e mirë apo ata që kanë marrëdhënie të mira me mësuesit. Po ashtu, në aktivitetet që organizohen në shkollë nuk ka gjithëpërfshirje, duke favorizuar edhe këtu nxënësit më të mirë apo të 'preferuar'. Si rrjedhojë, shumë të rinj të tjerë me dëshira, potencial, talente dhe nevojë për t'u angazhuar ndihen të përjashtuar apo jo të përfaqësuar. Për sa i përket komunitetit, të rinjtë pohuan se mungon në masë informimi dhe ndërgjegjësimi lidhur me rëndësinë e angazhimit rinor dhe përfitimet që vijnë prej tij. Për shumë të rinj, pengesë për pjesëmarrje është vetë shoqëria e tyre që i bullizon apo i tall në rast se marrin pjesë në aktivitete të paragjykuara prej tyre, sidomos kjo e theksuar për djemtë që marrin pjesë në aktivitete me natyrë sociale, komunitare apo artistike.
- **Pengesa që lidhen me strukturat vendore, rinore dhe OJF-të në vend** – Sipas të rinjve, në zonat ku ata jetojnë, hapësirat dhe aktivitetet ku mund të marrin pjesë janë të pakta. Ka mungesë aktivitetesh apo mungesë promovimi dhe informimi në lidhje me to, sidomos nga OJF-të, të cilat kanë programe për të rinjtë në zonë. Po ashtu, shpesh aktivitetet ku nevojitet angazhimi dhe zëri i të rinjve zhvillohen në vende jo të arritshme për të gjithë, duke përjashtuar kështu të rinj që mund të jetojnë në zona të largëta rurale apo që vijnë nga grupe të marginalizuara. Për sa u përket strukturave rinore vendore, sipas të rinjve, ato janë më së shumti formale dhe jo aktive, apo shumë prej të rinjve nuk kanë informacion për ekzistencën dhe rolin e tyre . Një tjetër arsye pse të rinjtë ngurrojnë të marrin pjesë dhe të angazhohen lidhet me zhvillimin e aktiviteteve që janë jo interesante për të rinjtë, duke përfshirë tema jo aktuale, jo gjithëpërfshirëse apo të papërshtatshme për pjekurinë dhe botëkuptimin e tyre. Po ashtu, teksa folën për botën online, të rinjtë shpjeguan se përdorimi i teknologjisë në mënyrë masive, jo konstruktive, po i largon nga njëri-tjetri, duke theksuar individualizmin tek ata. Por të rinjtë theksuan po ashtu se teknologjia dhe mediat sociale janë kanali i komunikimit ku informohen dhe shpenzojnë shumë kohë, ndaj duhet të përdoren më gjerë për promovimin e aktiviteteve dhe ndërgjegjësimin rreth angazhimit rinor.

Duke analizuar pengesat e sipërpërmendura, është e rëndësishme të theksohet se duhet të punohet me të rinjtë për të rritur vetëbesimin e tyre dhe ndjenjën e përfshirjes. Është shumë e nevojshme që të rinjtë të fuqizohen dhe të ndërgjegjësohen për rolin që kanë në shoqëri. Të rinjtë duhet të dëgjohen, të mbështeten nga shkolla dhe strukturat vendore, rinore dhe OJF-të për të ndërmarrë nisma, por edhe të vlerësohen për mendimet e tyre dhe ato të merren në konsideratë. Duhet të sigurohet barazi, meritokraci, nxitje dhe konkurrencë e barabartë në proceset e përzgjedhjes së të rinjve në strukturat shkollore apo rinore. Nismat e ndërmarrura duhet të jenë sa më gjithëpërfshirëse, pa bërë dallime me bazë gjinore, etnike, fetare, origjine apo statusi ekonomik.

Rekomandimet e sugjeruara nga të rinjtë janë grupuar në mënyrë më specifike si më poshtë:

Respektimi i të drejtave të të rinjve për angazhim dhe pjesëmarrje:

- Të ngrihen mekanizma në nivel vendor dhe kombëtar që sigurojnë angazhim dhe përfaqësim të plotë të të gjithë të rinjve në vendimmarrje dhe hartimin e politikave rinore.
- Të ngrihen mekanizma që fuqizojnë dhe sigurojnë që pushteti vendor të përfshijë të rinjtë dhe të marrë vendime bazuar në sugjerimet e të rinjve.
- Mekanizmat e pjesëmarrjes duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë përfshirje të të gjithë të rinjve (vajza, djem, grupe të marginalizuara), duke marrë parasysh diferencat e tyre, sfidat dhe pengesat që hasin në angazhim.
- Të sigurohet që të gjithë profesionistët që punojnë me dhe për të rinjtë të jenë të trajnuar mbi të drejtat e tyre dhe mekanizmat e pjesëmarrjes në mënyrë që të sigurojnë që zëri i të rinjve të dëgjohet dhe të merret parasysh (bazuar në moshën dhe pjekurinë e tyre).
- Politikat rinore të hartohen në bazë të të dhënave dhe evidencave nga studimet e drejtuara nga të rinjtë dhe të sigurohen gjithashtu mekanizma financiare për zbatimin e tyre.
- Të hartëzohen dhe dokumentohen praktikrat dhe eksperiencat më të mira të angazhimit rinor (në vend dhe në rang ndërkombëtar).
- Shpenzimet publike për të rinjtë duhet të shkojnë përtej arsimimit. Që të rinjtë të 'lulëzojnë', nevojiten investime në infrastrukturë sportive, hapësira komunitare/publike, qendra rinore, hapësira për art dhe kulturë, etj.

Informimi dhe ndërgjegjësimi mbi angazhimin rinor:

- Informim i të rinjve mbi mekanizmat vendorë dhe kombëtarë të pjesëmarrjes, mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në vendimmarrje. Vendosja e theksit të forcimit të rolit të shkollës dhe strukturave rinore për informimin e qartë mbi qytetarinë aktive, të drejtat themelore të të rinjve, legjislacionin për rininë dhe rolin e institucioneve.
- Informim i të rinjve mbi shërbimet dhe mundësitë që ofrohen për ta për të mësuar, për t'u përfshirë në veprimtari vullnetare, si dhe në hapësirën publike dhe sferën politike. Të forcohet promovimi që bëhet nga strukturat vendore dhe OJF-të në lidhje me aktivitetet, nismat apo projektet rinore. Të përdoren për informim kanale komunikimi ku të rinjtë kanë më shumë qasje, si media sociale. Të forcohet roli i medias për informimin e të rinjve dhe orientimin drejt vlerave dhe jo antivlerave.

- Informim dhe ndërgjegjësim i prindërve dhe anëtarëve të komunitetit në lidhje me rëndësinë e pjesëmarrjes dhe angazhimit të të rinjve. Po ashtu, ndërgjegjësim për vlerën e angazhimit humanitar krahas angazhimeve për qëllime fitimprurëse, rëndësinë e bashkëpunimit dhe ndërveprimit në komunitet krahas individualizmit dhe nxitjen e të rinjve për të luajtur rol edukues dhe nxitës në këtë proces.

Aktivitetet rinore dhe gjithëpërfshirja:

- Të sigurohet që argëtimi, sporti, aktivitetet kulturore dhe hapësirat e gjelbra ekzistojnë për të rinjtë dhe janë të arritshme në të gjitha bashkitë, veçanërisht për vajzat, të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë nga zonat rurale, ata që u përkasin grupeve minoritare, etj.
- Aktivitetet të ofrohen dhe të sigurojnë pjesëmarrje kuptimplotë të të gjithë të rinjve ('jo vetëm për nxënësit më të mirë').
- Aktivitetet duhet të paraqesin tema aktuale, të përshtatshme, specifike, praktike dhe të përshtatura me grupmoshën dhe botëkuptimin e të rinjve (komponenti argëtues të jetë pjesë).
- Krahas edukimit, të rinjtë konsiderojnë si shumë të rëndësishme kryerjen e aktiviteteve që ndikojnë në zhvillimin e identitetit pozitiv dhe mirëqenies emocionale e psikologjike (vetëbesimi, komunikimi, qëndrueshmëria, toleranca, diversiteti).
- Të ofrohen hapësira dhe mundësi (shkëmbime) që mbështesin dialogun mes vajzave dhe djemve, të rinjve në zona rurale apo urbane, apo nga kultura të ndryshme, drejt zhvillimit të bashkëpunimit, tolerancës, parandalimit të konflikteve dhe pranimit të diversitetit.
- Të zhvillohen aktivitete që promovojnë modele pozitive të angazhimit rinor, projekte të drejtuara nga të rinjtë që promovojnë vendin, për të nxitur më shumë ndjenjën e përkatësisë dhe shpresën për të qëndruar dhe kontribuar në vend.
- Strukturat vendore (bashkia/njësitë vendore), OJF-të, bizneset vendore dhe komuniteti të mbështesin të rinjtë në nisma komunitare (financiarisht dhe teknikisht).
- Aktivitetet/trajnimet/fushatat e ndërgjegjësimit me fokus çështjet gjinore duhet të ofrohen në shkollë/universitet nga OJF-të për gjithë të rinjtë, familjen dhe komunitetin për zbehjen e stereotipave gjinore.
- Këshillimi i karrierës të ofrohet si një mjet për zbehjen e stereotipave rreth roleve gjinore duke theksuar potencialin që kanë të rinjtë pavarësisht gjinisë.
- Vajzave dhe djemve t'u jepen hapësira të barabarta për t'u informuar, për të vepruar dhe për të bashkëjetuar në kontekstin aktual, ku demokracia e vendit është përparësi.
- Të dokumentohet dhe të njihet pjesëmarrja e të rinjve dhe kontributi i tyre në komunitet nëpërmjet formave të stimulimit si përmes dhënies së certifikatave apo letrave të referencës, të cilat janë të rëndësishme gjatë aplikimeve të ndryshme në rang kombëtar/ndërkombëtar.

Puna me familjen:

- Të punohet me familjen për ndërgjegjësimin e prindërve rreth rëndësisë dhe përfitimeve nga angazhimi komunitar dhe pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje.
- Të ofrohen programe të prindërimit pozitiv ku prindërit të trajnohen rreth zhvillimit të mendimit kritik te fëmijët që në moshë të hershme, dëgjimit aktiv si aftësi te fëmijët dhe frymës së bashkëpunimit me të tjerët.

- Të trajnohen prindërit për çështjet gjinore, duke kontribuar kështu për eliminimin e stereotipave rreth roleve gjinore.

VII. Bibliografia

1. Angazhimi Politik Shqipëri 2020. IDM dhe NDI Gjendet në: https://www.ndi.org/sites/default/files/Albania%20Political%20Engagement%20Suvey%202020_Albanian.pdf(Aksesuar më 23 shtator 2023), faqe 115.
2. Anketa Kombëtare: Të rinjtë dhe politika në Shqipëri. Gjendet në: https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-suvey_young-people-and-politics-in-albania-final.pdf
3. Bino et al (2020). Civil Society Participation in Decision Making in Albania. WFD dhe IDM. Gjendet në: <https://idmalbania.org/wpcontent/uploads/2021/11/CSO-Participation-in-Decision-Making-in-Albania.pdf>
4. Bino, B., & Seferaj, K. (2021). Mapping of Youth Policies and Identification of Existing Support and Gaps in Financing of Youth Actions in The Western Balkans – Albania Report. Gjendet në https://www.rcc.int/youth_db/files/user/docs/1.1_Albania_Report.pdf.
5. Bërdufi, D., & Pacukaj, S. (2022). Youth Political Participation in Conventional Forms in Albania 2011-2021. Academic Journal of Interdisciplinary Studies. ISSN 2281-3993. Vol.11. Nr.3
6. Economic Reform Programme 2020-2022, Government of Albania, January 2020, gjendet në:<https://new.financa.gov.al/wpcontent/uploads/2020/03/Economic-Reform-Programme-2020-2022.pdf>
7. Equality, gender & youth, gjendet në: <https://www.forestsoftheworld.org/goals-strategies/equality-gender-youth> (Përdorur më 15 shtator 2023).
8. Gender equality strategy 2022-2025, UNDP 2022, United Nations Plaza New York, NY 10017 USA, UNDP 2022
9. INSTAT. (2022). Burra dhe Gra 2022, Instituti i Statistikave, Tiranë, Shqipëri.
10. Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
11. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
12. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
13. Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
14. Ligji nr. 75/2019 “Për Rininë”.
15. Ligji. nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
16. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Gjendet në: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>
17. Oden, A., & Porter, L. (2023). The Kids Are Online: Teen Social Media Use, Civic Engagement, and Affective Polarization. Social Media+ Society, 9(3), 20563051231186364.
18. Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020. Gjendet në: https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/plani-kombetar-i-veprimit-per-rinine-2015-2020_Shqip.pdf

20. Raporti Kombëtare Rinia në Shqipëri 2020. CRCA/ECPAT. Gjendet në:
https://www.crca.al/wp-content/uploads/2022/10/RAPORTI-TE-RINJTE-NE-SHQIPERI-2019-2020_0-1.pdf
21. Raporti Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/2019 “Për Rininë” (2021). Fondacioni Konrad Adenauer dhe Kongresi Rinor Kombëtar. Gjendet në:
<https://mail.google.com/mail/u/0/#inbox/FMfcgzGtxSmrIFSGmwvdvXKWmcTmsksx?projector=1&messagePartId=0.1>
22. Social and demographic indicator, INSTAT 2020, gjendet në:
<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhesocial%C3%AB/popullsia/#tab3> (Përdorur më 4 shtator 2023).
23. Strategjia e BE-së për Rininë 2019-2027. Gjendet në:
https://www.oph.fi/sites/default/files/documents/eu-youth-strategy_en.pdf
24. Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029. Gjendet në:
<https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/Strategjia-Kombetare-e-Rinise-2022-2029.pdf>
25. Strategjia kombëtare për barazinë gjinore 2021-2030, qershor 2021, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
26. Studim Pilot, Perceptimet dhe Qëndrimet Publike ndaj Barazisë Gjinore në Shqipëri, Janar (2016) - Tiranë, Shqipëri.
27. The European Union Youth Strategy 2019–2027, gjendet në:
https://www.oph.fi/sites/default/files/documents/eu-youth-strategy_en.pdf (Përdorur më 11 shtator 2023).
28. Udhërrëfyesi Kombëtar për Tranzicionin e të Rinjve nga Shkolla në Vendin e Punës (2022). Gjendet në:
<https://krk.al/wp-content/uploads/2023/04/UDHERREFYESI-KOMBETAR-PER-TRANZICIONIN-E-TE-RINJVE-NGA-SHKOLLA-NE-VENDIN-E-PUNES-2-1.pdf>
29. Udhërrëfyesi kombëtar për tranzicionin e të rinjve nga shkolla në vendin e punës, Tiranë, qershor 2022, gjendet në:
<https://krk.al/wp-content/uploads/2023/04/UDHERREFYESI-KOMBETAR-PER-TRANZICIONIN-E-TE-RINJVE-NGA-SHKOLLA-NE-VENDIN-E-PUNES-2-1.pdf> (Përdorur më 12 shtator 2023), faqe 24.
30. UNICEF. Udhëzuesi për Angazhimin e Adoleshentëve dhe të Rinjve. Gjendet në:
<https://www.unicef.org/evaluation/media/1581/file/A%20guide%20to%20action%20what%20works%20on%20adolescent%20and%20young%20people%20engagement.pdf>
31. United Nations (2023). The Sustainable Development Goals Report: Special Edition 2023. Gjendet në:
<https://unstats.un.org/sdgs/report/2023/The-Sustainable-Development-Goals-Report-2023.pdf>
32. United Nations Development Programme, Gender Equality Strategy 2022-2025, gjendet në:
https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2022-09/UNDP_Gender_Equality_Strategy_2022-2025_EN.pdf. (Përdorur më 21 shtator 2023).

33. Vrutgman, L., & Bino, B., (2020). Trust in Governance Opinion Poll 2019. Tirana: IDM, gjendet në UNDP Albania
<https://www.undp.org/albania/press-releases/presentation-%E2%80%9Ctrust-governance-2019%E2%80%9D-opinion-poll-findings>(Përdorur më 9 shtator 2023).
34. Young people's participation and civic engagement, gjendet në:
<https://www.unicef.org/evaluation/media/1581/file/A%20guide%20to%20action%20what%20works%20on%20adolescent%20and%20young%20people%20engagement.pdf>, (Përdorur më 13 shtator 2023)
35. Zaimi A. (2023). Participation of Citizens in Decision- Making Process: Albanian Case. Tezë e dorëzuar për marrjen e titullit Doktor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Universiteti Epoka. Gjendet në:
<http://dspace.epoka.edu.al/bitstream/handle/1/2274/Ali%20Zaimi.pdf?sequence=1>

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët.

PJESA E DYTË

Studim Kombëtar mbi Çështjet Gjinore

Falënderime

Grupi kërkimor i studimit dëshiron të shprehë falënderimin për 750 të rinjtë nga 12 qarqet e Shqipërisë, pjesë e këtij studimi, të cilët iu përgjigjën me shpejtësi studimit.

Dëshirojmë të falënderojmë edhe kolegët tanë – koordinatorë të Terres des hommes në disa nga qarqet dhe bashkëpunëtorë të Tdh në terren, veçanërisht të rinjtë, të cilët nëpërmjet fokus grupeve dhe intervistave dhanë informacione, ndanë opinione dhe njohuri të vlefshme në lidhje me analizat dhe rekomandimet e këtij studimi.

Një falënderim i veçantë shkon për ekipin drejtues dhe menaxhues të programeve të Terre des Hommes në Shqipëri, për inkurajimin, besimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen për të realizuar një studim pionier në këtë fushë me të rinjtë dhe për të rinjtë.

Së fundi, një falënderim për Agjencinë Austriake për Zhvillim për mbështetjen financiare dhe inkurajimin e tyre për të zhvilluar një studim kaq të vlefshëm për të rinjtë, për t'i nxitur ata të jenë pjesë aktive e shoqërisë dhe demokracisë shqiptare.

Shkurtime

BE-Bashkimi Evropian

CAWI-Computer Assisted Web Interviewing (Mbledhja e të dhënave përmes internetit)

CEDAW-Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave

INSTAT-Instituti i Statistikave

IDM-Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

NEET-Të rinj jo në edukim, punësim apo formim profesional

UN- Kombet e Bashkuara

UNSCR-Rezoluta e Këshillit 2250 për Rininë, Paqen dhe Sigurinë, Kombet e Bashkuara

UNDP-Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara

SKBGJ-Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore

Tabela përmbledhëse

I. Qëllimi dhe objektivat e studimit	45
II. Metodologjia	46
Metodologjia e përfshirjes së të rinjve bashkëkërkues	46
Përzgjedhja e kampionit	47
III. Struktura e studimit	48
IV. Kuadri i përgjithshëm teorik dhe legjislativ mbi rolin e gjinisë në çështjet rinore	49
Mekanizmat e pjesëmarrjes publike me fokus gjinor të fëmijëve dhe të rinjve	50
Marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj	53
Legjislacioni shqiptar dhe pjesëmarrja e të rinjve në këndvështrimin e barazisë gjinore	54
Dokumente politike dhe strategjike mbi çështjet gjinore	56
V. Gjetjet dhe analiza	57
VI. Përfundime dhe rekomandime	64
VII. Bibliografia	67
VIII. Shtojca	68
a. Kriteret për të qenë bashkëkërkues	68
b. Pyetëtori	69
c. Diskutimi në fokus grupe: Shënime për lehtësuesit	79
Lista e tabelave	
Tabela 1 Të dhënat zyrtare të INSTAT-it për popullsinë e grupmoshës 15-19 dhe 20-24 vjeç	47
Tabela 2. Të dhënat sipas INSTAT-it për popullsinë për qark dhe përlllogaritjet e kampionit	48
Lista e figurave	
Figura 1. Të anketuarit sipas grupmoshës	57
Figura 2 Të anketuarit sipas gjinisë	57
Figura 3. Shpërndarja e të anketuarve në nivel qarku në %	58
Figura 4. Institucionet ku të rinjtë njihen me konceptin e barazisë gjinore	59
Figura 5. Fushat e përfshirjes së vajzave/grave	64

Përmbledhje

Është thelbësore të pranohet se trajtimi i çështjeve gjinore të lidhura me rininë kërkon një qasje të shumanshme që përfshin politikat e qeverisë, organizatat e shoqërisë civile, institucionet arsimore dhe pjesëmarrjen aktive nga vetë të rinjtë.

Terre des hommes (Tdh) është organizata kryesore zvicerane për ndihmën ndaj fëmijëve. Nëpërmjet programeve të ndryshme, çdo vit ofron ndihmë për mbi katër milionë fëmijë dhe familjet e tyre në rreth 40 vende të botës. Një nga vendet ku Terre des hommes operon është Shqipëria, me seli në Tiranë. Në përmbushje të misionit të saj, një nga projektet e organizatës është 'Të Rinjtë, të Drejtat dhe Drejtësia', i financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC) nëpërmjet Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA). Një nga rezultatet e zotuar në kuadër të këtij projekti është edhe hartimi i një studimi kombëtar drejtuar nga të rinjtë, mbi pjesëmarrjen e të rinjve shqiptarë në çështjet e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe në komunitet. Përveç ekspertizës dhe hulumtimeve përkatëse, roli i të rinjve si bashkëkërkues dhe përpunues të dhënash ka qenë një dimension thelbësor në ndërtimin dhe impaktin e studimit.

Marrja përsipër e këtij studimi në nivel kombëtar përputhet me vizionin dhe misionin e projektit të zbatuar nga Terre des hommes Shqipëri 'Të Rinjtë, të Drejtat dhe Drejtësia', financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim nëpërmjet Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Rrugëtimi i këtij studimi u ndërtua duke pasur parasysh ndikimin në forcimin e kapaciteteve konceptuale dhe praktike të të rinjve për pjesëmarrjen në komunitet, si dhe vizionin e misionin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029:

Objektivi Specifik 1.3 "Studimet rinore zhvillohen dhe bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë" dhe masat përkatëse përfshijnë:

1.3.2 Politikat zhvillimore rinore ndërtohen mbi analiza faktike dhe dokumentare.

1. Hartohet një studim bazë reference në lidhje me autonominë rinore dhe mundësitë e barabarta sipas nevojave të të rinjve (2022 – 23).

2. Hartohet një studim bazë reference në lidhje me gjithëpërfshirjen rinore dhe sfidat e përfshirjes të të gjitha kategorive rinore në proceset e zhvillimit të vendit (2022 – 23).

Rrugëtimi i këtij studimi është bazuar gjithashtu mbi qëllimin e tij për ndikimin në forcimin e kapaciteteve konceptuale dhe praktike të të rinjve për pjesëmarrjen në komunitet dhe dimensionet demokratike në tërësi. Ky studim u realizua në nivel kombëtar nga bashkëpunimi i 23 të rinjve nën drejtimin shkencor të dy drejtuesëve, duke mbuluar 12 qarqe në Shqipëri.

Procesi i kërkimit në këtë studim përfshiu tri faza kryesore: së pari, hulumtimi dhe kërkimi shkencor; së dyti, puna në terren dhe mbledhja e të dhënave nga të rinjtë e angazhuar si bashkëkërkues; dhe së treti, analiza dhe interpretimi i të dhënave.

Metodologjia për mbledhjen e të dhënave u realizua sipas teknikës CAWI (Computer Assisted Web Interviewing), e njohur ndryshe si mbledhje e të dhënave përmes internetit. Mbledhja e të dhënave u krye në periudhën shtator 2023, në platformën Microsoft Forms, dhe studimi përfshiu një kampion prej 650 të rinjsh e të rejash të grupmoshave 15–19 vjeç dhe 20–24 vjeç, duke përfshirë të rinj nga zona urbane dhe rurale, nga komunitete të cënueshme dhe të rinj që nuk janë në arsim, punësim apo formim profesional (NEET). Po ashtu, u krijuan 11 fokus grupe me 100 të rinj nga 12 qarqet e vendit, me përfaqësi të të rinjve nga zona urbane e rurale, vajza e djem, komunitete vulnerabël.

Bazuar në analizën e të dhënave, të rinjtë e angazhuar dhe ekspertët kanë nxjerrë përfundime dhe kanë bërë rekomandime në lidhje me gjendjen, mundësitë e fuqizimit, pjesëmarrjes dhe paragjykimet gjinore të të rinjtë në Shqipëri. Rekomandimet janë të bazuara në gjetje për përmirësimin e strukturave dhe praktikave rinore në mbështetje të avancimit të sundimit të ligjit, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

Disa nga gjetjet kryesore të studimit:

42% e të rinjve mendojnë se gjinia ndikon në pjesëmarrjen apo mospjesëmarrjen e tyre në vendin tonë ndërsa 16% shprehen se nuk e dinë se si ndikon gjinia.

24% e të rinjve raportuan se kanë përjetuar personalisht paragjykim gjinor gjatë pjesëmarrjes në aktivitete rinore dhe 13% e tyre kanë preferuar të mos përgjigjen.

“Shokët më thonë me ironi ‘djalë mbledhjesh’ dhe ndihem pak keq, megjithatë kjo nuk më ka penguar që të marr pjesë në aktivitete të ndryshme, sepse unë përfitoj prej tyre.” - djalë, 18 vjeç, Dibër

10% e të rinjve u shprehën se kanë dashur të marrin pjesë në aktivitete që cilësohen për gjininë tjetër por paragjykimet i kanë frenuar.

63% e të rinjve janë shprehur se ka pasur raste kur nuk kanë marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga shkolla/universiteti sepse ka ndikuar opinioni i shoqërisë.

44% e të rinjve mendojnë se prindërit në Shqipëri nxisin më shumë djemtë për të marrë pjesë në aktivitete, krahas 11% të të rinjve që mendojnë se nxiten më shumë vajzat. Ndërkohë që 46% e të rinjve raportojnë se familja nxit njëlloj si vajzat dhe djemtë.

Po ashtu, gjatë fokus grupeve u theksua fakti se vajzat nxiten më shumë drejt edukimit, angazhimit komunitar, punës në familje, ndërsa djemtë drejt punësimit, roleve menaxhuese, bizneseve familjare dhe aktiviteteve fitimprurëse.

Po nga këto fokus grupe del qartë nga të gjithë të rinjtë e qyteteve të ndryshme se diskriminimi është më i dukshëm kur krahasojmë zonat rurale me ato urbane. Sipas tyre, vajzat në fshat janë më të diskriminuara dhe më të painformuara.

I. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është hulumtimi i pengesave gjinore për angazhimin e të rinjve në komunitet, demokraci dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Objektivat e studimit janë si më poshtë:

- Të analizojë mekanizmat ligjorë dhe politikat që mbështesin fuqizimin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve/të rinjve për avancimin e të drejtave të njeriut nga këndvështrimi i barazisë gjinore.
- Të identifikojë praktikatat ekzistuese në mbarë vendin që promovojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e barabartë gjinor të fëmijëve me aktorët vendorë për avancimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe mjedisit në nivel vendor.
- Të eksplorojë pengesat dhe boshllëqet me bazë gjinore që ndikojnë në angazhimin e duhur dhe kuptimplotë të të rinjve.

Studimi ka pasqyruar gjetjet dhe konkluzionet e analizës së bërë pas ndjekjes së një metodologjie rigoroze dhe ka dalë me rekomandime konkrete dhe të përshtatura për Tdh-në, që do të përdoren në ndërhyrjet e ardhshme të organizatës.

II. Metodologjia

Ky studim u realizua në nivel kombëtar nga bashkëpunimi i 23 të rinjve nën drejtimin shkencor të dy drejtuesëve, duke mbuluar 12 qarqe në Shqipëri.

Procesi i kërkimit në këtë studim përfshiu tri faza kryesore: së pari, hulumtimi dhe kërkimi shkencor; së dyti, puna në terren dhe mbledhja e të dhënave nga të rinjtë e angazhuar si bashkëkërkues; dhe së treti, analiza dhe interpretimi i të dhënave.¹ Në bashkëpunim me të rinjtë u hartua një kornizë kërkimore për studimin.

Procesi i realizimit ishte si më poshtë:

- **Identifikimi i grupit të të rinjve bashkëkërkues dhe realizimi i trajnimit/ orientimit të tyre.** Fillimisht u zhvillua një trajnim 2-ditor me 23 të rinjtë me qëllim për t'i bërë pjesë të të gjithë studimit, duke filluar nga hartimi i pyetësorit me fokus gjinor, mbledhja e të dhënave deri te realizimi i fokus grupeve me të rinjtë në 12 qarqe.

- **Përcaktimi i objektivave të kërkimit:** Këtu u përfshinë objektivat specifike të kërkimit dhe në bashkëpunim me të rinjtë u identifikuan fushat kryesore të interesit, si strukturat rinore, iniciativat për fuqizimin e fëmijëve/të rinjve, mekanizmat e pjesëmarrjes dhe paragjykimet gjinore në kontekstin e Shqipërisë.
- **Rishikimi i literaturës ekzistuese:** U bë një përmbledhje e literaturës për të kuptuar gjendjen aktuale të njohurive mbi çështjet rinore gjinore në arenën ndërkombëtare, me fokus te politikat rinore në BE dhe Shqipëri. U analizuan punimet akademike, studimet, dokumentet ligjore, strategjitë kombëtare, publikimet e OJQ-ve dhe të dhënat e organizatave ndërkombëtare. Kjo ndihmoi për të ndërtuar një bazë të fortë për studimin dhe për të identifikuar boshllëqet që kanë nevojë për eksplorim të mëtejshëm në rastin e Shqipërisë.
- **Identifikimi i praktikave më të mira të ruajtjes së balancave gjinore:** U identifikuan praktikat e suksesshme të fuqizimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve që kanë kontribuar pozitivisht në avancimin e sundimit të ligjit, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore në Shqipëri, si dhe u analizuan faktorët që i bëjnë këto praktika efektive.
- **U analizua roli i gjinisë** në formësimin e iniciativave për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve.
- **Mbledhja dhe analiza e të dhënave:** Metodologjia për mbledhjen e të dhënave u realizua sipas teknikës CAWI (Computer Assisted Web Interviewing), e njohur ndryshe si mbledhje e të dhënave përmes internetit. Mbledhja e të dhënave u krye në periudhën shtator 2023, në platformën Microsoft Forms dhe studimi përfshiu një kampion prej 650 të rinjsh e të rejash të grupmoshave 15–19 vjeç dhe 20–24 vjeç. Të dhëna cilësore u mbledhën përmes 11 fokus grupeve të realizuar me 100 të rinj nga gjithë vendi.
- **Përfundime dhe rekomandime:** Bazuar në analizën e të dhënave, të rinjtë e angazhuar dhe ekspertët kanë nxjerrë përfundime dhe kanë bërë rekomandime në lidhje me gjendjen dhe mundësitë e fuqizimit dhe pjesëmarrjes të të rinjve në Shqipëri. Rekomandimet për përmirësimin e strukturave dhe praktikave rinore në mbështetje të avancimit të sundimit të ligjit, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore janë të bazuara në fakte.

Gjatë gjithë procesit të kërkimit, janë ruajtur standardet etike dhe është siguruar konfidencialiteti i të dhënave.

Metodologjia e përfshirjes së të rinjve bashkëkërkues

Terre des hommes Shqipëri, ka përfshirë në këtë studim, në rolin e bashkëkërkuesëve, 23 të rinj nga 12 qarqe të vendit. Të rinjtë janë përzgjedhur përmes një procesi aplikimi, ku fillimisht u përcaktuan kriteret kryesore që duhet të përmbushnin të rinjtë bashkëkërkues (Shtojca A). Në secilin qark u përzgjedhën 2 të rinj. Pas procesit të përzgjedhjes, të rinjtë u bënë pjesë e një trajnimit 2-ditor ku u pajisën me njohuri në lidhje me studimin e drejtuar nga të rinjtë, procesin dhe hapat e tij. Po ashtu, u pajisën me aspekte teorike të angazhimit rinor dhe mekanizmave ligjore, si dhe u orientuan mbi metodologji dhe mjete praktike për hartimin e një pyetësori.

¹ Studimi është ndërtuar mbi të njëjtin proces kërkimi dhe metodologji, si dhe duke respektuar të njëjtën strukturë përmbajtësore dhe forme me studimin kombëtar mbi pjesëmarrjen rinore.

Pas disa takimeve konsultuese mbi teknikat që do të përdreshin prej tyre për të ideuar dhe shpërndarë pyetësonin, për të drejtuar takimet me të rinjtë në fokus grupet vendore e deri në hartimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve bazuar mbi të dhënat, së bashku me ekspertët dhe stafin e Tdh-së, të rinjtë morën udhëzimet përkatëse për të shpërndarë dhe përcjellë në komunitetet e tyre të dhënat e mbledhura të pyetësonit.

Pyetësoni i hartuar nga të rinjtë (Shtojca B) u administrua online me 650 të rinj. Pyetjet për "Pjesëmarrja dhe çështjet gjinore" ishin një nga 5 fushat ku u përqendrua studimi gjithëpërfshirës: "Të rinjtë shqiptarë dhe të drejtat e tyre në demokraci"

Të rinjtë dhe stafi mbështetës i Tdh-së, pas përfundimit të pyetësonit, ngritën 11 fokus grupe (Shtojca C) me pjesëmarrjen e 100 të rinjve nga 12 qarqet e Shqipërisë.

Përzgjedhja e kampionit

Përzgjedhja e kampionit në këtë studim u bazua në të dhënat zyrtare të INSTAT-it (1 janar 2023) për popullatën e grupmoshës rinore 15-24 vjeç.

Pyetësoni u aplikua në dy grupmosha: 15-19 dhe 20-24. Në bazë të të dhënave të INSTAT-it dhe llogaritjes së 'madhësisë së kampionit' dhe kufirit të gabueshmërisë, parashikimi ishte që, për të qenë sa më përfaqësues, studimi të përfshinte minimalisht 384 persona të të dy grup-moshave të mësipërme.

Popullata	Total	Vajza	Djem
15-19	172.076	368.316	87.761
20-24	196.240	97.887	98.353
Total	368.316	182.202	186.114

1 Të dhënat zyrtare të INSTAT-it për popullsinë e grupmoshës 15-19 dhe 20-24 vjeç

Popullata (total)	Niveli i besimit	Kufiri i gabimit	Madhësia e kampiolit ²
368.316	95%	5%	384

Vihet re se numri total i të rinjve për secilin qark është një indikator i munguar në bazën e të dhënave të INSTAT-it. Duke eksploruar edhe nga burime (raporte) të tjera, duke qenë se kjo e dhënë mungon, përllogaritjet përkatëse për secilin qark u bazuan mbi numrin e popullsisë totale. Në këtë mënyrë u nxor përqindja përkatëse për secilin qark (popullsia e qarkut si pjesë e numrit total të popullsisë).

	Total i të rinjve	Femra	Meshkuj	% e totalit
Berat	111.431	56.370	55.061	4
Dibër	106.380	51.030	55.350	4
Durrës	289.797	143.757	146.040	10
Elbasan	252.719	128.470	124.249	9
Fier	271.672	136.104	135.568	10
Gjirokastrë	53.314	27.907	25.407	2
Korçë	192.925	98.437	94.488	7
Kukës	71.498	34.783	36.715	3
Lezhë	114.181	58.164	56.017	4
Shkodër	189.164	97.728	91.436	7
Tiranë	925.268	470.061	455.207	34
Vlorë	183.436	92.053	91.383	7
Total	2.761.785	1.394.864	1.366.921	

2 Të dhënat sipas INSTAT-it për popullsinë për qark dhe përlllogaritjet e kampionit

Ky numër u konceptua dhe përlllogaritjet u kryen në mënyrë që kampioni të ishte sa më përfaqësues edhe për popullsinë urbane dhe rurale, vajzat dhe djemtë, si dhe grupmoshën 15-19 dhe 20-24 vjeç. Numri i të rinjve të përfshirë për secilin qark do të përfshinte 50 për qind meshkuj e 50 për qind femra për secilën grupmoshë.

Përzgjedhja e kampionit u testua edhe në takimin e organizuar me të rinjtë dhe u diskutua mbi mundësitë, pamundësitë dhe vështirësitë që mund të hasin në këtë proces. Zgjedhja e kampionit prej 500 të rinjsh (realisht arriti në 650) në gjithë qarqet e vendit, siguroi përfaqësimin e duhur për secilin prej qarqeve, duke mundësuar jo vetëm gjithëpërfshirjen, por edhe mundësinë e krahasimit të problematikave dhe realiteteve të komuniteteve mbi pjesëmarrjen e të rinjve, me mekanizmat e ngritur në nivel politik, ligjor dhe social.

III. Struktura e studimit

- **Prezantimi (lista e shkurtimeve, hyrja, metodologjia, objektivat, përmbajtja, etj.).** Këtu janë përfshirë disa informacione bazë, objektivat e kërkimit, metodologjia, përzgjedhja e kampionit dhe instrumentet konkrete të kërkimit.

- **Kuadri i përgjithshëm teorik dhe legjislativ mbi rolin e gjinisë në çështjet rinore**

Qëllimi i këtij kapitulli të dytë është të ofrojë një kornizë të detajuar konceptuale dhe analitike, si sfond i nevojshëm i projektit kërkimor, por edhe si një instrument për të kuptuar më mirë dhe për t'i vendosur gjetjet e kërkimit në kontekst. Qëllimi nuk është të ndalemi në konceptet teorike, por të kemi një kornizë të qartë analitike që do t'u mundësojë studiuesve të interpretojnë gjetjet dhe të nxjerrin rekomandimet përkatëse.

- **Gjetjet dhe analizat**

Kjo do të jetë pjesa thelbësore e studimit dhe do të organizohet sipas objektivave të kërkimit të përshkruara në hyrje. Duke qenë se ky është një studim sasior dhe cilësor, analizat dhe diskutimet do të paraqiten së bashku. Për ta bërë më të lehtë leximin, do të përdoren grafika dhe tabela të rezultateve .

- **Përfundime dhe rekomandime**

Ky seksion do të fokusohet në pikat kryesore dhe rekomandimet. Këto të fundit janë hartuar në bazë të çështjeve të identifikuara, por edhe duke synuar audienca të veçanta, për shembull, rekomandime për ministrinë, grupet e interesuara dhe Tdh-në.

- **Bibliografi**

- **Shtojcat: Formati i pyetësorit, udhëzimet e fokus grupeve, instrumentet e përdorur në studim.**

IV. Kuadri i përgjithshëm teorik dhe legjislativ mbi rolin e gjinisë në çështjet rinore

Mekanizmat e pjesëmarrjes publike me fokus gjinor të fëmijëve dhe të rinjve

Përfshirja e të rinjve në jetën demokratike ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm të një vendi, ku rol të rëndësishëm luan respektimi i barazisë së tyre gjinore. Çdo i ri, qoftë vajzë apo djalë, duhet të jetë në gjendje të njohë dhe të përdorë të drejtat e veta, pasi vetëm kështu mund t'u afrohem vendëve të zhvilluara. Fuqizimi i të rinjve në sistemet demokratike ka si përparësi përfshirjen dhe barazinë gjinore. Në këtë kontekst, përfshirja sistematike e vajzave në këto sisteme, duke shmangur pabarazinë gjinore, është kusht i domosdoshëm i zhvillimit të të rinjve në veçanti dhe mbarë shoqërisë në përgjithësi. Kur një individ, qoftë femër apo mashkull, trajtohet në mënyrë jo të barabartë për shkak të gjinisë, atëherë kemi të bëjmë me pabarazi gjinore. Pavarësisht gjinisë, ky fenomen ndodh në të dyja rastet, por më i dukshëm është fakti që femrat preken më shpesh.

Në Strategjinë e Bashkimit Evropian (BE) për Rininë, 2019-2027, inkurajimi i të rinjve për të marrë pjesë në jetën demokratike, si dhe mbështetja e tyre për pjesëmarrje sociale dhe qytetare, është një ndër pikat kyçe, e listuar e dyta në këtë strategji.

Pika 2:

“Barazia e të gjitha gjinive: Diskriminimi me bazë gjinore ende prek shumë të rinj, sidomos vajzat e reja. Duhet të sigurohen mundësi të barabarta dhe qasje në të drejta për të gjithë të rinjtë.”³

BE-ja e ka gjithnjë në vëmendje përmirësimin e mirëqenies së të rinjve. Kujtojmë këtu shpalljen e Vitit të Rinisë, kur në dhjetor të vitit 2021, qyteti i Lituanisë i dorëzoi Tiranës titullin “Kryeqyteti Evropian i Rinisë” për vitin 2022. Për sa i përket vëmendjes politike, BE-ja e ka shpallur Vitin e Rinisë në shenjë mirënjohjeje për sakrificat që brezi i ri bëri gjatë pandemisë, duke sjellë aktivitetet e BE-së në Tiranë. Në kuadër të Vitit të Rinisë, janë planifikuar aktivitete, konferenca dhe iniciativa për të rinjtë në të gjitha vendet e BE-së.⁴

Gjithashtu, Kombet e Bashkuara, Rezoluta e Këshillit 2250 për Rininë, Paqen dhe Sigurinë (UNSCR), i kanë dhënë një rëndësi të veçantë nevojës për të kuptuar shqetësimet, kërkesat dhe përgjegjësitë e të rinjve. Sipas UNSCR-së, të rinjtë duhet të përfshihen në vendimmarrje, pasi vetëm kështu mund të japin kontributin e tyre në jetën sociale me të drejta të barabarta.⁵

Në kontekstin shqiptar, prej një periudhe të gjatë, dominimi i gjinisë mashkullore në shoqëri ka qenë tepër i dukshëm, nisur kjo nga natyra patriarkale që ka pasur shoqëria jonë brez pas brezi. Gratë dhe vajzat janë përballur shpesh me diskriminimin gjinor vetëm për shkak të këtij fenomeni që ka sunduar në shoqërinë tonë dhe që kërkon punën dhe dëshirën e të gjithëve për të bashkekzistuar si të barabartë, pavarësisht gjinisë. Janë bërë dhe vijojnë të bëhen përpjekje që mekanizmi i barazisë gjinore të rinjtë të funksionojë si hallkë thelbësore e sistemit demokratik shqiptar.

Në dhjetëvjeçarin e fundit, Shqipëria ka bërë një ndryshim rrënjësor për sa i përket zbatimit të të drejtave të njeriut dhe fuqizimit të grave. Zbatimi i politikave gjinore dhe kuadri ligjor është përmirësuar ndjeshëm qëkur u është bashkuar konventave ndërkombëtare, ka futur në përdorim instrumentet ligjorë rregullues dhe ka angazhuar organizata të ndryshme ndërkombëtare, të cilat së bashku sigurojnë dhe punojnë për zbatimin e të drejtave të njeriut, demokracisë, ndalimit të dhunës, trafikut të qenieve njerëzore dhe respektimit të barazisë gjinore në vend.

Një nga politikat kombëtare të kohëve më të fundit në shërbim të realizimit të barazisë gjinore në Shqipëri është edhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, e realizuar në qershor 2021 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vizioni i së cilës është:

³ United Nations Development Programme, Gender Equality Strategy 2022-2025, gjendet në: https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2022-09/UNDP_Gender_Equality_Strategy_2022-2025_EN.pdf. (Përdorur më 21 shtator 2023).
⁴ Udhërrëfyesi kombëtar për tranzicionin e të rinjve nga shkolla në vendin e punës, Tiranë, qershor 2022, gjendet në: <https://krk.ai/wp-content/uploads/2023/04/UDHERREFYESI-KOMBETAR-PER-TRANZICIONIN-E-TE-RINJVE-NGA-SHKOLLA-NE-VENDIN-E-PUNES-2-1.pdf> (Përdorur më 12 shtator 2023), faqe 24.

“Një shoqëri e cila vlerëson barazinë dhe drejtësinë gjinore si kushte të domosdoshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik e politik të vendit, fuqizon të gjithë individët për të gëzuar të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës, nuk lejon që askush të mbetet pas, si dhe që mbështetet në parimin e tolerancës zero kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke ndëshkuar dhunuesit dhe duke mbrojtur, rehabilituar e riintegruar personat e dhunuar”. (SKBGJ 2021 – 2030; faqe 23).

Nisma të tilla, sikurse janë strategjitë e sipërpërmendura, janë vlerë e shtuar në luftën aktuale mbarëbotërore kundër pabarazisë gjinore të rinjtë, ku çdokush ka të drejtën për t'u njohur/informuar me të jetuarit në një sistem demokratik. Të rinjtë nuk kanë pse të largohen nga vendi i tyre. Bazuar në disa sondazhe të opinionit publik, realizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2019, një shumicë dërrmuese (65%) e të anketuarve në grupmoshën 18-25 vjeç raportuan se duan të largohen nga Shqipëria.⁶ Në fakt, ky fenomen nuk i vjen në ndihmë zhvillimit të vendit, pasi zhvillimi i vendit e ka të domosdoshme praninë e tyre.

Rritja e nivelit të përfaqësisë së vajzave të reja dhe pozicionimi i tyre me të drejta të njëjta si djemtë në avancimin e demokracisë, është një detyrë që i takon gjithë komunitetit, përfshi këtu, familjet, shkollat dhe mjedisin përreth. Të gjithë këta elementë kanë detyrimin që të ndikojnë në prishjen e stereotipave negative se vajzat nuk mund të përfshihen njësoj si djemtë në jetën sociale. Duke eliminuar këtë stereotip dhe duke mbështetur zhvillimin e besimit të vajzave për të drejta të barabarta me djemtë, ne japim një shtysë të fortë në rritjen e interesit për të drejta përfaqësie të njëjta me gjininë tjetër. Shoqëria përballet çdo ditë me krizat sociale dhe ekonomike që krijohen nga vetë njerëzit. Duket se këto kriza bien më keq në kurriz të vajzave vetëm për shkak të diskriminimit gjinor.

“Krizat klimatike, COVID-19 dhe pothuajse çdo sfidë tjetër humanitare dhe zhvillimore ndikojnë më keq te gratë, si pasojë e ndarjes jo të barabartë të pushtetit dhe diskriminimit të rrënjësor dhe të thellë gjinor” (UNDP, 2022).

Shmangia e kësaj pabarazie gjinore kërkon përdorimin e disa mekanizmave, të cilët, që të jenë funksionalë në një komunitet, nisin qysh herët me pozicionimin e vajzave të reja në të njëjtin rang me djemtë, kur flitet për njohje e zbatim të lirisë dhe të të drejtave të njeriut.

Një mekanizëm për shmangien e pabarazisë gjinore në pjesëmarrjen e fëmijëve/të rinjve për avancimin e sundimit të ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut është puna që bëjnë organizatat të ndryshme joqeveritare, kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat realizojnë projekte/trajnime që lidhen ngushtësisht me çështjet gjinore. Këto organizata, që zhvillojnë këshillim social dhe ligjor, kanë si mision që të rinjtë të njihen me të drejtat dhe liritë në lidhje me demokracinë dhe zhvillimin e vendit, si dhe me mirëqenien e tyre.

⁵Young people's participation and civic engagement, gjendet në: <https://www.unicef.org/evaluation/media/1581/file/A%20guide%20to%20action%20what%20works%20on%20adolescent%20and%20young%20people%20engagement.pdf>, (Përdorur më 13 shtator 2023)

⁶Vrutgman, L., & Bino, B., (2020). Trust in Governance Opinion Poll 2019. Tirana: IDM, gjendet në UNDP Albania <https://www.undp.org/albania/press-releases/presentation-%E2%80%9Ctrust-governance-2019%E2%80%9D-opinion-poll-findings> (Përdorur më 9 shtator 2023).

Trajnimet dhe projekte të tilla me fokus të fuqizimi i vajzave në sistemet demokratike janë pjesë e një mekanizmi tepër të rëndësishëm për çështjet gjinore. Vajzat mësojnë se kanë të drejta të njëjta me djemtë, pavarësisht se konteksti ku mund të kenë jetuar nuk u ka dhënë mundësinë e reflektimit për të pasur të drejta të barabarta me djemtë për sa i takon vendimmarrjes dhe fuqizimit të tyre në shoqëri.

Aktet ligjore dhe rregullatore të vendit formojnë një tjetër mekanizëm, i cili është përgjegjës për shpërndarjen e njohurive të rinjta në lidhje me barazinë gjinore. Gjithashtu, këto akte kontrollojnë edhe zbatimin e konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare në lidhje me këtë fenomen, si dhe zbatimin e bazave ligjore të realizuara, me qëllim që situata të kthehet në favor të vajzave. Bazat ligjore për çështjet ligjore ndërthuren me informacionet që të rinjtë marrin në tekstet shkollore sipas viteve përkatëse të të nxënies të dijeve. Nga njëra anë është qeveria ajo që përgjigjet për hartimin e ligjeve të reja, akteve nënligjore dhe mbështetjen e politikave të integritetit gjinor në lidhje me rritjen e pjesëmarrjes së vajzave në sundimin e ligjit dhe avancimin e demokracisë, dhe nga ana tjetër janë një sërë mekanizmash që lidhen me nxitjen, njohuritë, komunikimin, rritjen e interesit dhe formimin, në mënyrë që këto akte të vihen në zbatim.

Me qëllim që të sigurohet barazia e gjinive në të gjitha fushat e jetës së rinjve, një tjetër mekanizëm është ndërgjegjësimi dhe njohuritë që të rinjtë marrin në familje dhe në shkollë. Për sa i përket arsimit, duket se ka një rënie të numrit të rinjve të regjistruar në arsim, bazuar kjo në disa të dhëna nga INSTAT-i.

Në shekullin e 21-të, ne jemi të vetëdijshëm se kërkohen shumë përpjekje për të rritur fuqizimin e vajzave në sistemet demokratike, prandaj edhe progresi i tyre arsimor është i rëndësishëm në strategjinë e zhvillimit të një vendi. Interesi i vajzave për t'u mirinformuar mbi të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore merr formë që në mënyrën se si u komunikohet atyre nga mjedisi social ku jetojnë. Janë mjediset arsimore, familjare dhe shoqërore ato që japin kontributin e tyre për të rritur këtë interes të vajzave që në formimin e tyre të përgjithshëm. I gjithë komuniteti duhet të ketë besim të plotë të rritja intelektuale e vajzave, duke ndikuar kështu në besimin se vajzat formohen për të rritur kërkesën ndaj vetes dhe për të vepruar në bazë të të drejtave që u përkasin. Prindërit dhe mësuesit kanë detyrimin që t'ua bëjnë të qartë të rinjve se nuk ka asnjë dallim gjinor të fëmijët për sa i përket përfaqësisë së tyre në një sistem demokratik.

Sot, shoqërisë shqiptare i nevojitet që të rrisë numrin e përfaqësimit të vajzave në sundimin e ligjit dhe demokracisë, prandaj studime të mirëfillta për barazinë gjinore në nivel kombëtar janë shumë të domosdoshme dhe një mekanizëm i mirë për të eliminuar pengesat. Kërkimet shkencore dhe puna në terren për çështje që kanë të bëjnë me barazinë gjinore të rinjtë ndihmojnë në eliminimin e pengesave për barazi gjinore.

Studimet e mirëfillta që lidhen me ndërgjegjësimin e çështjeve gjinore ndihmojnë që të rinjtë të bashkëpunojnë. Studimet në nivel kombëtar ndihmojnë për të kuptuar shkaqet dhe pasojat e fenomenit, por edhe se cilët mund të jenë mekanizmat që të çojnë në arritjen e barazisë gjinore të të rinjve, pavarësisht pengesave sociale dhe kulturore. Gjithashtu, këto studime ndihmojnë për të kuptuar se cilët janë instrumentet që ndihmojnë në përballjen me sfidën që kanë këta të rinj për të kaluar më pas në tregun e punës, ku pavarësisht përmirësimeve, papunësia e të rinjve në Shqipëri mbetet ende e lartë ⁸

Bazuar në eksperiencën e vendeve më të përparuara, duke punuar ngushtësisht me konventat ndërkombëtare dhe duke garantuar zbatimin e akteve ligjore në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, shoqëria shqiptare e shmang pengesën që vjen nga mentaliteti i vjetruar i pabarazisë gjinore dhe shkon drejt zhvillimit. Të rinjtë janë më të hapur ndaj bashkëpunimit, prandaj nuk janë të pakta rastet kur vetë ata janë kthyer në nxitës të barazisë gjinore.

Marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj

Nuk ka asnjë dokument ndërkombëtar/evropian që të trajtojë në mënyrë specifike apo të mëvetësishme pjesëmarrjen e të rinjve nga këndvështrimi gjinor. Kombet e Bashkuara, apo dhe vetë Bashkimi Evropian, kanë zgjedhur një fokus lidhës të të dy koncepteve, duke e përmendur pjesëmarrjen e të rinjve si një instrument apo mjet që do fuqizojë ndryshimin dhe zhvillimin e mendësive dhe politikave për barazinë gjinore. Edhe objektivat strategjike të Bashkimit Evropian e vendosin barazinë gjinore si një kauzë më vete nga pjesëmarrja e të rinjve. Nga analiza e dokumenteve ligjore në planin ndërkombëtar, evropian, rajonal dhe kombëtar, vëmë re që pjesëmarrja e të rinjve në këndvështrimin gjinor nuk është një kapitull i veçantë i trajtuar nga legjislatori, por interpretimet juridike dhe më gjerë ato politike mundësojnë lidhjen e ngushtë të pjesëmarrjes së të rinjve me kauzën e barazisë gjinore. Pjesëmarrja e të rinjve nuk është çështje vetëm e djemve, por një mundësi që shteti i së drejtës duhet t'ua ofrojë dhe garantojë të dyja gjinive. Ky aspekt theksohet edhe në misionin dhe vizionin e një pjese të konsiderueshme të organizatave ndërkombëtare.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut e përfshin diskriminimin gjinor (neni 14), duke sanksionuar se gëzimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë do të sigurohen pa diskriminim për arsye seksi, race, ngjyre, gjuhe, feje... etj. Konventa e ngre kauzën e diskriminimit gjinor si një element të rëndësishëm për të disponuar në mënyrë të qetë të drejtat dhe liritë themelore të individit. Karta e të Drejtave Themelore të BE-së ndalon po kështu diskriminimin për çdo lloj shkak, duke përfshirë seksin (neni 21 i Kartës).

⁸Economic Reform Programme 2020-2022, Government of Albania, January 2020, gjendet në: <https://new.financa.gov.al/wpcontent/uploads/2020/03/Economic-Reform-Programme-2020-2022.pdf> (Përdorur më 23 shtator, 2023), faqe 115

⁹Shih dokumentin e OKB-së lidhur me këtë pjesë https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/CSE/65/EGM/Aruri_Advancing%20youth%20participation%20to%20achieve%20gender%20transformative%20change_EP7_EGMCSE65.pdf

Ekziston gjithashtu edhe Konventa mbi Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit kundër Grave e miratuar nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara (CEDAW).¹⁰ Këto dimensione dhe parime kryesore të vendosura nga dokumentet ndërkombëtare dhe evropiane janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e vajzave të reja me të drejta të barabarta me djemtë.

Legjislacioni shqiptar dhe pjesëmarrja e të rinjve në këndvështrimin e barazisë gjinore

Legjislacioni shqiptar i trajton çështjet gjinore më tepër në një panoramë gjithëpërfshirëse, duke mos shfaqur në mënyrë direkte elementë të barazisë gjinore apo diskriminimit gjinor kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e të rinjve. Gjithsesi, edhe pse legjislacioni shqiptar ka këtë veçori teknike, elementë të barazisë gjinore, që lidhen me pjesëmarrjen e të rinjve, i gjejmë në akte të ndryshme ligjore.

Diskriminimi gjinor, barazia gjinore, rritja e pjesëmarrjes së vajzave në sferën publike, politike dhe shoqërore janë disa çështje të cilat duhet të mbahen në një fokus specifik kur bëhet fjalë për të analizuar përmbajtjen e duhur ligjore. Përveç rrugës së gjatë që ka përpara zbatimi i duhur i këtij mekanizmi, nevojitet edhe një përmirësim i legjislacionit, duke e theksuar në vendin dhe kohën e duhur dimensionin gjinor të pjesëmarrjes së të rinjve. Kjo kërkesë bëhet jo vetëm për të pasur një moderim të ri e të duhur të mënyrës se si ligji duhet të vishet me këtë dimension, por, mbi të gjitha, për të kultivuar sjelljen e duhur të barazisë gjinore te të rinjtë, si e tashmja dhe e ardhmja premtuese e zhvillimit në tërësi të shoqërisë.

Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, duke përmendur që shkaqe të tilla si etnia, përkatësia fetare, shoqërore, etj., të mos bëhen shkak për diskriminim dhe trajtim diferencial. Ky parashikim i përgjithshëm, sigurisht që duhet të zbatohet edhe për pjesëmarrjen e të rinjve me fokus gjinor.

Kushtetuta jonë pësoi ndryshime në vitin 2020-2021. Në kuadër të këtyre ndryshimeve, gjujkojmë se do të ishte me vend përfshirja e disa termave, të cilat do të lidhnin konceptin demokraci me pjesëmarrjen, si pjesa më ekzistenciale e saj. Gjithsesi, Kushtetuta jonë vendos parimin e barazisë, të detyrueshëm për t'u zbatuar edhe në pjesëmarrjen e të rinjve, duke respektuar parimin e barazisë gjinore. Kujtojmë gjithashtu se Kushtetuta merr në mbrojtje të veçantë fëmijët, gratë dhe vajzat, duke evidentuar edhe njëherë rëndësinë që këto grupe kanë për zhvillimin e shoqërisë me parametra demokratikë.

Ligji kryesor që rregullon dimensionin e barazisë gjinore në vendin tonë është Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, 'Për barazinë gjinore në shoqëri'. Ligji e trajton këtë dimension në këto fusha kryesore:

Rregullon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në:

¹⁰ Ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin 7767, datë 09.11.1993 dhe ka hyrë në fuqi më 11 maj 1994.

- marrëdhëniet e punës (pjesa IV);
- arsim dhe kualifikim (pjesa V);
- media (pjesa VI).

Ligji ofron edhe mundësinë e masave të përkohshme me qëllim rritjen e përfaqësimit të grave dhe vajzave në aktivizmin publik:

1. Masat e veçanta të përkohshme përfshijnë kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor, rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe në jetën publike, fuqizimin ekonomik dhe të pozitës së personave të secilës gjini në fushën e punës, përmirësimin në mënyrë të barabartë të nivelit arsimor, si dhe masa të tjera në çdo fushë, ku personat e njëjës gjini nuk gëzojnë pozitë të barabartë me personat e gjinisë tjetër.
2. Nuk përbëjnë diskriminim për shkak të gjinisë rastet kur organet shtetërore marrin masa të veçanta të përkohshme, përfshirë edhe dispozita ligjore, që synojnë përsheptimin e vendosjes së barazisë faktike ndërmjet femrave dhe meshkujve. Këto masa duhet të pushojnë së ekzistuari sapo të jenë arritur objektivat e barazisë gjinore, për të cilat janë krijuar.¹¹

Ligji për barazinë gjinore shpreh dhe saktëson kuotën gjinore si një mjet për të rritur pjesëmarrjen e gruas në jetën publike e politike. E vlerësojmë si pozitiv dhe premtues faktin që ky ligj e lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe eksplicite realizimin e barazisë gjinore në proceset vendimmarrëse me pjesëmarrjen si një dimension më i gjerë.

Ndërkohë, edhe Kodet e Republikës së Shqipërisë vendosin mbrojtje specifike për gratë dhe vajzat në procese të ndryshme të zhvillimit (marrëdhëniet e punësimit, martesat, krijimi i familjes etj).

Kodi Zgjedhor rithekson në të njëjtën mënyrë si Ligji për Barazinë Gjinore kuotat gjinore (30 për qind për zgjedhjet e përgjithshme dhe 50 për qind për ato vendore).

Për sa u përket akteve të pushtetit ekzekutiv, në këtë brez të të drejtave vëmë re një risi sa i përket zhvillimit të dimensionit gjinor dhe dimensionit pjesëmarrës. Këshilli i Ministrave ka miratuar me vendim Planin e Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 'Gruaja, paqja dhe siguria', ku fusha e parë është ajo e pjesëmarrjes. Ky plan veprimi shpreh, me indikatorë specifikë, elementët e pjesëmarrjes me fokus gjinor. Sigurisht, plani përqendrohet në një pjesë të konsiderueshme edhe të rinjtë, duke ofruar edhe aspekte teorike për konceptimin e duhur të politikave që duhet të ndjekin organet shtetërore, si dhe statistika të disponuara deri tani nga burime të ndryshme. Duke qenë se plani i veprimit është miratuar rishtazi (ndodhet ende në fazën përfundimtare të konsultimeve publike), rekomandojmë që sjellja në vëmendje e përmbajtjes së këtij plani të orientojë në mënyrën e duhur organizatat dhe aktorët shtetërorë që punojnë në fushën e forcimit dhe përmirësimit të pjesëmarrjes së të rinjve, sidomos me fokus gjinor.

¹¹Shih nenin 8, https://www.mod.gov.al/images/PDF/barazia_gjinore_shqeri.pdf
¹²https://konsultimpublik.gov.al/documents/RENJK_631_Draft-PlanVeprimi-zbatimi-i-Rezolutes-1325--2023-2027.pdf-eva.pdf

Në kuadër të miratimit të Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, një dokument rajonal u përgatit në vitin 2006 nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës në bashkëpunim me anëtarët dhe anëtarët e shoqatave, si pjesë e një projekti të mbështetur financiarisht nga Këshilli i Europës. Karta është përkthyer në 28 gjuhë të ndryshme (përfshirë edhe gjuhën shqipe), si dhe është nënshkruar nga 1800 bashki në 36 vende të Europës, në të cilat përfshihen tashmë edhe 13 bashki nga Shqipëria. Karta Evropiane për Barazi përbëhet nga 30 nene që përfaqësojnë fusha të ndryshme të kompetencave të autoriteteve vendore dhe rajonale. Nga vëzhgimi i disa planeve (ato të publikuara në faqet në internet të bashkive si p.sh.: Gramsh, Bulqizë, Cërrik) vihet re se pjesëmarrja e vajzave shpesh përmendet duke përcaktuar edhe indikatorët e veprimit, si në aspektin konceptual ashtu dhe në atë institucional.

Dokumente politike dhe strategjike mbi çështjet gjinore

Strategjia për të rinjtë, e miratuar rishtazi, e thekson në objektivin e përgjithshëm dhe ata specifikë se priret të jetë e orientuar drejt aspekteve të barazisë gjinore, duke realizuar pjesëmarrje më specifike dhe domethënëse për vajzat dhe gratë e reja. Nga pikëpamja e drejtësisë dhe barazisë gjinore masat janë formuluar duke marrë në konsideratë kushtet specifike për vajzat dhe gratë e reja për të përballuar më mirë sfidat e zhvillimit profesional dhe hyrjes në jetën familjare. Në të gjitha rastet, masat e parashikuara ndërliken me politikat nxitëse gjinore dhe i shërbejnë fuqizimit të vajzave dhe grave të reja, duke marrë në konsideratë edhe vajzat e bëra nëna apo të martuara në moshë të hershme, si dhe ato që gjenden në situata të cënueshme. Nga pikëpamja gjinore masat e parashikuara synojnë edhe rritjen e pjesëmarrjes së vajzave, si në jetën sociale ashtu edhe në atë profesionale. Strategjia e pozicionon këtë faktor si një element me indikatorët përkatës matës për të siguruar jo vetëm të drejtën, por edhe mundësinë për pjesëmarrje.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 ¹⁴

4 qëllime strategjike:

- Përbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat, burrat, të rinjtë, djemtë.
- Përbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.
- Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
- Aplikimi i integritimit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri.

¹³Shih Plani Vendor i Bashkisë Cërrik për Barazinë Gjinore https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00X8ZN.pdf

¹⁴https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/WEB_Strategjia-Kombetare-AL.pdf

Strategjia për barazinë gjinore përcakton ngritjen e një sërë institucionesh dhe funksionimin e tyre si, ministri që mbulon kauzat e barazisë gjinore, nëpunësi i barazisë gjinore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Aleanca e Grave Deputete, Aleanca Kombëtare e Këshilltarëve etj. Do të ishte me vend që Strategjia të parashikonte dy mundësi:

- a. përcaktimin dhe zbatimin e aktiviteteve që lidhen dhe nxisin çështjen e pjesëmarrjes së të rinjve me fokus gjinor
- b. ndërtimin e një strukture apo të paktën krijimin e një pozicioni për një nëpunës (sidomos në nivel bashkie) që të kishte kompetencë funksionale specifike këtë dimension.

Njëra nga këto alternativa do ta paraqiste këtë koncept në mënyrën e duhur, si dhe me qasjen e nevojshme për të rritur pjesëmarrjen reale të vajzave në politikë e shoqëri.

Indikatorët e strategjisë përputhen edhe me Planin Kombëtar të Integritit Evropian që e përmend këtë aspekt për aq sa është i nevojshëm në kuadër të kapitujve të integritit.

V. Gjetjet dhe analiza


Të dhëna demografike

Studimi përfshiu një kampion prej 650 të rinjsh e të rejash të grupmoshave 15–19 vjeç dhe 20–24 vjeç. Grupmosha 15-19 vjeç zë përqindjen më të lartë të të anketuarve, në total 60%, dhe 40% e të anketuarve i takojnë grupmoshës 20-24 vjeç (Figura 1).


Nga pyetësi rezulton se përqindja më e lartë e të anketuarve përbëhet nga gjinia femërore, përkatësisht 63% e numrit total të të anketuarve, përkundrajt 37% të cilët i takojnë gjinisë mashkullore (Figura 2).

Në Figurën 3 paraqitet shpërndarja e të anketuarve në nivel qarku. Vendin e parë e zë Tirana me 167 përgjigje. Në vend të dytë renditet Elbasani me 107, ndjekur nga Fieri me 90 përgjigje.


1 Kampioni- grupmoshë (%)



2 Kampioni-gjini (%)



3 Kampioni- qark (%)



Për sa i përket përkatësisë etnike të të rinjve që i janë përgjigjur pyetësorit, 92% deklarojnë se janë shqiptarë, 4% i përkasin komunitetit rom dhe 4% komunitetit egjiptian. Një pjesë e mirë e këtyre të rinjve e të rejave ndjekin arsimin parauniversitar (45%), 31% janë duke ndjekur studimet e larta, 16% janë të punësuar dhe 2% ndjekin arsimin profesional. 6% e të anketuarve deklarojnë se nuk janë duke ndjekur studimet dhe as nuk janë duke punuar.

Për përmbushjen e qëllimit të këtij studimi dhe për interpretim të mëtejshëm të rezultateve të pyetësorit, u realizuan 11 fokus grupe në rang kombëtar në qytete të tilla si Tiranë, Korçë, Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Berat, Elbasan, Fier dhe Vlorë, ku morën pjesë 100 të rinj e të reja të moshës 15-24 vjeç, të cilët ndanë mendimet dhe botëkuptimet e tyre tepër të vlefshme për rezultatet dhe rekomandimet e këtij studimi. Shpërndarja e kampionit sipas kritereve ishte:

15-19 vjeç – 77%

20-24 vjeç – 23%

Vajza – 69%

Djem – 31%

Zona rurale – 26%


Komuniteti Rom/Egjiptian – 7%



Gjetjet e studimit

Momenti i parë kur të rinjtë ballafaqohen me njohjen e konceptit “Barazia gjinore” është komuniteti në të cilin jetojnë, kryesisht familja dhe shkolla. Këto dy institucione shumë të rëndësishme të shoqërisë kanë si qëllim që t’u mësojnë të rinjve se djemtë dhe vajzat kanë të drejta të barabarta për sa i përket përfshirjes në mënyrë të njëjtë në jetën sociale.

Nga rezultatet e pyetësorit rezulton se shkolla zë vendin e parë, ku 295 (45.3%) të rinj janë përgjigjur se për herë të parë janë njohur me konceptin e barazisë gjinore në shkollë. 221 prej tyre (34%) janë njohur për herë të parë në familje, 40 (6.1%) në qendra rinore dhe 37 (5.6%) në organizata të ndryshme të shoqërisë civile (Figura 4).



4 Institucionet ku të rinjtë njihen me konceptin e barazisë gjinore

Nga këto të dhëna, është më se e kuptueshme se realisht familja dhe shkolla zënë një vend parësor në prezantimin e konceptit të barazisë gjinore dhe stereotipave gjinorë që lidhen me të, duke bërë kështu të mundur që të rinjtë të njihen me këtë realitet që fatkeqësisht ekziston, si dhe duke dhënë kontributin e tyre që këta të rinj, pasi janë njohur me këtë koncept, të arrijnë të kuptojnë domosdoshmërinë e eliminimit të këtyre stereotipave të krijuar në shoqëri. Nëse bazohemi te këto shifra në lidhje me njohjen e konceptit, dukshëm ekziston një diferencë midis atyre që e kanë marrë informacionin nga shkolla dhe familja kundrejt atyre që e kanë marrë informacionin nga qendra rinore apo organizata të shoqërisë civile. Nga këto të dhëna rezulton se familja dhe shoqëria e japin kontributin e tyre në rezultate të larta dhe thuajse të përafërta midis tyre, kurse qendrat rinore dhe organizatat e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, pavarësisht përpjekjeve të deritanishme, projektet, trajnimet dhe këshillimet sociale e ligjore duhet të shtohen edhe më shumë, për njohjen e të rinjve me çështjet gjinore.

Po duke u bazuar në rezultatet e pyetësorit, pjesëmarrja e të rinjve në projekte apo trajnime të këtyre organizatave, mbetet thuajse në shifra të përafërta midis atyre që nuk kanë qenë asnjëherë në trajnime (37%) dhe atyre që kanë qenë disa herë (34%). Pjesa tjetër e të rinjve është përgjigjur se kanë qenë vetëm një herë (29%). Edhe nga këto shifra, theksohet edhe një herë nevoja për të rritur numrin e trajnimeve dhe projekteve nga organizatat e ndryshme, nga ku të rinjtë marrin më së miri informacion më të hollësishëm në lidhje me të drejtat dhe liritë e tyre për përfaqësi të barabartë gjinore në demokraci dhe në zhvillimin e vendit. Gjatë fokus grupeve, vetë të rinjtë e qyteteve të ndryshme kanë kërkuar që të ketë më shumë aktivitete vetëm me të rinjtë në lidhje me këtë çështje. Të rinjtë e Korçës shprehen se duhen organizuar më shumë aktivitete në shkollë, por edhe nga bashkia, që të rinjtë të kenë më shumë mundësi për të qenë aktivë. Gjithashtu, të rinjtë e Shkodrës shprehen se kalendari i aktiviteteve duhet t'u vihet në dispozicion dhe duhet të jetë i dukshëm në rrjete sociale, në mënyrë që të përdoret nga të gjithë të rinjtë. Po ashtu, edhe të rinjtë e qytetit të Vlorës kanë vënë në dukje rëndësinë e bashkëpunimit të shkollës me të gjitha organizatat që zhvillojnë aktivitete. Shembujt e këtyre qyteteve dhe shumë të tjerëve ku u realizuan fokus grupet janë elementë të dukshëm të kërkesës dhe nevojës që kanë të rinjtë për marrjen e informacionit të saktë mbi barazinë gjinore.

Duke u njohur që në krye të herës nga familja dhe shkolla me konceptin e barazisë gjinore dhe duke vijuar më tej me punën e gjithë komunitetit për zhdukjen e stereotipave, të rinjtë shqiptarë janë tashmë të vetëdijshëm se nuk janë burrat ata që marrin vendime në shoqërinë shqiptare. 79% e të rinjve janë përgjigjur se nuk janë vetëm burrat ata që marrin vendime dhe 13% e tyre kanë pohuar të kundërtën. Përgjigjet lidhur me ndërgjegjësimin e të rinjve se nuk janë vetëm burrat ata që marrin vendime janë shumë herë më të larta se përgjigjet e atyre që e mendojnë ndryshe. Ky fakt tregon se shoqëria, si pasqyrë e jetesës së vetë të rinjve, ka rritur numrin e përfaqësuesve të gruas në vendimmarrje, gjë që, me sa duket, për të rinjtë është e dukshme.

Respektimi i barazisë gjinore është element kyç në zhvillimin e qëndrueshëm të një vendi, si rrjedhojë përfshirja e të rinjve pa dallim gjinor në jetën demokratike është kusht i domosdoshëm që duhet të njihet dhe të vlerësohet nga e gjithë shoqëria shqiptare. Vetë të rinjtë shprehen se në rrethin e tyre shoqëror qëllon të flitet edhe për tema që kanë të bëjnë me çështjet gjinore. Jo shumë shpesh, por ndonjëherë, e kanë pjesë të diskutimeve të ndryshme, nga ku kanë mësuar se sa i rëndësishëm është fuqizimi i të rinjve në demokraci dhe se sa përparësi duhet të ketë barazia gjinore. Përqindja e shpeshtësisë ndahet në: Shumë shpesh 17%, shpesh 31%, ndonjëherë 43%, dhe asnjëherë 10%. Këto shifra tregojnë qartë se përqindja e mosdiskutimit të kësaj çështjeje mes tyre është shumë e vogël (vetëm 10%) krahasuar me parametrat e tjerë. Pavarësisht shpeshtësisë, duke qenë se barazia gjinore është thelbësore në zhvillimin e të rinjve, fakti që mes tyre diskutohet si çështje, na bën të kuptojmë se vetë ata janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e këtij aspekti. Ky është një tregues i mirë se si të rinjtë i japin rëndësi mes tyre kësaj çështjeje kaq të ndjeshme për mirëqenien e tyre dhe mbarë shoqërisë shqiptare. Megjithatë, në disa qytete, përfshirja e të rinjve në takime apo aktivitete rinore paragjykohet. Për shembull, gjatë fokus grupit me të rinjtë e qytetit të Dibrës, vetë ata u shprehën se djemtë paragjykohe kur marrin pjesë në takime sociale dhe vajzat dekurajohen për të mos marrë pjesë në takime ku numri i djemve është më i madh se i vajzave.

Interesi i të rinjve për t'u mirëinformuar mbi të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore rritet kur vetë ata diskutojnë, së pari, në rrethin e tyre, dhe së dyti, në familje. Shoqëria dhe familja janë kontribues të mirë për formimin e një të riu apo të reje sot, të cilët kanë në vëmendje kërkesën për rritje intelektuale dhe të drejtën për t'u përfaqësuar pa dallim gjinor. Familja është bërthama kryesore nga ku të rinjtë marrin informacionin e parë për çdo çështje sociale, si dhe nga ku mësohen fillimisht me mënyrat se si duhet të reagojnë ndaj fenomeneve shoqërore. Pyetjes se sa ndikojnë prindërit apo sa nxitës janë për pjesëmarrjen e djemve apo vajzave në aktivitete, 44% e të rinjve i përgjigjen se prindërit në Shqipëri nxisin më shumë djemtë, krahas 11% të të rinjve që mendojnë se nxisin më shumë vajzat. Ndërkohë që 46% raportojnë se nxiten njëloj, si vajzat dhe djemtë.

'Edhe në shkollë më shumë besohet se presidenti i shkollës duhet të jetë mashkull, sepse një vajzë nuk mund ta bëjë këtë rol, pasi për disa organizime ku duhet të kërkojnë dhe bashkëpunojnë me biznese vendore, vajzat nuk mund ta bëjnë apo paragjykojnë.' – djalë, 18 vjeç, Dibër

Më lart kemi përmendur faktin se sa rol të rëndësishëm ka shkolla dhe familja në formimin e të rinjve dhe se sa ndikues janë në lidhje me çështje të barazisë gjinore. Shifrat që tregojnë se prindërit nxisin më shumë vajzat janë tejet të ulëta, krahasuar me shifrat që tregojnë se prindërit nxisin më shumë djemtë. Kjo gjë tregon se ndikimi kulturor nga brezi në brez vijon të jetë shumë i madh. Nuk ka ndonjë ndryshim të madh mes shifrave që tregojnë se prindërit nxisin njësoj si djemtë dhe vajzat (46%) dhe atyre që prindërit nxisin më shumë djemtë (44%). Një përqindje thuajse e barabartë për të dyja rastet dhe tejet e papërfillshme për prindërit që nxisin më shumë vajzat në aktivitete. Nga këto shifra kuptojmë natyrën patriarkale që, fatkeqësisht, ndikon ende në një pjesë të familjeve tona, ku ende nuk pranohet plotësisht se vajza ka të drejtë të veprojë njësoj si djemtë, bazuar në të drejtat që u takojnë.

Bazuar te fokus grupet e realizuara me këta të rinj, vihet re se në disa qytete si Berat, Dibër dhe Durrës, vajzat paragjykojnë kur marrin pjesë në aktivitete ku ka djem dhe se këta të fundit shihen, më së shumti, si më të aftë në drejtim. E njëjta gjë nuk mund të thuhet për qytetin e Elbasanit, ku të rinjtë mendojnë se është rritur fuqizimi te vajzat, të cilat në këtë qytet shihen si më të nxitura se djemtë. 56.6% e të rinjve shprehen se djemtë dhe vajzat kanë të drejta të barabarta përfaqësimi, 30.7% mendojnë të kundërtën dhe vetëm 12.7% shprehen se nuk e dinë. Në dukje, numri i atyre që mendojnë se kanë të drejta përfaqësimi të barabarta është më i lartë se i atyre që shprehen për të kundërtën, gjë që vërteton edhe njëherë se të rinjtë e kanë kuptuar se e drejta për përfaqësim i takon gjithkujt dhe se si djemtë ashtu dhe vajzat kanë të drejtat dhe liritë e tyre për të qenë përfaqësues në një sistem demokratik.

Pavarësisht të kuptuarit të drejtë nga vetë të rinjtë për barazinë në përfaqësim, në fokus grupe ata nuk ngurojnë të shprehin shqetësimin e tyre se familja, edhe pse një mekanizëm kryesor për njohjen e barazisë gjinore te të rinjtë, bën diferencime për sa i përket përfaqësimit të tyre. Të rinjtë e qyteteve Berat, Dibër dhe Kukës u shprehën se vajzat ndihen më pak të inkurajuar për përfaqësi dhe se djemtë shihen më pranë drejtimit, ndërsa vajzat më pranë punëve të shtëpisë.

Të rinjtë e qyteteve Fier dhe Korçë u shprehen se vajzat paragjykohe për përfaqësim nga mentaliteti i vjetër dhe se janë më të angazhuara në punët e shtëpisë se sa në aktivitete të tjera jashtë saj, megjithatë të rinjtë korçarë mendojnë se vajzat nxiten më shumë dhe prindërit i mbështesin ato ekonomikisht, moralisht dhe psikologjikisht. Të rinjtë e Beratit janë shprehur se familja i lë djemtë disi më të lirë për pjesëmarrje në aktivitete rinore, ndryshe nga të rinjtë e Elbasanit, të cilët shprehen se familja po i inkurajon vajzat që të përfshihen në aktivitete rinore dhe të kenë një edukim të mirë, në mënyrë që të kenë më tepër siguri për të ardhmen e tyre. Në këtë mënyrë, ato nuk do të mbeten të paditura dhe të paaferta për të drejtuar dhe menaxhuar në të ardhmen. Për qytetet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, diskriminimi ndeshet në një moshë më të madhe, kur të rinjtë afrohen më pranë profesioneve, por gjatë aktiviteteve të tjera diskriminimi ndihet disi më pak. Të rinjtë e Elbasanit shprehen se vajzat po shihen më pranë fuqizimit dhe se familja ka besim në mënyrën e tyre të të punuarit. Edhe të rinjtë e Lezhës dhe Vlorës shprehen më së shumti për një lloj barazie në përfaqësimin e të rinjve dhe se e kundërta ndodh vetëm në rastet kur aktivitetet, si pasojë e natyrë së tyre, kanë përparësi praninë e djemve.

Po nga këto fokus grupe del qartë nga të gjithë të rinjtë e qyteteve të ndryshme se diskriminimi është më i dukshëm kur krahasojmë zonat rurale me ato urbane. Sipas tyre, vajzat në fshat janë më të diskriminuara dhe më të painformuara. Në lidhje me këtë, kujtojmë rastin e vajzës 17 vjeçare nga Guri i Zi, e cila gjatë fokus grupit shprehet se:

“Ndihej e paragjykuar pasi vetë mësuesit na thonë se ju nuk jeni si vajzat e qytetit”.

Gjithashtu, edhe në fokus grupin e realizuar në Dibër, të rinjtë shprehen se vajzat në fshat kanë akoma më shumë vështirësi për shkak të mungesës së informacionit dhe distancave shtëpi-shkollë.

Ka mendime që disa pozicione (drejtuese apo sipërmarrëse) janë për meshkuj, sepse femrat janë më të dobëta dhe nuk kanë aftësi t'i mbajnë. Të rinjtë e Kukësit shprehen se në zonën e tyre djemtë janë më të favorizuar se vajzat. Këto të fundit janë më pak të përfaqësuara edhe pse ndihet përpjekja për pavarësi. Megjithatë, të rinjtë e këtij qyteti mendojnë se djemtë shihen nga familja si pasues të trashëgimisë. Edhe në Dibër është ende i njëjti mentalitet. Akoma në Dibër familja gëzon më shumë kur lind një djalë sesa një vajzë, sidomos në rastet kur kanë vajzë tjetër, siç shprehet një e re.

Për sa u përket dallimeve gjinore që mund t'u jenë bërë të rinjve gjatë pjesëmarrjes në aktivitete rinore, është shumë e lartë përbindja e atyre që nuk kanë përjetuar një paragjykim të tillë. 63% e të rinjve shprehen se nuk kanë përjetuar paragjykim gjinor gjatë pjesëmarrjes në aktivitete rinore, kurse 24% shprehin të kundërtën. Gjithsesi, nëse marrim parasysh 13% të të rinjve që kanë preferuar të mos përgjigjen, duke prezumuar faktin që kanë qenë të paragjykuar dhe nuk janë ndier të gatshëm ta pohojnë këtë fakt, si dhe 24% të të rinjve të cilët janë përgjigjur se kanë përjetuar paragjykim gjinor, kjo rezulton me një shifër të konsiderueshme prej 37% të të rinjve që kanë përjetuar paragjykim gjinor gjatë pjesëmarrjes në aktivitete rinore.

Ky tregues na shtyn të mendojmë se në aktivitete mes tyre, të rinjtë kanë filluar të kuptojnë dhe të ndërveprojnë, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe barazinë gjinore. Të rinjtë janë të vetëdijshëm se sa e rëndësishme është përfshirja e tyre në aktivitete sociale dhe në trajnime informuese për barazinë gjinore. Gjatë fokus grupit në qytetin e Elbasanit një vajzë shprehet:

“Pak me vonesë, por unë tani e kuptoj se sa e rëndësishme është të marrësh pjesë në organizata e trajnime, edhe sot prandaj kam ardhur, të shfrytëzoj këto mundësi”.

Familja dhe shkolla janë kontribues të mirë për formimin e të rinjve, duke punuar për t’i bërë sa më të denjë për një shoqëri të zhvilluar, por, gjithashtu, edhe vetë rrethi i tyre shoqëror është një kontribues i dytë i mirë, që i ndihmon të kuptojnë rëndësinë e barazisë gjinore në kontekstin social ku jetojnë.

Familja dhe shkolla, që shihen si nismëtare të njohjes së të rinjve me konceptin e barazisë gjinore, duhet të heqin dorë nga mentaliteti i vjetëruar, ku gjithçka merr vazhdimësi vetëm nëpërmjet djalit, për të mos i transmetuar kështu vajzës pasigurinë për të ardhmen. Vajza 17 vjeçare nga Kukësi shprehet në fokus grup:


“Djemtë nxiten më shumë. Përderisa që në këtë moshë vëllai im mendon se gjithçka e prindërve është trashëgimia e tij dhe unë nuk kam të drejtë të kem pjesën time, atëherë mendoj që, sigurisht, prindërit nxisin më shumë djemtë, dhe pse me kalimin e kohës mentaliteti sa vjen e po zbutet më shumë.”

Kjo është mendësi e shumë djemve shqiptarë dhe që këtu fillon pabarazia, sepse një vajzë duhet ta nisë çdo gjë nga zero, që 18 vjeçe, nëse nuk do të martohet, por të jetë e pavarur, ndërsa një djalë ka më shumë siguri, sepse ka diçka nga prindërit. Në fakt, nxitja duhet të jetë e njëjtë për të dyja gjinitë. Si vajza dhe djali janë njësoj përfaqësues të denjë të së ardhmes. Pavarësisht përpjekjeve për ta realizuar këtë gjë, ende në familjet shqiptare duket se merr përparësi djali. Vajza 15 vjeçare nga Lezha shprehet:

“Vë re që në familjet tona, sado që ka ndryshuar në krahasim me të shkuarën, prapë është mentaliteti që djali duhet t’i ketë të gjitha dhe ai është përparësia në familje, duke lënë kështu vajzën mënjane”.

Pavarësisht gjithë aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë për sensibilizimin e shoqërisë në lidhje me respektimin e barazisë gjinore, situata e përfshirjes së vajzave në jetën demokratike, në raport me atë të djemve, është e tillë që vetë të rinjtë mendojnë se vajzat apo gratë janë më të përfshira në familje se sa në role drejtuese, vendimmarrje, politikë e punësim.

5 Sektorët ku vajzat dhe gratë janë më të angazhuara



Pjesa më e madhe e të rinjve mendon se vajzat janë më të përfshira në familje sesa në vendimmarrje dhe rol drejtues dhe në fakt, ky është interpretimi që të rinjtë i bëjnë asaj që shohin dhe përjetojnë çdo ditë në kontekstin tonë. Ka një rritje të përqindjes së përfshirjes në edukim dhe politikë, pasi kohët e fundit, nga aktorë të ndryshëm kulturorë dhe socialë, bëhet një punë e mirë për përfshirjen e vajzave/grave në këto fusha, por në raport me përfshirjen në familje, përfshirja e tyre në punësim është dukshëm e ulët.

VI. Përfundime dhe Rekomandime

Të rinjtë janë nxitës të barazisë gjinore dhe për këtë arsye, i gjithë komuniteti ka përparesi që të formojë një të ri/të re të denjë për një shoqëri ku, si vajzat ashtu dhe djemtë, kanë të drejta dhe liri të njëjta për t'u arsimuar, edukuar, punësuar dhe përfaqësuar në të gjithë komponentët që formojnë një vend të zhvilluar me sistem demokratik të qëndrueshëm.

Është thelbësore të pranohet se trajtimi i çështjeve që lidhen me rininë kërkon një qasje të shumanshme që përfshin politikën e qeverisë, organizatat e shoqërisë civile, institucionet arsimore dhe pjesëmarrjen aktive nga vetë të rinjtë.

Bazuar në analizën e të dhënave të 650 pyetësorëve dhe 100 të rinjve pjesëmarrës në fokus grupe, të rinjtë e angazhuar dhe ekspertët kanë nxjerrë përfundime dhe kanë bërë rekomandime në lidhje me gjendjen dhe mundësitë e fuqizimit, pjesëmarrjes dhe trajtimit të paragjyqimeve gjinore të të rinjve në Shqipëri.

Rekomandimet për përmirësimin e strukturave dhe praktikave rinore në mbështetje të avancimit të sundimit të ligjit, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore janë të bazuara në fakte,.

Gjithsesi, përpara se të arrijmë në rekomandime, duhen theksuar disa nga pengesat e identifikuara nga të rinjtë gjatë fokus grupeve lidhur me aspekte/sfidat gjinore që ndikojnë në pjesëmarrjen e të rinjve:

- **Pengesat individuale** - Gjatë fokus grupeve të rinjtë u shprehën se ka disa pengesa apo faktorë individualë që ndikojnë në mosangazhimin apo mospjesëmarrjen e të rinjve në shoqëri dhe që lidhen me aspekte gjinore, si p.sh., djemtë janë në punë dhe nuk kanë kohë për angazhime të tjera, apo vajzat kujdesen për anëtarë të familjes (gjyshër, fëmijë më të vegjël) dhe nuk mund të marrin pjesë në aktivitete të tjera shoqërore.

Në të shumtën e rasteve, vajzat u shprehën se djemtë nuk kanë interes të angazhohen në aktivitete sociale, janë indiferentë dhe vendosin në plan të parë përparësitë personale (punën, karrierën), ndërkohë që shumë të rinj, kryesisht djem, pohuan se nuk angazhohen sepse kanë plane për t'u larguar nga vendi dhe janë të fokusuar drejt këtij objekti.

Shumica e të rinjve, pavarësisht gjinisë, u shprehën se ka shumë faktorë të tjerë që ndikojnë në mospjesëmarrjen e të rinjve, si mungesa e vetëbesimit, mungesa e interesit, pesimizmi dhe ankthi për të ardhmen, mungesa e shpresës se gjërat mund të ndryshojnë dhe fakti se u mungojnë modele të suksesshme dhe pozitive që marrin parasysht mendimet e tyre dhe i bëjnë të ndihen të dëgjuar.

- **Pengesat në familje** - Të rinjtë në fokus grupe shpjeguan qartë mendimet patriarkale të familjeve shqiptare dhe mungesën e ndërgjegjësimit të tyre mbi përfitimet që sjell angazhimi i barabartë i vajzave dhe djemve në shoqëri. Sipas pjesëmarrësve në fokus grupe, shpesh vajzat pengohen të bëhen pjesë e aktiviteteve kur ka pjesëmarrje të lartë të djemve apo kur vendndodhja ku kryhet aktiviteti është e largët, kjo e lidhur dhe me çështje të sigurisë, sidomos për vajzat që jetojnë në zona rurale. Për shumë familje, përparësi, sidomos për djemtë, është shkollimi dhe punësimi i tyre (përfitimet materiale) kundrejt angazhimit komunitar. Ndërsa, shpesh ndodh që familja angazhon vajzat në punët e shtëpisë dhe kujdesin për anëtarët e familjes, duke anashkaluar kështu rëndësinë e angazhimit të tyre në shoqëri.
- **Pengesat në shkollë dhe komunitet** - Një ndër pengesat për pjesëmarrjen e të rinjve, që u theksua më shumë gjatë fokus grupeve, lidhej me mungesën e barazisë, gjithëpërfshirjes, meritokracisë dhe konkurrencës së pastër në përfshirjen në strukturat qeverisëse në shkollë apo në struktura vendimmarrëse rinore në komunitet. Po ashtu, të rinjtë nuk ndihen të përfaqësuar dhe të përfshirë në mënyrë kuptimplote në vendimmarrje. Ata shprehen, gjithashtu, se faktori gjini ndikon në pjesëmarrjen ose jo të të rinjve, duke theksuar se shpesh tallen apo bullizohen nga shoqëria kur marrin pjesë në aktivitete/organizime që lidhen me 'gjininë' tjetër, p.sh., kur vajzat përfshihen në sporte apo djemtë në aktivitete sociale. Po ashtu, pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme është pengesë, sidomos kur bëhet fjalë për vajzat që jetojnë në zona rurale apo të thella dhe për personat nga grupe të marginalizuara.

Është e rëndësishme të theksohet se duhet të punohet me të rinjtë për të rritur vetëbesimin dhe ndjenjën e përfshirjes. Është shumë e nevojshme që të rinjtë të fuqizohen dhe të ndërgjegjësohen për rolin që kanë në shoqëri. Të rinjtë duhet të dëgjohen, të mbështeten nga shkolla dhe strukturat vendore, rinore dhe OJF-të, për të ndërmarrë nisma, por edhe të vlerësohen për mendimet e tyre dhe ato të merren në konsideratë. Duhet të sigurohet barazi, meritokraci, nxitje dhe konkurrencë e barabartë në proceset e përzgjedhjes së të rinjve në strukturat shkollore apo ato rinore. Nismat e ndërmarra duhet të jenë sa më gjithëpërfshirëse, pa bërë dallime me bazë gjinore, etnike, fetare, origjine apo statusi ekonomik.

Rekomandimet e sugjeruara nga të rinjtë

- Të ngrihen apo forcohen mekanizmat në nivel vendor dhe kombëtar që sigurojnë angazhim dhe përfaqësim të plotë të të gjithë të rinjve (vajza dhe djem) në vendimmarrje dhe hartimin e politikave rinore.
- Të ngrihen apo forcohen mekanizmat që fuqizojnë dhe sigurojnë që pushteti vendor të përfshijë të rinjtë (vajza dhe djem) dhe të marrë vendime bazuar në sugjerimet e të rinjve.
- Mekanizmat e pjesëmarrjes duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë përfshirje të të gjithë të rinjve (vajza, djem, grupe të marginalizuara), duke marrë parasysh diferencat e tyre, sfidat dhe pengesat që hasin në angazhim.
- Aktivitetet/trajnimet/fushatat e ndërgjegjësimi me fokus çështjet gjinore duhet të ofrohen në shkollë/universitet dhe nga OJF-të dhe partnerë institucionalë për të gjithë të rinjtë, familjen dhe komunitetin, duke kontribuar kështu drejt zbehjes së stereotipave gjinorë.
- Organizatat duhet të vijojnë punën e tyre për trajnime të specializuara në kuadër të barazisë gjinore, duke qenë sa më gjithëpërfshirëse si në zona urbane ashtu edhe rurale dhe të përshtatura për të rinjtë me aftësi të kufizuar.
- Këshillimi i karrierës duhet të ofrohet si një mjet drejt zbehjes së stereotipave rreth roleve gjinore dhe evidentimit të potencialit që kanë të rinjtë pavarësisht gjinisë.
- Të sigurohet që argëtimi, sporti, aktivitetet kulturore dhe hapësirat e gjelbra ekzistojnë për të rinjtë dhe janë të arritshme në të gjitha bashkitë, veçanërisht për vajzat, të rinjtë me aftësi të kufizuar, të rinjtë nga zonat rurale, ata që u përkasin grupeve minoritare, etj.
- Të ofrohen hapësira dhe mundësi (shkëmbime) që mbështesin dialogun mes vajzave dhe djemve, të rinjve në zona rurale apo urbane, apo nga kultura të ndryshme, për zhvillimin e bashkëpunimit, tolerancës, parandalimin e konflikteve dhe pranimin e diversitetit.
- Vajzave dhe djemve t'u jepen hapësira të barabarta për t'u informuar, për të vepruar dhe për të bashkëjetuar në kontekstin aktual, ku demokracia e vendit është përparësi.
- Angazhimi i barabartë i të rinjve në aktivitetet dhe trajnimet e organizuara nga bashkitë, organizatat dhe qendrat/strukturat rinore, të cilat kanë si qëllim zhvillimin e barazisë gjinore si koncept.
- Familja, shkolla dhe komuniteti duhet të jenë gjithnjë në përpjekje për përfshirjen e të rinjve në mënyrë të barabartë në jetën sociale.
- Rritja e ndërgjegjësimi të prindërve se fuqizimi e mbështetja për të ardhmen duhet të ofrohet njëllëj si për vajzat e djemtë.
- Modelet pozitive të të rinjve, përfshirë ndjeshmërinë për çështjet gjinore, përcillen edhe te më të vegjlit, ndaj të rinjtë dhe prindërit duhet të punojnë për të rritur vetëbesimin e vajzave dhe djemve, për sa i përket përfshirjes së tyre në jetën sociale.

VII. Bibliografia

1. Gender Equality Strategy 2022-2025, UNDP 2022, United Nations Plaza New York, NY 10017 USA, UNDP 2022.
2. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, qershor 2021, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
3. Studim pilot, Perceptimet dhe Qëndrimet Publike ndaj Barazisë Gjinore në Shqipëri, janar (2016) - Tiranë, Shqipëri.
4. INSTAT (2022). Burra dhe Gra 2022, Instituti i Statistikave -Tiranë, Shqipëri.
5. United Nations Development Programme, Gender Equality Strategy 2022-2025, gjendet në:
https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2022-09/UNDP_Gender_Equality_Strategy_2022-2025_EN.pdf. (Përdorur më 21 shtator 2023).
6. The European Union Youth Strategy 2019–2027, gjendet në:
https://www.oiph.fi/sites/default/files/documents/eu-youth-strategy_en.pdf (Përdorur më 11 shtator 2023).
7. Equality, Gender & Youth, gjendet në:
<https://www.forestsoftheworld.org/goals-strategies/equality-gender-youth> (Përdorur më 15 shtator 2023).
8. Social and Demographic Indicator, INSTAT 2020, gjendet në:
<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhesocial%C3%AB/popullsia/#tab3> (Përdorur më 4 shtator 2023).
9. Economic Reform Programme 2020-2022, Government of Albania, January 2020, gjendet në:
<https://new.financa.gov.al/wpcontent/uploads/2020/03/Economic-Reform-Programme-2020-2022.pdf> (Përdorur më 23 shtator 2023), faqe 115.
10. Vrutgman, L., & Bino, B., (2020). Trust in Governance Opinion Poll 2019. Tirana: IDM, gjendet në PNUD Albania
<https://www.undp.org/albania/press-releases/presentation-%E2%80%9Ctrust-governance-2019%E2%80%9D-opinion-poll-findings> (Përdorur më 9 shtator 2023).
11. Young people’s participation and civic engagement, gjendet në:
<https://www.unicef.org/evaluation/media/1581/file/A%20guide%20to%20action%20what%20works%20on%20adolescent%20and%20young%20people%20engagement.pdf>, (Përdorur më 13 shtator 2023).
12. Udhërrëfyesi kombëtar për tranzicionin e të rinjve nga shkolla në vendin e punës, Tiranë, qershor 2022 gjendet në:
<https://krk.al/wp-content/uploads/2023/04/UDHERREFYESI-KOMBETAR-PER-TRANZICION-IN-E-TE-RINJVE-NGA-SHKOLLA-NE-VENDIN-E-PUNES-2-1.pdf> (Përdorur më 12 shtator 2023), faqe 24.

VIII. Shtojca A

A. Kriteret për të qenë bashkëkërkues

Për të realizuar studimin kërkojmë të rinj që të kenë profilin e mëposhtëm:

- Të jetë qytetar shqiptar 17-20 vjeç.
- Të jetë aktiv në komunitet (anëtar në senat, këshillat studentorë, këshillat rinore, pjesëmarrës në organizata të ndryshme dhe të tjera të ngjashme me këto).
- Të ketë angazhime të mëparshme në aktivitete të Terre des hommes dhe/ose të organizatave të tjera shqiptare apo të huaja.
- Të ketë aftësi të mira dhe të konsiderueshme drejtuese, organizative, si dhe komunikim aktiv me komunitetin (të rinjtë e tjerë).
- Të tregojë disponueshmëri për t'iu përkushtuar studimit në gjithë procesin e realizimit të trajnimeve, hartimit të pyetësorit, shpërndarjes së pyetësorit dhe reflektimeve mbi studimin.
- Të zotërojë aftësi për të mobilizuar dhe përfshirë edhe të rinjtë e tjerë në këtë proces.
- Shënim: Në përfshirjen e të rinjve bashkëkërkues do të merret parasysh ruajtja e balancës gjinore, si dhe përfaqësimi i duhur si nga zonat rurale ashtu dhe nga ato urbane.

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit të të rinjve bashkëkërkues

- Të marrin pjesë në trajnime sipas agjendës së përcaktuar nga Terre des hommes Shqipëri (datat 8-9/15-16 Shtator 2023, ora 10:00-15:30).
- Të ofrojnë reflektime dhe këshillim mbi problematikat e pjesëmarrjes së të rinjve në komunitetet e tyre duke bashkëshoqëruar procesin e studimit.
- Të kontribuojnë në hartimin e pyetësorit.
- Të shpërndajnë pyetësorin duke aktivizuar të rinjtë e tjerë dhe duke ndërtuar paralelisht me ta fokus grupe.
- Të drejtojnë fokus grupet me të rinjtë.
- Të mbajnë një komunikim etik dhe koherent me stafin e Terre des hommes mbi ecurinë e procesit (10 ditë për mbledhjen e të dhënave), si dhe për reflektimet përkatëse në draftin e studimit.
- Të kontribuojnë për hartimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të studimit.

Shtojca B

B. Pyetësi

Përshëndetje,

Ne jemi një grup të rinjsh të angazhuar në një studim kombëtar “Të rinjtë shqiptarë dhe të drejtat e tyre në demokraci” që realizohet në kuadër të projektit “Youth for Justice and Rights”, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe zbatuar nga Terre des hommes Shqipëri. Ky studim do të kryhet me rreth 500 të rinj nga të gjitha qarqet në Shqipëri.

Pjesë e këtij studimi është edhe pyetësi që keni përpara. Ky është një pyetësor i thjeshtë, i hartuar prej nesh. Plotësimi i tij kërkon gjithsej 15-20 minuta.

Ju sigurojmë se i gjithë informacioni që do të jepni do të përpunohet dhe përdoret vetëm për nxjerrjen e të dhënave statistikore, pa u identifikuar individualisht në asnjë rast, duke siguruar ruajtjen e konfidencialitetit.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin!
Pranoni ta plotësoni pyetësin?

SEKSIONI I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1.1 Grupmosha:

- 15 – 19 vjeç
- 20 – 24 vjeç

1.2 Gjinia:

- Femër
- Mashkull

1.3 Vendbanimi juaj: _____

1.4 District:

- Berat
- Durrës
- Elbasan
- Fier
- Gjirokastrë
- Korçë
- Kukës
- Lezhë
- Shkodër
- Tiranë
- Vlorë

1.5 Etnia juaj: Shqiptar /Komuniteti /Rom/Egjiptian/Tjetër_____

1.6 Aktualisht jeni në:

- Shkollë
- Universitet
- Asnjëra

SEKSIONI II. AKTIVIZMI PUBLIK DHE DEMOKRACIA

2.1. Çfarë është për ty demokracia pjesëmarrëse?

- Formë ku unë mjafton të ftohem në aktivitete të ndryshme
- Aktivitet i ndërmarrë nga qytetari dhe jo nga aktorët shtetërorë
- Pavarësisht nga kush ndërmerret, mjafton që pjesëmarrja ime të ndikojë në vendimmarrje apo ndryshime
- Tjetër _____

2.2 Sa i/e gatshme je për të marrë pjesë në organizata rinore apo struktura të tjera vendimmarrëse për të rinjtë?

- Shumë
- Disi
- Pak
- Aspak

2.3 A je i/e angazhuar/pjesë e organizatave rinore/organizatave për të rinjtë?

- Po
- Jo

2.4 Nëse po, në cilën? _____

2.5 A je i angazhuar në grupime politike?

- Po
- Jo
- Preferoj mos të përgjigjem

2.6 Nëse po, a ke hapësirën e nevojshme për të dhënë mendimin tënd për çështje që shqetësojnë fëmijët dhe të rinjtë?

- Po
- Jo

2.7 A je në dijeni nëse ka një ligj specifik për të rinjtë në vendin tonë?

- Po
- Jo

2.8 Në dijeninë tënde, cilat janë organet vendimmarrëse në nivel qendror dhe vendor ku të rinjtë mund të jenë pjesë?

- Parlamenti i Republikës së Shqipërisë
- Agjencia Kombëtare e Rinisë
- Këshilli Kombëtar i Rinisë
- Këshilli Rinor Vendor
- Këshilli Bashkiak
- Qeveria studentore
- Senati i shkollës
- Tjetër _____

2.10 Në cilat prej këtyre organeve vendimmarrëse ke marrë pjesë?

- Kongresi Rinor Kombëtar
- Këshilli Rinor Vendor
- Këshilli Bashkiak
- Qeveria studentore
- Senati i shkollës
- Tjetër _____

2.11 Aktualisht si një i ri/e re a ndihesh i/e përfaqësuar në organet vendimmarrëse?

- Po
- Jo

2.12 Si nxitesh më së shumti për angazhim dhe pjesëmarrje?

- Me iniciativën time
- Me inkurajimin e prindërve
- Me ftesë të shkollës
- Me ftesë të bashkisë
- Me ftesë të strukturave politike
- Jam senator/e president/e, ndaj kam informacion mbi aktivitetet

2.13 A je dakord me pohimin 'Të rinjtë janë indiferentë kur bëhet fjalë për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për të ngritur zërin për të drejtat e tyre'?

- Po
- Jo

2.14 A mendon se pjesëmarrja jote do të ndikojë në vendime më demokratike?

- Po
- Jo
- Nuk e di

SEKSIONI 3. ASPEKTI GJINOR NË PJESËMARRJEN DHE ANGAZHIMIN RINOR

3.1. Me aspekte të barazisë gjinore për të rinjtë je njohur për herë të parë në:

- Familje
- Shkollë
- Qendër rinore
- Organizata të shoqërisë civile
- Tjetër _____

3.2. Ke marrë pjesë në trajnime që lidhen me aspekte të barazisë gjinore te të rinjtë?

- Po, një herë
- Po, disa herë
- Jo, asnjëherë

3.3. A je dakord me shprehjen 'Vetëm burrat marrin vendime në shoqërinë shqiptare'?

- Po
- Jo
- Nuk më intereson si çështje

3.4. A mendon se gjinia ndikon në pjesëmarrjen apo mospjesëmarrjen e të rinjve në vendin tonë?

- Po
- Jo
- Nuk e di

3.5 A të ka ndodhur të marrësh pjesë në aktivitete që shoqëria i cilëson si aktivitete vetëm për gjininë tjetër?

- Po
- Jo
- Kam dashur të marr pjesë, por paragjykimet më kanë frenuar

3.6 Sa shpesh flisni për çështjet gjinore në rrethin tuaj shoqëror?

- Shumë shpesh
- Shpesh
- Ndonjëherë
- Asnjëherë

3.7 Sa shpesh flisni për çështjet gjinore në familje?

- Shumë shpesh
- Shpesh
- Ndonjëherë
- Asnjëherë

3.8. Mendon se prindërit në Shqipëri:

- Nxisin më shumë djemtë për të marrë pjesë në aktivitete
- Nxisin më shumë vajzat për të marrë pjesë në aktivitete
- I nxisin njëloj si vajzat dhe djemtë

3.9. A mendon se vajzat dhe djemtë kanë mundësi të barabarta përfaqësimi?

- Po
- Jo
- Nuk e di

3.10. A ke përjetuar personalisht paragjykim gjinor gjatë pjesëmarrjes tënde në aktivitete rinore?

- Po
- Jo
- Preferoj të mos përgjigjem

3.11. Në cilat fusha mendon se vajzat/ gratë janë më shumë të përfshira?

- Në familje
- Në rol drejtues dhe vendimmarrës
- Në politikë
- Sport
- Art
- Edukim
- Punësim
- Tjetër_____

SEKSIONI 4. PJESËMARRJA DHE ANGAZHIMI NË KOMUNITET

4.1 Cila nga strukturat e mëposhtme në komunitet është më aktive në punën me të rinjtë?

- Shkolla
- Organizata e shoqërisë civile
- Qendra rinore
- Forum politik
- Institucion fetar
- Bashkia
- Tjetër_____

4.2. Aktivitetet e cilit prej institucioneve më poshtë preferon të frekuentosh më shumë?

- Shkolla
- Organizata e shoqërisë civile
- Qendra rinore

- Forum politik
- Institucion fetar
- Bashkia
- Tjetër _____

4.3 A ka një qendër rinore në zonën ku ti jeton?

- Po
- Jo
- Nuk e di

4.4 Nëse po, a mendon se ka infrastrukturën e duhur për të kryer aktivitete domethënëse për të rinjtë?

- Po
- Jo
- Nuk e di

4.5 A ke marrë pjesë ndonjëherë në mbledhje të Këshillit Bashkiak?

- Po
- Jo
- Nuk e di

4.6. Cilat janë aktivitetet që ofrohen më së shumti për të rinjtë në komunitetin ku ti jeton?

- Sportive
- Kulturore
- Argëtuese
- Me natyrë politike
- Me natyrë fetare
- Nuk kam informacion
- Tjetër _____

4.7 Sa i/e përfshirë ndihesh në aktivitetet ku merr pjesë?

- Ndihem i përfshirë dhe i dëgjuar
- Nuk ndihem i përfshirë dhe i dëgjuar
- Nuk mendoj se roli im ka ndonjë ndikim

4.8 Në komunitetin ku ti jeton, më të angazhuar janë:

- Djemtë
- Vajzat
- Si djemtë dhe vajzat njëjloj

4.9 Në rast se do të propozoje realizimin e një nisme, fillimisht do të 'trokisje' në:

- Shkollën ku ndjek/kam mbaruar studimet
- Organizatën e shoqërisë civile ku angazhohem
- Një biznes në komunitet
- Bashki/njësi administrative
- Institucion fetar
- Partinë ku unë bëj pjesë
- Asnjëra

4.10 A ke qenë pjesë e ndonjë nisme që ka prodhuar rezultate konkrete që kanë ndryshuar diçka në komunitetin tënd?

- Po
- Jo

4.11 A mendon se institucionet që punojnë me të rinjtë mund të sjellin ndryshime reale në komunitetin tënd?

- Shumë
- Disi
- Pak
- Aspak

SEKSIONI 5. PJESËMARRJA DHE ANGAZHIMI NË EDUKIM

5.1 A keni pasur mundësi të barabarta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në struktura vendimmarrëse në shkollë/universitet (qeveri e nxënësve/senat/këshill studentor)?

- Po
- Jo
- Nuk e di

5.2 A ka pasur/ka në shkollën ku je/keni ndjekur studimet aktivitete që nxisin ekskluzivisht pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje?

- Po
- Jo
- Nuk e di

5.3. Nëse po, a mendon se gjithë të rinjtë kanë pasur mundësi për të marrë pjesë në struktura vendimmarrëse?

- Po
- Jo
- Nuk e di

5.4. Në cilat prej strukturave të mëposhtme ke qenë/je i/e angazhuar në shkollë/ universitet?

- Në Senat
- Në Qeverinë e Nxënësve
- Në Këshillin Studentor
- Asnjë

5.5. Sa i/e përfaqësuar je ndier/ndihesh nga senati/qeveria e nxënësve/studentëve?

- Shumë
- Disi
- Pak
- Aspak
- Nuk kam dijeni

5.6. A të mbështet familja për të marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga shkolla/universiteti?

- Po
- Jo

5.7 A ka pasur raste kur nuk ke marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga shkolla/universiteti sepse ka ndikuar opinioni i shoqërisë tënde?

- Po
- Jo

5.8 Aktivitetet në shkollën/universitetin tënd organizohen/janë organizuar kryesisht nga:

- Drejtoria e shkollës
- Dekanati
- Mësuesit
- Pedagogët
- Qeveria e nxënësve
- Këshilli studentor
- Prindërit
- Organizata të shoqërisë civile
- Tjetër _____

5.9 Çfarë të motivon/të ka motivuar më shumë për të qenë pjesëmarrës në aktivitete të shkollës/universitetit:

- Iniciativa ime personale
- Motivim nga prindërit
- Motivim nga mësuesit
- Motivim nga stafi psikosocial i shkollës
- Shtysë nga shoqëria ime
- Asgjë specifike
- Nuk kam motivim

5.10 Çfarë përfiton/ke përfituar më shumë nga pjesëmarrja në aktivitetet e shkollës/universitetit (klikoni më të rëndësishmen):

- Shoqërizim
- Aftësi komunikimi / drejtimi
- Edukim
- Përfitime monetare
- Asnjë
- Tjetër

SEKSIONI 6. PJESËMARRJA DHE TEKNOLOGJIA ONLINE

6.1 A janë për ty rrjetet sociale një burim i besueshëm për të marrë informacione që lidhen me të rinjtë dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri?

- Po
- Jo
- Nuk e di

6.2 Për se i përdor më shumë rrjetet sociale?

- Për të kaluar kohën e lirë
- Për t'u informuar për kauza që lidhen me të rinjtë
- Për të siguruar të ardhura
- Për asnjë nga të mësipërmet
- Tjetër_____

6.3 Sa shpesh i përdor rrjetet sociale për t'u informuar mbi aktivitete që të ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve/njohurive personale?

- Shumë shpesh
- Shpesh
- Ndonjëherë
- Asnjëherë

6.4. Cili është burimi kryesor për të marrë informacion që nxit pjesëmarrjen e të rinjve?

- TV
- Faqet e internetit
- Media sociale (Fcb, Instagram, etj.)
- Tjetër

6.5. A je ndier i bullizuar/ngacmuar/rrezikuar gjatë përdorimit të rrjeteve sociale?

- Po
- Jo
- Preferoj të mos përgjigjem

6.6. Nëse po, a ke raportuar?

- Po
- Jo
- Preferoj të mos përgjigjem

Faleminderit që u bërë pjesë e studimit tonë!

Ne do të përpiqemi që ta përfaqësojmë zërin e të rinjve në gjithë Shqipërinë!

Shtojca C

Diskutimi në fokus grupe: Drejtuesi

Mirëseardhja: Falënderohen pjesëmarrësit, ftohen për të qenë pjesë e diskutimit dhe shpjegohet **qëllimi i fokus grupit:**

Përshëndetje. Emri im është _____ dhe jam pjesë e grupit të të rinjve të angazhuar me Terre des hommes për realizimin e studimit kombëtar mbi angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve. Ky studim realizohet në kuadër të projektit “Të rinjtë, të drejtat dhe drejtësia” financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe zbatuar nga Terre des hommes Shqipëri. Në fazën e parë të tij është kryer një studim online ku 650 të rinj nga gjithë Shqipëria kanë dhënë mendimin e tyre në lidhje me pjesëmarrjen dhe angazhimin në fusha si vendimmarrja, edukimi, angazhimi komunitar, çështjet gjinore dhe teknologjia online. Këto gjetje paraprake të studimit do të diskutohen me ju sot për të kuptuar më qartë se cilat janë arsyet e angazhimit apo mosangazhimit të të rinjve dhe cilat janë rekomandimet që keni për një përfshirje më kuptimplotë në fushat e sipërpërmendura.

Kohëzgjatja: Intervista do të zgjasë rreth 45-60 minuta.

Konfidencialiteti: Pjesëmarrja juaj në studim është vullnetare dhe nëse nuk doni t’i përgjigjeni ndonjë pyetjeje gjatë bisedës jeni të lirë ta bëni. Gjatë fokus grupit do të mbahen shënime, të cilat do të përdoren vetëm me qëllim prodhimin e raportit dhe nuk do të ndahen me askënd tjetër. I gjithë informacioni i marrë do të mbetet konfidencial.

- **Pjesëmarrja e të rinjve**

1. Në përditshmërinë tuaj, cilat janë hapësirat dhe mundësitë që ju ofrohen në familje, shkollë, komunitet dhe struktura vendimmarrëse rinore për të marrë pjesë, për t’u angazhuar, për të diskutuar dhe për të ngritur zërin për çështje që u përkasin të rinjve?
2. A keni qenë pjesë e ndonjë nisme që mendoni se ka ndryshuar diçka në komunitet apo te ju personalisht? Cila ka qenë? Çfarë rezultatesh konkrete ka prodhuar? Çfarë do të rekomandonit që nismat të jenë më gjithëpërfshirëse dhe me një impakt domethënës?

- **Pengesat**

A. Nëse nuk keni qenë të angazhuar, cilat kanë qenë arsyet që ju kanë penguar të jeni pjesë e aktiviteteve të tilla?

- Indiferenca e vetë të rinjve
- Mungesa e informacionit
- Mungesë aktivitetsh (shkollë/ komunitet/organizma rinore)
- Qasja në teknologjinë online

- Pengesa nga shoqëria
- Pengesa nga familja
- Stereotipat/ rolet gjinore
- Nuk ndihen të përfaqësuar nga organet vendimmarrëse
- Nuk ndihen të përfshirë, të angazhuar dhe të dëgjuar
- Mungesa e besimit

B. Të rinjtë janë indiferentë kur bëhet fjalë për të marrë pjesë në vendimmarrje. A është paragjykim apo realitet sipas jush ? Pse mendoni se janë indiferentë të rinjtë?

- **Rekomandimet:**

- a. Cilat janë sugjerimet/rekomandimet e tua për familjen, shkollën, komunitetin, organizatat rinore, bashkinë/qeverinë që të rinjtë të jenë më të angazhuar, të ndihen më të përfaqësuar dhe më të dëgjuar ?

II. Pjesëmarrja e të rinjve dhe çështjet gjinore:

- a. A keni përjetuar ndonjëherë diskriminim për shkak të gjinisë në aktivitete ku keni marrë pjesë? Si ka ndodhur dhe çfarë keni përjetuar?
- b. Shumica e të rinjve janë shprehur se vajzat dhe djemtë nuk kanë mundësi të barabarta angazhimi dhe përfaqësimi. Po mendimi juaj cili është? Cilat mund të jenë arsyet apo pengesat që hasin?
- c. A mendoni se prindërit nxisin më shumë djemtë? Pse? Si mendoni se e bëjnë këtë prindërit? Çfarë u ofrojnë? Mbështetje (emocionale, ekonomike, etj.)?

- **Rekomandimet:**

- a. Cilat janë sugjerimet/rekomandimet e tua që si vajzat dhe djemtë të kenë mundësi të barabarta për t'u përfshirë?

